

- Nderimi për Ismail Kadarenë-

PËSHTJELLIM NË DITË LAMTUMIRE TË PËRZISHME

Nga Prof. Dr. Bashkim Kuçuku



SHËNIME MBI LIBRAT

BESNIK MUSTAJ, NJË
LABORATOR AKTIV NË
KËRKIM TË HAPËSIRAVE
TË PASHKELURA KRIJUESE

Nga Emin Azemi (fq. 12)

“ODEON”(2024) NJË
PËRMBLEDHJE E RE
STUDIMORE NGA
ALFRED ÇAPALIKU

Nga Arben Prendi (fq. 13)

Romani “Pesha e padurueshme e pafajësisë”
i Primo Shllakut

TË JESH, A TË MOS JESH ...
I PAFAJSHËM?

Nga Alma Ibi Zekollari (fq. 14)

SANDRA
CISNEROS

Mbi aktin personal të
shkrimit të poezisë:
“E mendoj shkrimin
e poezisë një akt
kryengritës”

Përzgjedhi dhe përktheu:
Andja Krasniqi



Vera e fillesës
së një miqësie

Nga Prof. Dr. Diana Kristo (fq. 9)

Kadareja ynë

Nga María Rocés González (fq. 7)

Heshtja e Kadaresë

Nga Ndue Ukaj (fq. 8)

Enigma e një
vepre gjeniale

Nga Feride Papeleka (fq. 11)

Një histori me Kadarenë

Nga Thanas Qirzidhi (fq. 8)

Kadareja u nis lart për
në bulevardin e gjenive

Nga Bujar Skëndo (fq. 11)

Memoriale nga takimet
e fundit me Kadarenë

Nga Petro Çerkezi (fq. 10)

Disa shkrime të
mediave kineze për
vdekjen e Kadaresë

Përgatiti Iljaz Spahiu (fq. 19)

Shënime në formë ditari

TRI KËNGË ZIE PËR KADARENË

Nga Agim Vinca

Kadareja foli me shekullin e vet, që shekujt të flasin
për të. U bë shkrimtar universal duke qenë dhe mbetur
thellësisht shqiptar. Nëpërmjet veprës së tij bota e njohu
Shqipërinë dhe shqiptarët, kurse shqiptarët e njohën veten
dhe botën. (fq. 6)

BIBLIOTEKË

Zejnullah Rrahmani (fq. 16)

Heshtja

Xhevair Lleshi (fq. 17)

Kmesa

Sali Bashota (fq. 18)

Orari i ri i ëndrrave

Demë Topalli (fq. 19)

Fjalët

TRI KRONIKA PËR
KADARENË DHE
AMANETI I NËNËS NGA
ÇAMËRIA

Nga Enver Kushi (fq. 15)

Në shenjë nderimi për Ismail Kadarenë The Paris
Review ribotoi dhe bëri të mundur leximin në format
elektronik të intervistës së verës së vitit 1998.

KADARE:
Doja të mbetesh
shkrimtar dhe i lirë
Përktheu Granit Zela (fq. 20)

Lamtumira e qytetarëve dhe bashkëkombësve

E hëna e 1 korrikut, që në mëngjes, më filloi me mesazhin më se trishtues, në celular, të një punonjëseje të Akademisë së Shkencave: *Mirëmëngjes! Paska vdekur Kadareja? A mund të më dërgosh pak numrin e Bujarit?* Menjëherë pyeta Bujar Hudhrin, botuesin e veprës së tij, i cili m'u përgjigj: "Po, është e vërtetë".

Prej vitesh kisha menduar, si do të jetë dita e ndarjes nga jeta e shkrimtarit Ismail Kadare. Vazhdimisht më përfytyrohej e vështirë, tronditëse për mua. Jo pa arsye. Në mendjen time, ai ka qenë dhe mbetet shqiptari me ndihmesa më të mëdha në shekullin e njëzetë, që vetëm i dha Shqipërisë dhe shqiptarëve, duke marrë veç jetesën e vet të zakonshme, për mos të thënë modeste, dhe pa iu sjellë asnjë të keqe, apo, dëm të çdo lloji qofshin, ndryshe, nga politikanë, shtetarë e kryeshtetarë, të cilët, edhe kur dalin, në faqen e historisë, me bëma pozitive, nuk u mungojnë dëmet apo zhvatjet, që i kanë bërë vendit dhe bashkësisë shqiptare. Ndhimesat e tij nuk janë vetëm në letërsi dhe kulturën shqiptare, as ndihmesa pasive në rrethin e mbyllur të letërsisë e kulturës, por kanë qenë e janë tepër aktive e gjallëruese në përditshmërinë e këtyre shtatëdhjetë-tetëdhjetë vjetëve, që ka kaluar bota shqiptare. Të tilla janë në historinë e kulturimit, europianizimit dhe emancipimit shpirtëror e psikologjik, moral e qytetar të tyre, duke kaluar njëmendësisht në epokën e kulturimit e qytetërimit europian.

Argumentohet, se politika është baza e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik për së mbari apo e traumave a rënieve të shoqërive dhe të sistemeve shoqërore. Mirëpo, nuk mund të mos shihet, sidomos në kohët moderne, më tepër në bashkëkohësi, se shpesh kultura merr epërsi mbi politikën, e cila shtrohet përmbi kulturën e traditat kulturore. Kombet e vendet e kulturuar në shekuj kanë politika e demokraci të dorëmbarshme e të qëndrueshme. Vendet e shoqëritë me kulturë të varfër, sikurse është shoqëria shqiptare, e kanë tepër të vështirë të bëjnë politika të dorëmbarshme e të ndërtojnë demokraci të plotë e të qëndrueshme. Kadareja me veprën e shumëllojshme letrare e diskursive, me veprimtarinë shoqërore, madje dhe politike, kur ka qenë e mundur për të, i ka hedhur ndihmesat, pikërisht, në këtë bazament kulturor të ngrehinës së shoqërisë shqiptare.

Ditën e parë më brente pyetja: A do të shpallen ditë zie për të? E përsërisja me vete, e diskutova dhe me miq. Në mbrëmje të asaj dite isha i ftuar në studion e *TV ABC NEWS*, në orën 20:00, gati për të filluar bisedën. Para bisedës sonë, gazetaria lexoi njoftimin, se ishin shpallur dy ditë zie në nderim të shkrimtarit Ismail Kadare. U lehtësova! I dhashë mendim, edhe gazetares që më pyeti për vendimin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Filloi, pyetja tjetër dyshuese. Po Kosova, do të shpallë ditë zie? I takon të shpallë. E ka shtetas të vet, të Republikës së Kosovës, e ka nderuar me dekorata të larta për ndihmesat e tij në njohjen botërore të së drejtës dhe luftës së saj për t'u çliruar. Të nesërmen, kur doli njoftimi, se qeveria e Kosovës kishte shpallur një ditë zie në nderim të shkrimtarit, të paepur të çështjes shqiptare, u preka. Në intervistën, që dhashë në "Radio Prishtina", për sa fola për Kadarenë në mbrojtje të Kosovës, isha i mallëngjyer.

Me rëndësi të veçantë ishte njoftimi i Zyrës së presidentit të Francës. Franca ka jo pak shkrimtarë me emër në botë, dhe bota ka shumë shkrimtarë të mëdhenj, disa dhe nobelistë. Por Zyra e presidentit nuk shpreh vlerësime për të gjithë, janë të rrallë të përzgjedhurit e saj. Ismail Kadarenë e quajti shkrimtar *shqiptaro-francez*, sepse ishte shtetas i Francës, anëtar i Akademisë Morale e Politike të saj, dhe frëngjishtja

- Nderimi për Ismail Kadarenë-

PËSHTJELLIM NË DITË LAMTUMIRE TË PËRZISHME

Nga Prof. Dr. Bashkim Kuçuku

gjuhë e dytë e veprës së tij.

Në ditët e përzishme, pamë si asnjëherë tjetër, nderimin e madh e të merituar ndaj kulturës. Mijëra e mijëra qytetarë, personalitete të shkencave, arsimit, letërsisë dhe të arteve të tjera, politikanë e ambasadorë, më shumë qytetarë të zakonshëm, bashkëkombës nga treva të ndryshme të hapësirës shqiptare e të diasporës, në forma të ndryshme dinjitoze, i dhanë lamtumirën e fundit shkrimtarit të dashur. Nderimi për të ishte nderim për letërsinë, kulturën shqiptare, gjuhën shqipe, identitetin shqiptar me të cilat ishte njësuar, dhe, bota e huaj, e njëjta si të tillë, të njësuar me to.

Ata, që e kanë lexuar dhe të cilët i ka emocionuar dhe emancipuar për dhjetëra vjet, sidomos, ata, që kanë pasur rastin ta ndjekin nga afër jetën e tij, nuk mund mos t'u shfaqeshin edhe momente të vështira, traumatike, e jo pak, që pati kaluar Ismail Kadareja në vitet e diktaturës, prej të cilave, fatmirësisht, doli i patraumatizuar. Ndihej gjithmonë i lirë e i çliruar, pas çdo situatë dramatike, energjik, me guxim të pavarë. Dhe fillonte veprën e re, shoqërisht e politikisht edhe më të guximshme, letrarisht risore e origjinale.

Dashakeqësit, ndoshta dhe instanca të caktuara shtetërore, e njerëz të porositur, patën përhapur mendimin për "privilegjet" e tij në sistemin stalinist. Të tjerë, të paditur, se çdo të thotë jetë normale, se vetë kishin një jetë ekonomiko-shoqërore jonormale, të varfër e tepër të varfër, e besuan këtë, dhe e përsërisnin, sikur ankesa për "privilegjet" e tij do të përmirësonte gjendjen e tyre ekonomike. Thuhet kështu dhe ashtu për "privilegjet" e tij në kohën e diktaturës, zakonisht, nga ata, që nuk e kanë njohur nga afër, ndoshta, as nuk e kanë parë ndonjëherë me sy. Ai nuk ishte kooperativist a punëtor uzine. Ishte intelektual i shkallares më të

lartë. Nuk kishte as pesë-gjashtë fëmijë për të mbajtur. Jeta dhe jetesa e tij ishte si e çdo intelektualit të asaj shkallareje shoqërore të atëherëshme. Unë, që isha redaktor i kritikës letrare në fillimet e karrierës sime, në gazetën letrare *Drita*, kisha pagë mujore 7200 lekë. Ai, që ishte edhe shkrimtar i njohur e i vlerësuar botërisht, dhe shkrimtarët e tjerë në profesion të lirë, si ai, e kishin pagën 11.000 lekë, po aq edhe ata me titullin Profesor, p.sh., Dhimitër Shuteriqi. Gjithë fitimet e honorareve, që i vinin nga jashtë, depozitoheshin në Bankën e Shtetit me emrin e Ismail Kadaresë, por, pa të drejtë tërheqjeje. Kur dilte jashtë shtetit, nga depozita e tij në Bankë, llogaria e Lidhjes së Shkrimtarëve, me shkresë të kryetarit, i jepte vetëm disa qindra dollarë, 200-300, ose dhe më shumë, me të cilat mund të blinte libra ose diçka tjetër, të përdorshme për shkrimtarin. Për blerjet sillte faturat, ndryshe, kthente dëmshpërblimin. Ka qëlluar më se një herë të dëgjoj qortimet e shesës së llogarisë, se nuk kishte disa nga faturat e shpenzimeve. Një herë debati i tyre, u përmbyll, duke i premtuar Kadareja, se do t'i sillte dollarët për të cilët nuk kishte faturë.

Banasa e tij, "luksozja" ka qenë në një pallat te Rruga e Dibrës, projektuar nga Maks Velo, paramenduar për shkrimtarë dhe artistë të njohur. Sot është muzeu *Kadare*. Apartamenti i zakonshëm për çdo familje, me dy dhoma e kuzhinë. Më tepër se familjet e këtij lloji kishte sallonin e pritjes dhe dhomën apo studion e punës, sikurse kishte Dritëro Agolli, kompozitori Feim Ibrahim i disa shkrimtarë e artistë të tjerë.

Në ekranin e kujtesës më janë shfaqur shpesh disa nga situatat e rënda të tij, të cilat nuk mund t'i harroj, madje, m'u rishfaqën më qartë, kur qëndrova përpara trupit të tij pa jetë. Së paku, janë dy rrufe të njëmendta të pushtetit diktatorial, që

janë lëshuar mbi të, nga Zeusi nr. 1 dhe Zeusi nr. 2. Projektori i kujtesës sime hodhi shtëllungë drite te ndëshkimi dhe izolimi shoqëror, që iu bë, kur iu ndalua nga botimi poema *Në mesditë Byroja Politike u mblodh*. Pas kritikave të rënda, që nga Ramiz Alia te kolegë shkrimtarë, iu sulën me cilësimin e rëndë "armik i socializmit", që e përsërisnin në biseda e debate edhe jo pak qytetarë "vullnetarë". Sipas programit të zakonshëm, Ismaili vinte çdo ditë në Lidhjen e Shkrimtarëve. Takonte miq e kolegë, hynte në redaksinë e *Dritës* dhe të *Nëntorit*, diskutonte, herë-herë ironizonte njërin ose tjetrin. Në zyrat e Lidhjes, në oborrin e saj nuk dukej më. Edhe të donte të shfaqej, nuk mundte, se ishte degdisur në një fshat të Fierit për "riedukim". Shfaqej tek-tuk, e zhdukej menjëherë, veç kur kishte ndonjë punë të pashmangshme. Mirëpo, atëherë, askush, me përjashtim të dy-tre zyrtarëve të afërt, nuk e dinte, se Enver Hoxha, në *Ditarin* e vet, për poemën *Në mesditë byroja Politike u mblodh*, kishte shkruar:

"E tërë kjo pjesë (nga poezia *Në mesditë Byroja Politike u mblodh/Pashallarët e kuq*) shpreh pa dorashka ide-antirevolucionare, ide antimarksiste, antiparti, dhe flet hapur kundër rendit socialist në vëndin tonë. Sipas tij, regjimi te ne është duke "shkuar në varr", "është prishur nga themelet"... Ky poet borgjez atakon gjithë ndërtimin e socializmit në vëndin tonë... Me keqardhje ky poet korbash thotë... Por "filozofia" e këtij poeti reaksionar është e falsifikuar... Është e qartë se Kadareja është kundërrivolucionar, është kundër diktaturës së proletariatit, kundër dhunës dhe shtypjes së armiqve të klasës... Ky poet i lig e përgjithëson për të atakuar partinë... I thashë Ramizit... thirr Ismail Kadarenë, e vure përpara "mutrave" të tij dhe bëje t'i lëpijë." *Panorama*, maj 2016/ Dashnor Kaloshi *Zbulohet Ditari sekret i Enverit: Kadare poet i lig korbash//* Edhe Ismaili, pavarësisht se nuk dinte për ditarin e zi kundër tij, i provoi në shpinë e i përjetoi të gjitha pasojat e mundshme, që erdhën prej porosisë së tij.

Tjetër periudhë traumatike ishte kritika publike, që iu bë romanit *Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave/Pallati i Ëndrrave* (1982). Në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, në prani të disa qindra pjesëmarrësve dhe një pjese të Byrosë Politike, Ramiz Alia, duke pasur parasysh romanin e Ismail Kadaresë, tha: "Ky gjykim e vlerësim popullor është i pamëshirshëm... Ai të vë në krye të pedestalit e të vendos në Olimp, por edhe të rrëzon përdhë e të bën baltë kur vepra nuk vlen".

Këtë "sezon" ndëshkimi, herë-herë, vinte në Lidhje, hidhte sytë andej-këndej, dhe, siç vinte ashtu ikte. I heshtur, rrallë njatejtohej



Çifti Kadare, studiuesi dhe kritiku Bashkim Kuçuku, dhe botuesi Bujar Budhri, në restorant Piazza, pranverë 2001

me dikë. Përsëri e shihje shkrimtarin vetëm nëpër Tiranë, ose, me të shoqen. Trishtoheshe, kur, nga Lidhja kthehej për në shtëpi përmes sheshit *Skënderbej*, pa asnjë koleg a dashamirës, ndryshe nga dikur, që i ngjiteshin njëri pas tjetrit e dy e nga dy, për t'i parë të tjerët, se me kë shoqëroheshin.

Për ata, që nuk i kanë lexuar veprat e tij, dhe, për ata, që i kanë lexuar, por nuk i njohin fare kriteret e vlerësimit të letërsisë, apo, për të tjerët, që, edhe pse i dinë kriteret letrare, i shkelin qëllimisht, po sjellim parasysh një kriter themelor të vlerësimit – biografia as i shton dhe as i pakëson vlerat e veprës. Ato janë në vetvete, të pacenueshme e të patjetërsueshme. Biografia vetëm ndihmon në kuptimin dhe interpretimin e saj. Sado të sorollaten, me fakte më shumë të paqena se sa të qena, herostratët nuk hyjnë dot në tempullin e letërsisë kadareane për ta cenuar. Ata vetëm çirren, kush e kush të hakërrehet më keq, qark kësaj kështjelle, të mbrojtur sot e përgjithmonë nga vlerat e veta.

Rrufetë dhe përndjekjet e dikurshme, gjithashtu, përndjekjet dhe baltosjet e sotme, të një turme vlerëshkelëse, më krijuan një pëshqjellim, që godiste paprerë timpanin e nderimit të madh dhe të heshtjes sime të lamtumirës së përzishme. Nga betejat e mëdha, ndonëse, edhe të përzhitur shpirtërisht, gjenitë dalin më fisnikë e madhështorë.

Nga bisedat me Kadarenë

Takimet dhe bisedat me Ismail Kadarenë i kam përjetuar me kënaqësi të jashtëzakonshme, sidomos pas 1990-s, kur flitej lirshëm. Gjithmonë kam qenë i bindur, se bisedoja me një shqiptar e shkrimtar të pa të dytë të botës shqiptare, personalitet evropian e botëror, kudo i nderuar e i çmuar. Nuk është vetëm vepra e shkruar me origjinalizëm të pakrahasueshëm, letërsi autonome, më vete, në tërësinë e Republikës Botërore të Letrave. Ai, edhe në biseda për dukuri e çështje nga më të zakonshmet, shprehte mendime e perceptime, që mund t'i kishe dhe ti, dhe më shumë mendime e perceptime të tjera, për botën shqiptare e të huaj, letërsinë, shkrimtarët, politikën, traditën, femrën, dashurinë, që të befasonin e jo pak të nguliteshin në kujtesë. Gati si fillestar, i magjepsur nga madhështia e veprës dhe e famës tij, që tërhiqesh nga hollësitë e jetës vetjake, si flet, si rri, si vepron, si mund të flasësh ti me të e si mund të të përgjigjet ai, që kur punoja në gazetën *Drita*, në Lidhjen e Shkrimtarëve, kam ngulitur jo pak në kujtesë. Një kureshtje e tillë adoleshenti, gjithashtu, thellësisht njerëzore, më “përndoqi” një kohë të gjatë. Për të qenë më besnik ndaj kujtesës vetjake, për t'i ruajtur në trajtë të paharrueshme, herë pas here, disa i kam hedhur në letrën besnike të përjetshme të njeriut, shpikësit të saj. Më shkonte ndër mend, që, veç meje, mund të ketë edhe të tjerë, që i tërheqin këto hollësi. Dhe, ashtu, doli. Ditët e përzishme, gazetaret e gazetaret, që më ftuan në emisionet e katër TV-ve dhe të “Radio Prishtinës”, kërkonin të dinin për vete dhe publikun të dhëna të jetës së tij të përditshme, të mënyrës së jetesës, të komunikimit.

Të dhënat biografike e të jetës intime të shkrimtarëve dhe artistëve: Gëte, Beethoven, Mozart, Mikelanxhelo, Tolsto, Pushkin, Balzak, Xhek London, Sartrë etj., aq më tepër të Ismail Kadaresë, i kam lexuar me kureshtje të përqendruar, tjetër lloj, mbi të cilat, gjej një lloj mbështetjeje në leximin e veprave të tyre. Shënimi i tyre, në mënyrë sistematike, ka qenë mision i detyrueshëm i të tjerëve, i institucioneve shtetërore përkatëse, në radhë të parë, të Akademisë së Shkencave dhe institucioneve të tjera me radhë. Libri i Helena Kadaresë *Kohë e pamjaftueshme*, kujtime, është monument i shkruar i portretit autentik të Ismail Kadaresë. Megjithatë, ka pasur mundësi



Ndërtesa te Saint-Michel



Ndërtesa, në Paris, ku ka banuar Ismail Kadareja 1992-1996, rue “Violet” 75015, pranë avenue “Zola”

këndvështrimesh të tjera për të plotësuar portretin e tij autentik. Presim me shpresë, që, dikush të ketë e të botojë shënime të vlefshme të këtij lloji. Copëzat e shënimeve të mia po i jap thjesht për të rigjallëruar, në çastet e lamtumirës, përjetimet e paharrueshme vetjake me shkrimtarin dhe shqiptarin e madh, Ismail Kadare.

Paris, e martë, 17 dhjetor, 1996

Shqiptarët thonë, se dita e martë është ters, e mbrapshtë, ose, së paku, e ka një orë të keqe, prandaj, ruaju nga kjo orë e keqe. Po cila është ora e keqe e së martës? Askush nuk e di. Atëherë mbetet që të ruhesh gjithë ditën nga ora e mbrapshtë e saj. A ka vallë, ndonjë shqiptar të mos jetë pak besëtytë, sidomos, kur dëshiron diçka, por nuk e ka në dorë, prandaj, rri e pret me padurim atë që do të ndodhë? Duke besuar tek e mira dhe tek orët e mira, edhe të së martës, mora guximin të telefonoja në familjen Kadare. Ismaili, në Tiranë, më kishte premtuar, se do të më jepte materiale të kritikës së huaj për veprën e tij. Mezi prisja! Kur dhe sa?! Isha duke punuar për librin *Mbi veprën e Kadaresë*, botimet në gjuhë të huaja dhe kritika për të.

Në orën 11:20 mora në telefon nga *Residence Universitaire, Rue de Citeaux*, boulevard *Diderot*, ku banoj këta dy muaj, me bursë *Tempus* të Bashkësisë Europiane.

- Do të dalë Ismaili, apo, Helena? Helena, apo, Ismaili?

- Alo? Qui êtes-vous?

Ishte zëri i plotë i Helenës, që vjen nga një ndjesi mirësjelljeje dhe lirshmërie ndaj atij me të cilin bisedon.

- Mirëdita, zonja Helena! Jam...

- Si kaloni këtu?

- Mirë, shumë mirë. Ju, si jeni?

- Bisedova me Ismailin për materialet, dhe, për fat, ai u kujtua, se ku i ka vënë, por unë nuk i kam nxjerrë, se janë lart, në raft. Do t'i marr me shkallë...

- Mirë! Atëherë, si do të merremi vesh, se kur mund të jenë gati?

- Më telefono prapë nesër.

.....

Paris, e premte, 20 dhjetor, 1996

-

Prisja Helenën, doli Ismaili. Me zërin burrëror e melodioz, imponues, sidomos në telefon, me vetëkënaqësi, duke jetë i çliruar nga një mundim a bezdi. I qetë, e rrallë në telefon.

- Zoti Ismail, jam... Mirë jeni me shëndet? Jeni lodhur?

- Po, edhe të lodhur jemi.

- E kisha lënë të flisja me zonjën Helena për ato materialet. Më falni, mund të flas me të?

- S'ke ç'flet. Eja sot.

- Kur është e përshtatshme të vij?

- Mundohu të vish nga ora 6:30.

- Më falni, por nuk di as adresën.

- Mirë, shënoje, se nuk mbahet mend.

- Po ju dëgjoj, se nuk kam as letër as stilolaps.

- Po si nuk ke!? Si merr tjetrin në telefon pa letër dhe pa stilolaps!?

- E, po, ja, nuk kam me vete. Do ta mbaj mend....

- Bulevardi “Saint-Germain”, nr. 63. Di ta hapësh derën me kod?

- Di, di.

- Do ta hapësh me këtë kod Apartamenti, kati i dytë, dera përballë ashensorit.

- Po e përsëris, ju lutem, mos ta harroj.....

- E shikon, e ngatërrove që tani! Jo,; po

- Në rregull. Mirupafshim, atëherë!

Pa arritur te porta e madhe prej druri ngjyrë kafe, me numrin 63 sipër qemerit, mbaja në dorë letrën me adresën e shkruar dhe kodin e portës. Kodin nuk e përdora. Para meje hyri një vajzë, siç dukej, banore e atjeshme, dhe unë u futa brenda pa arritur të mbyllej porta, të cilën vajza e harroi, ose, e la hapur pa e shtyrë aspak. Shpejt u pendova, që nuk e përdora kodin për ta provuar, nëse e kisha shkruar të saktë në letër. Një herë thashë të dilja jashtë, të mbyllja portën dhe të provoja ta hapja me kod, por, nëse porta nuk hapej, kjo do të më detyronte të merrja në telefon, patjetër e bezdisshme për Helenën, ose, Ismailin, kush do të kishte fatin të bezdisej edhe një herë. Pas portës së madhe prej druri ishte një korridor i gjatë disa metra, dhe i gjerë. Në të djathtë ishte hyrja për në ndërtesë. Në katin e parë, kur pashë shkallët rrethore djathtas (më duket prej druri) të shtruar tejet e tej me qilim të pastër sikur nuk shkelte njeri, nuk mora ashensorin. U ngjita shkallëve për të parë arkitekturën e ndërtesës dhe ndonjë objekt të veçantë. Kur u ngjita disa shkallë pashë që më lart nuk kishte dritë. U ktheva mbrapsht.

Sa dola nga ashensori pashë derën përballë. “- Kjo do të jetë”, - thashë. Korridorit edhe këtu i shtruar krejt me qilim. I rashë ziles. Derën e hapi një vajzë me trup mesatar. Pasi më vëzhgoi tiparet dhe

veshjen, siç duket, u bind, që isha shqiptar.

- Urdhëroni! tha.

Ishte e bija, Gresa. Edhe pyetjes - “Si jeni?”, - iu përgjigj, sikurse përgjigjen ata, që janë rritur në Shqipëri. Në të majtë ishte një korridor i gjatë, edhe ky i shtruar me qilim, në fund të të cilit, te dera e dhomës së televizorit, në krye të korridorit, ishte Ismaili. Para se të përshkoja tërë atë korridor, nga një derë përbri tri dyerve të tjera, doli Helena, që më dha dorën. Pa arritur të këmbëj pyetje-përgjigjet me Helenën, dhe ende pa u takuar me të, nga larg Ismaili, tha:

- Po ti, pse nuk vete te *Fayard*-i. Mos do që ata të të lutën për materialet, që u ke kërkuar!?

Hymë në dhomën e televizorit/ Salon du séjour.

- Ulu, - m'u drejtua, duke më treguar divanin, ku ishte një revistë e hapur, e përthyer, d.m.th., në lexim e sipër. Nuk u ula aty, se mendova që rrinte vetë.

- Një minutë, ja, erdha, - dhe u largua.

Pashë ç'pashë, u ula në divan aty, ku më tregoi, pasi, më tutje divanit, në krye ishte një kolltuk rrethor me shilte të bardhë, në pamje tepër e butë, që kuptohej nga rrudhat e thella e të shumta të bezes së saj.

Pas pak erdhi me një dosje.

- Merri këto materialet, - tha, dhe u ul në vendin e vet të butë.

Helena më pyeti:

- Ç'dëshiron të pish? Uiski, martini, apo, përmendi disa pije të tjera.

- Ç'të duash, se këto pije pak i njoh dhe rrallë i provoj.

Ismaili u ngrit përsëri.

- Më prisni pak, dhe u largua.

Kur u kthye, në duar, mbante një kuti kartoni të bardhë, të mbyllur, që ngjante si pako. Pamja e tij me pako në duar m'u duk e çuditshme, madje e pabesueshme. Nuk e kisha parë herë tjetër të mbante peshë aq të madhe.

- Merre! - më tha. Më ke bërë me djersë. Mezi i kam gjetur. Edhe kur i kujtoj më zë koka, sepse ka kaq shumë materialet dhe nuk i di ku janë. Besoj, me këto je i kënaqur.

Hapa pak mbulesën në të cilën, qarkuar gjithandëj, shkruhej *Presse*. Ishin koleksione revistash dhe gazetash me shkrime për veprat e tij.

Prishtinë, e mërkurë, 17 nëntor, 1999

Në orën 18:15 në Pallatin e Rinisë/Pallati i Sportit, ku po hapej Panairi i parë i Librit Shqip, në Kosovë, erdhi Ismail Kadareja,

së bashku me Helenën, Gresën, të bijën e madhe dhe botuesin e veprës së tij, Bujar Hudhri. Dukej i lodhur, tepër indiferent, i hutuar, i përgjumur si një sonnambul, i zbehtë e i ftohtë. Ndoshta, ftohtësia dhe indiferenca iu shtuan nga të ftohtit, që përshkonte sallën e Panairit të Librit, me dyer e korridore nga të katër anët të hapur. I dhashë dorën dhe shkëmbyem vetëm përshëndetjet e rastit. Ismaili, Rexhep Qosja, Dritëro Agolli, Hashim Thaçi etj., u ngjitën në tribunën e foltores. Pas fjalës së mirëseardhjes së shkrimtarit të njohur Nazmi Rrahmani, drejtor dhe redaktor veteran i Shtëpisë Botuese *Rilindja*, foli Ismaili. Foli shkurt, pa letër. Dukej që ishte tepër i prekur dhe i emocionuar. Disa herë tha “jam shumë i prekur, jam shumë i lumtur, që kam ardhur në Prishtinë”, fjalë, që rrallë i përdor për veten e tij. Rrallë i zbulon ndjenjat në biseda me kolegë e miq, kurse, në biseda publike, thuajse, nuk i shpreh asnjëherë. Foli për rëndësinë e madhe të librit shqip. Panairi i Librit Shqip në Prishtinë, tani, pas luftës me Serbinë dëshmon, se shqiptarët janë komb i qytetëruar dhe i kulturuar. Ata besojnë te libri dhe e duan librin, dhe, kështu, u kundërvihen armiqve me dituri, qytetërim e kulturë.

Edhe Helena, të nesërmen, tha, se “ishim shumë të prekur, sidomos nga pritja në aeroport”. Atje kishin dalë mjaft qytetarë për t'i përshëndetur. Atë mbrëmje i bëra disa foto Ismailit nga larg. Natyrisht, në foto ishin edhe të tjerë afër tij: Rexhep Qosja, Nazmi Rrahmani, Dritëro Agolli, Hashim Thaçi, një klerik mysliman.

Prishtinë, e enjte, 18 nëntor, 1999, ora 9:30

Në mëngjes, në restorantin e hotelit *Iliria*, me qenë se ora po shkonte 8:40', fillova të ngutesha, sepse në orën 9:00, në Institutin Albanologjik, fillonte Simpoziumi për 100-vjetorin e Lasgush Poradecit. Mirëpo të tjerët ishin të qetë dhe nuk po lëviznin (Dalan Shaplo, Jani Thomaj, Jakup Mato). Pyeta gjuhëtarin Enver Hysa, përse nuk po nisej asnjë për në simpozium. Më tha se do të fillonte në orën 10:00. Këtë ndryshim të orarit e kishte kërkuar Ismaili. Ai u kishte thënë:

- Ç'është ky simpozium, që fillon në orën 9:00? Unë në orën 9:00 zgjohem nga gjumi. Po nuk e ndryshuat orarin nuk vij fare!

Ismaili erdhi tek Institutin Albanologjik në orën 9:30'. Nëse këto janë të vërteta, duket, se e ka vrarë ndërgjegjia, përdërisa erdhi një gjysmë ore përpara, prandaj, dhe nuk ishte asnjë që ta priste.

Te hyrja e Institutit e takova krejt rastësisht. Kur po mbërrinim tek oborri i Institutit bashkë me time shoqe, Mirën, pak para nesh, zbriti nga makina Ismaili, Helena dhe Gresa. Njerëz të tjerë nuk kishte fare, prandaj, donim s'donim do t'i takonim. Ismaili ishte me humor dhe kishte dëshirë për të biseduar.


- S'jemi parë, që nga takimi grotesk në Tiranë, që nuk u bë, - më tha. Do të bëj një komedi për atë takim grotesk.

- Aq më mirë, - ia ktheva. Ke rast të shkruash një komedi, meqë komedi nuk ke shkruar deri më sot.

- Jo. Nuk do ta shkruaj vetë. Do t'ia jap materialin ndonjë tjetri, - ndryshoi shakanë.

Nuk e mora vesh cilin quante takim grotesk, që nuk u bë. Takimin që kishim lënë në hotel *Tirana* në janar, apo, takimin, që i premtuam njëri-tjetrit në tetor, pa ditë dhe pa orar?

Në janar, kishim lënë të takoheshim në hotel *Tirana*. Do të ishte edhe botuesi i veprës së tij, Bujar Hudhri, dhe vëllai, studiuesi Ferid Hudhri. Ndoshta, ngaqë kishte harruar, apo, nuk e di nga ç'arsye tjetër, Ismaili kishte porositur punonjësin e recepsionit, që të thoshte se nuk ishte në dhomë. Në kafenenë e katit të parë, ne të tre pritëm mbi një orë, pastaj unë u largova. Të



Botuesi Fatmir Toçi, Bashkim Kuçuku dhe Ismail Kadare, Salloni i Librit, Paris

nesërmen, Bujari më tha, se e kishte takuar po atë mbrëmje dhe po në hotel. Ismaili kishte sharë shumë “nuk jeni fare korrektë!”, “le të prisnit atje edhe dy orë! Unë në dhomë isha, ju prisja të më merrnit në telefon”. E, meqë, kur fola me të në telefon, një ditë tjetër, kuptova, se nuk kishte dëshirë ta takoja, e lashë me aq.

Ndërsa, në tetor, ishte zhvilluar kjo bisedë në telefon:

- Ti bën befasisira! Kam kaq ditë në Tiranë dhe nuk ke ardhur.

- Më vjen keq! Këto ditë, që ju jeni në Tiranë, unë kam qenë në Holandë. Dje u ktheva, sot ju telefonova. Po jeni i lirë, sot pasdite, kam dëshirë të vij.

- Pikërisht, sot jam i zënë. Kam një ftesë për diku.

- Po, kur jeni i lirë? Nesër, apo pasnesër?

- Nuk e di. Shqiptarët nuk kanë asnjë program, asnjë orar, punojnë kuturu. Edhe tek unë ashtu vijnë. Më kërkojnë ose më marrin pa një orar dhe m'i prishin të gjitha punët. Këtu jemi, do të kemi rast e do të takohemi.

Megjithëse, ato, që tha ishin të vërteta, mendova mos i kishte pretekst për mos të vajtur. Dhe nuk vajta. Cili ishte takimi grotesk, që nuk u bë? I pari, i janarit, te hotel *Tirana*, apo i dyti, i tetorit, në shtëpi?

Në Institut, për 100-vjetorin e Lasgushit, hyjmë bashkë me Ismailin, i cili qëndroi në presidium. Në pushim, tek ekspozita e piktorit Anastas Kostandini, kushtuar Lasgushit dhe Pogradecit, që ishte hapur në katin e parë të ndërtesës së Institutit, Ismailit, Anastasit dhe dy të tjerëve, që nuk i njihja, u bëra foto, meqë Anastasi, miku im, m'u drejtua mua. Ismaili pranoi të pozonte.

Nëntor 1999

Tek *Onufri* bisedova me Bujarin, se si kishte kaluar Ismaili në Kosovë. Më tha, se ishte tepër i kënaqur dhe me humor. Kishin qenë në dasmën e komandantit të UÇK-së, së bashku me Helenën, dhe kishte luajtur valle popullore.

- Luajti, si gjenerali? - e ndërpreva nga kënaqësia dhe çudia.

- Vërtet si gjenerali, vazhdoi Bujari. Edhe vetë ma tha këtë. “- Ja, një skenë të tillë e kam imagjinuar dyzet vjet përpara”. Edhe Helena ishte çuditur me të. “- Ç'është Ismailin!? - thoshte. Ai nuk ka luajtur asnjëherë valle popullore. Kjo është hera e parë, që e shoh të luajë valle popullore.”

- Cili komandant bëri dasmë, - e pyeta, se UÇK-ja ka shumë komandantë.

- Nuk e di, më duket një Agim. Ishte djalë i ri.

- Edhe në Shkup ishte me humor. E pritën shumë mirë. Vajtëm edhe te *Flaka*. Dha një intervistë të gjatë. Në fillim, në Shkup, kishte bezdi, pastaj u çudit, se e pritën shumë mirë.

Paris, e mërkurë, 22 mars, ora 18:55, viti 2000

Në orën e caktuar i telefonova Ismailit për t'i kthyer materialet, që m'i dha për t'i fotokopjuar.

- Ta gjeta librin, - më tha. Ishte fjala për botimin në hebraisht *Viti i mbrapshtë, Krushqit janë të ngrirë*, të cilin nuk e gjeti pardje, kur isha në shtëpi të tij.

- Më gëzove. Faleminderit! Një gjuhë më shumë në bibliografinë e botimeve.

- Po, shiko! Mos eja tani, se jam i zënë. Eja në 7:30'. Mirë?

Për të kaluar kohën bëra shëtitje qark Kopshtit të Luksemburgut (Jardin du Luxembourg), pasi ishte i mbyllur, ku Kadareja shëtit çdo ditë.

Kur vajta në apartamentin e tij, pas tringëllimës së ziles, u dëgjua zëri i Doruntinës, mbesës: “-Kush është?” E përsëriti dy-tri herë “-Kush është?”. Dhe, kur nuk mori përgjigje, e hapi derën. Në korridor ishte rrëmujë dhe zhurmë. Bujar Hudhri po rregullonte çantat dhe arkat me libra të Ismailit në frëngjisht për t'i marrë në Shqipëri. Atje, në këmbë ishte dhe Ismaili, dhe Helena, kurse Doruntina s'dinte nga të vinte më parë dhe me kë të niste bisedën. Ismaili më dha librin në hebraisht, të cilin filloi ta shfletonte.

- Ja, ku i ke të gjitha të dhënat, që të duhen. I ke të shkruara edhe në frëngjisht, por librin duhet ta hapësh mbrapsht, se këta kështu e fillojnë shkrimin, në të kundërtën tonë. Shtyu syzet në majë të hundës dhe filloi të lexonte.

- Ja, ulu atje, dhe mbaj shënimet. Shiko dhe këto botimet e reja, po nuk i ke parë. Shënoi edhe këto. Pastaj u largua të merrej me librat.

Shkoi dhe solli disa libra në dorëshkrim, që ia dha Bujarit. Njëri, në nja tri volume, ishte studim i një profesori francez, i cili kishte mbrojtur doktoraturën me veprën e Ismailit. Për këtë më kishte folur në Tiranë.

- Po, nuk e dimë, - tha, është korrekte, apo, nuk është, që unë t'i jap ty për t'i përdorur. Sidoqoftë, merri t'i kesh atje. T'i shfrytëzoji, jepua dhe atyre, që janë të interesuar. Krijoi një arkiv me materiale të tilla. Mos i humb.

- Ky libër, është shumë i pasur, - vazhdoi të flasë për librin. Çuditësh ta lexosh. E ka bërë si enciklopedi.

Pastaj më tregoi një punim të një studenteje shqiptare në Strasburg, që kishte bërë një studim për veprën e tij.

- Edhe titullin, sa bukur e ka gjetur! - tha, duke shfletuar punimin.

- Po kjo si e ka bërë, - pyeti Helena.

- Ka punuar, - iu përgjigj Ismaili.

- Po nga i di tërë këto?

- Erdhi më takoi një herë. Më mori leje për të shkruar, pastaj ka lexuar.

Edhe këtë punim, më duket, se ia dha

Bujarit.

- Me ty, m'u drejtua mua, më duket se jam në rregull. Ta kam mbajtur fjalën. Je i kënaqur me këto që të dhashë?

- Më ke ndihmuar shumë. Faleminderit!

- Jo, unë ta di për nder ty. Faleminderit për kaq sa ke bërë!

- Kjo është puna ime profesionale.

Bujari filloi të merrej me librat për t'i vendosur në kuti, prandaj u ngritëm të gjithë për ta ndihmuar. Doruntina merrete libra një e nga një, e dy e nga dy, dhe na i jepte herë njërit e herë tjetrit.

- O, të keqen! Edhe ti mban libra? - i tha Ismaili së mbesës.

Librat i nxorëm nga korridori i shtëpisë në korridorin para ashensorit. Ismaili lëvizte nga korridori i brendshëm në korridorin e jashtëm. Libra nuk mbante. I zbritëm poshtë, e, më në fund, i nxorëm në trotuarin përballë portës së madhe për t'i marrë botuesi Fatmir Toçi, që kishte ardhur në Panairin e Librit, në Paris, me makinën e vet.

U kthyem përsëri, sa për t'u përshëndetur, por, pa e kuptuar u ulëm dhe filluam të bisedonim.

- Këtë herë, - tha Ismaili, në Gjirokastër, dua të shkoj me helikopter (Gjirokastra e kishte shpallur Qytetar Nderi). Nuk e bëj dot rrugën. Një fjalë goje. Po, hajde të gjesh helikopter!

- Nuk është kaq e vështirë, - thashë. Kush nuk ua jep juve helikopterin!? Po nuk ia dhanë Ismail Kadarese helikopterin, kujt do t'ia japin?

- Unë nuk jam mësuar t'i kërkoj askujt. As nuk i njoh.

- Ju njohin ata juve, mjafton t'u thuash.

- E po, e kam të vështirë. S'di kush t'u thotë. Vetëm një njoh, që mund t'u thotë. Atë të Rendit. Ka në dorë ai i Rendit?

- Si nuk ka në dorë. Ai është ministër. Ai jep urdhër.

- Vallë, ka helikopter?

- Sigurisht, që ka helikopter. Po nuk pati Rendi, nuk ka asnjë tjetër. Edhe nëse nuk ka, ai le t'i thotë ministrit të Mbrojtjes. Ministria e Mbrojtjes dhe e Rendit, me sa di unë, kanë helikopter.

Tiranë, e premte, 3 nëntor, 2000, ora 18:00

Më bëri përshtypje, se derën e hapi Ismaili. Zakonisht, e hap Kadria ose Helena. Në shtëpi ishte Ismaili me një kushëri të tij, me trup të vogël dhe me mjekër të varur, të bardhë. Fliste me zë të ulët e të qetë.

- Ky është kushëriri im, inxhinier. Kurse, ky, iu drejtua kushëririt me një seriozitet teatral, është profesor në universitet, kritik, studiues, eseist... U ktheu nga unë, duke qeshur dhe vazhdoi: biograf, bibliograf, ish-gazetar...

- Tjetër, ç'je më pyeti? Mos harrova ndonjë gjë?

- Jo, nuk harruat, por shtuat shumë, - iu përgjigja.

Ishte ora e lajmeve. Ismaili filloi të ndiqte *Zëri i Amerikës* dhe bëri disa komente për fushatën elektorale në SHBA. Pastaj lajmet nga Kosova, dhe përsëri komente.

Erdhi Agim Isaku me të shoqen, Verën. Agimi ishte ambasador në Spanjë dhe tha, se do të kthehej në Shqipëri. Ndër të tjera, Agimi e njoftoi për botimin në Spanjë të romanit *Nëntori i një kryeqyteti* për të cilin ishte shkruar një artikull i gjatë, në një gazetë të Madridit. Njoftimin Ismaili e priti me një lloj bezdie përzier me mërztitje, si diçka, që të lë shije të keqe.

- Unë nuk e dija, që ishte botuar në spanjisht, - tha Ismaili. Kur ma treguan, në Paris, u thashë, pse e keni lejuar botimin, dhe pse nuk më keni pyetur? Po atëherë kishte dalë dhe ishte e kotë. Edhe në frëngjisht, pasi ishte botuar, një ditë më tregojnë një libër xhepi. U çudita. Ai botohet gjithmonë pa dashjen time.

- Pse e keni me kaq mëri?! Nuk është aq, sa për ta pasur mëri. Edhe në të ka disa gjëra ta veçanta.

- Nuk e di, ashtu më është tiposur. Sa herë botohet provoj një shije të keqe.

Biseda kalonte degë më degë.

Verën, siç duket, nuk e tërhiqnin këto lloj bisedash. Asaj i mungonte Helena. Përsëriti disa herë, që pa Helenën shtëpia nuk ka lezet. Pata frikë se mos i kthehej Ismaili. Jo. Pasi na kishte sqaruar, se Helena ishte te tezja e tij, këtë herë shtoi:

- Kur Helena shkon diku, pa disa orë nuk shkulet. Sa orë kanë kaluar, që kur ka shkuar te tezja ime dhe nuk është kthyer? Merreni me mend sa rri, kur shkon te tezja e saj.

Në të vërtetë, ai kishte një siklet të brendshëm. Bisedat i pëlqenin, por lëvizte nga një vend në një tjetër, hapte televizorin, bënte pyetje, komente, si për të kapërcyer ata që kishte në vetvete. Kur erdhi, Helena na pyeti menjëherë, radhazi, ç'dëshironim për të pirë: kafe, çaj, pije alkoolike, madje këmbëngulte, që të merrnim nga diçka. Atëherë, mendova, se ai rrinte me siklet, besoj, nga njëra anë, nga që nuk po qeraste miqtë, punë që nuk e ka bërë ndonjëherë, dhe, nga ana tjetër, e dinte, që miqtë nuk lihen pa u qerasur. Ardha e Helenës e çliroi. Kur i hapi derën Helenës, e cila po fshinte këpucët te rrugica e derës, e priti me shaka, po me ton inati:

- Ç'u vonove deri në mbrëmje? Nuk të mjaftoi dita?

Ne qeshëm.

- Prit, - iu përgjigj Helena, se m'u zu fryma. Pastaj te tezja jote isha.

Kur biseda u shtrua përsëri, Helena rrëfente për tezen e Ismailit dhe çfarë i thoshte për nipin:

- Ai ishte më i rregullti nga të gjithë dhe më i dëgjueshmi. Gjithmonë i linte këpucët te dera. T'i thoshe Ismailit "më orën 9:00 të kthehesh, ai ishte tamam në orën 9:00." etj., etj.

- Të gjitha janë gënjeshtër, - tha Ismaili. Asnjëherë nuk kam qenë i dëgjueshëm, pa le i rregullt. Ç'më thoshte koka bëja.

Tiranë, e mërkurë, 13 prill 2022

Para dy-tri ditësh, kur e pyeta Bujar Hudhrin, se si ishte me shëndet Ismaili, më tha:

- Po, eja takoje. Ke kohë që nuk je takuar me të.

Më dha orarin prej orës 12:00 dhe deri në orën 14:00-15:00 jemi te restorant-piceri *Juvenilja* dhe në shëtitje nga Pylli i Liqenit.

Sot, para se të shkoja, i shpreha dyshimin:

- Mos bezdiset nga ardhja ime?

- Jo, ç'thua! Si do të bezdiset nga ti.

- Si rrini, me maska (vazhdonte ende pandemia e Koronavirus-it), apo pa maska?

- Ismail Kadareja është pa maskë, nuk e do maskën, - tha me nënkuptim. Edhe miqtë i do pa maskë.

Sapo u ula, pasi dhamë dorën, Ismaili m'u drejtua:

- Një orë për të ardhur!?

Unë u ngatërrova nga pallatet, që ndërtoheshin qark *Juvenilja*-s dhe shkova me vonesë. Duke biseduar si keni kaluar dhe si jeni, përsëri, m'u drejtua:

- Je rinuar.

- Jo, thjesht kam shkurtuar flokët.

Ishim përballë dhe me bisht të syrit e shikoja me vërejtje. Dukej që ishte i rënduar edhe psikologjikisht, fliste rrallë, ndonjë shprehje të përgjithshme. Atje gjeta dhe një vizitor tjetër, nga Gjirokastra, profesor gjuhe dhe letërsie, studiues, që kishte botuar një monografi për romanet e Kadaresë dhe mburrej me një libër të stërmadh për origjinën origjinën e gjuhës shqipe, që sipas tij, ishte mbi gjuhët e tjera të botës, të cilin ia dhuroi Kadaresë. Gati një orë, thuajse foli vetëm ai. Ismaili herë e ndiqte bisedën me vëmendje, herë me qetësi, që ngjante, se nuk e perceptonte fare. Duronte me një stoicizëm që nuk ishte në natyrën e tij. Nuk donte ta lëndonte mikun, prandaj dhe heshtte. Më në fund, i mbaroi durimi, dhe, shqiptoi në formë pyetëse:

- Tani çohemi?

Mirëpo miku profesor filloi përsëri nga faktet dhe shpjegimet e veta për gjuhësinë e historinë.

Bujari më ftoi ta bënim bashkë shëtitjen te Pylli i Liqenit, se nuk biseduam asgjë tjetër veç disa replikave me vizitorin tjetër.

- Na trulloso vizitori, - thashë, çfarë torture!

- Fajin e ka zoti Kadare, - vazhdoi Bujari.

- Jo, - ia ktheu ai. - Unë thashë të çohemi, por ti nuk u ngrite.

- Ismailin e shoqëroje ti, prandaj duhej t'ia prisje atij bisedën e pafund, - e plotësova.

U shkëputëm përpara.

Bujari mbante në dorë librin 500-600 faqesh për origjinën e shqipes të vizitorit, që ia kishte dhuruar Ismailit me një përkushtim të gjatë.

- Ku është libri, - u kujtua Ismaili.

- E kam unë në dorë, - iu përgjigj Bujari, por do ta hedh në kosh.

- Jo, e kundërshtoi, si do ta hedhësh në kosh!?

- Ç'e do librin e një budallai? Do ta ruash në bibliotekë? Dhe filloi të lexonte, duke u tallur me titullin e librit me disa terma e fjalë të sajura.

- Nuk ishte budalla, e ke gabim.

- Budalla nuk ishte. Ishte i lexuar,

- ndërhyra. Shpjegimet, pastaj, sipas hamendjes së tij.

Po ngjiteshim rrugës përpjetë mes pyllit. Ismaili mezi ecte, ngadalë, merrte frymë me vështirësi. Kur kaluam afër një kazani mbeturinash, Bujari, si duket, për të provuar deri në fund durimin e Kadaresë, m'u drejtua me shaka:

- Po ta jap librin, meqë e ke më afër koshin, hidhe pak aty.

- Jo, u ngut Ismaili. Nuk hidhet libri.

- Unë nuk hedh libra në kosh, - shpjegova. Edhe kur kam libra, që nuk janë për të qenë, nuk i hedh. Ia jap dikujt, - le ta bëjë ai krimin.

- Ti bën vrasje me pagesë, - interpretoi Ismaili.

- Po e shpure në shtëpi, - vazhdoi me shakanë Bujari, do të lërë Helena pa drekë.

U ngjitëm në një rrugë me ndenjese druri, ku rrinin për pushim sa herë dilnin andej. U ulëm në ndenjese. Bujari po bënte foto. Nga pylli, në një rrugicë, që nuk dukej nga bari, që ishte më i lartë, po dilte një çift.

- Nga vijnë ata? - tha Ismaili.

- Është një rrugë, po nuk duket nga bari ose, më saktë, është një rrugicë ose sokak, siç themi, ne, në Çamëri.

- Edhe ne sokak i themi.

- "Sokaku i të Marrëve", i kujtova, duke pasur parasysh Gjirokastrën dhe *Kronikë në gur* në të cilin është një emërvend ngjarjesh groteske. Me fjalën *sokak* është një këngë arvanite e bukur.

- Si është? - pyeti.

Nisa të recitoj:

Në sokak të ngushtë,

ku na mbloodhi hera...

Gërqishten e dinje,

dhe vazhdoi Ismaili:

s'më dhe kalimera,

e përfundova unë:

S'më dhe kalimera,

moj, t'u mbilltë dera.

- Këtë, *moj, t'u mbilltë dera*, nuk e di, - tha.

Kur bënte foto Bujari, kaloi një çift tjetër.

- Shiko, këtej, - i tha Kadaresë, se po të marr në foto, mos shiko femrat.

Kaluam në bisedë për ata, që shkruanin kundër tij.

- Mirëpo, me këto që thonë e shkruajnë, - tha Ismaili, krijojnë opinion, që del edhe tej Shqipërisë.

- Është e vërtetë, që përhapet edhe jashtë Shqipërisë, e kam parë vetë, me Lankshin dhe zonjën Erika Camaj, kur më kishte ftuar

në shtëpi. Ia kam treguar, që atëherë Bujarit. Ata donin një botim të plotë e me standard të veprës së Camajt, pasi edhe unë iu kisha shpjeguar domosdoshmërinë e botimit të saj, sepse nuk kishte për studentët, studiuesit e profesorët, të cilët e gjenin me vështirësi. Më pyetën cili ishte botues cilësor. Ju shpjegova, se më i përshtatshmi për Camajn dhe kërkesat tuaja, është *Onufri*.

- Po ai është nën urdhrat e Kadaresë, - u ngut me sinqeritet Lankshi. - Mendoni, se nuk do ta pengojë?

- E shikon, si përhapet opinion i keq? - ndërhyri Ismaili.

- Nuk mund të marr përsipër qëndrimin e Ismailit, - u përgjigja. Di që ai vlerëson çdo shkrimtar të vërtetë. Kam bindjen, se botimin e Camajt do ta mbështesë dhe përkrahë.

- Ku e bazon këtë mendim e bindje?

- Ndër të tjera, edhe te një intervistë e shkurtër, që ka dhënë te *Zëri i Amerikës*, kur Camaj ndërroi jetë. Aty e ka vlerësuar lart. Mund të ketë dhënë mendime edhe gjetkë, të cilat unë nuk i di. Për këtë u bindën me botimin e krijimtarisë së tij në dhjetë vëllime, pikërisht, nga *Onufri*, dhe Ismail Kadareja, në parathënien e vëllimit të parë, ka dhënë vlerësimet më të larta për të.

.....

- Edhe Camaj ka shkruar për ju, vite më parë.

- Çfarë thotë?

- Për *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Romani i eshtnave.

- Si?

- Romani i eshtnave/ i eshtrave. E quan ngjarje në letërsinë shqipe. E para herë, që një shkrimtar, në Shqipërinë e sotme, del nga standardi formal.

- Ku mund ta gjejmë, - u hodh Bujari.

- Është botuar te *Shejzat*, në Romë, në vitet 1960. Më lehtë, e gjen tek *Enciklopedi kadareane*.

Rrugës në kthim, deri ku hipi në makinë, përsëri biseda vazhdoi për Camajn. Bujari më kërkoi diçka për tek *Exlibris*, meqë e dinte, se punoja me letrat e tij.

- Kam një studim psikolettrar, nisur nga letrat. Ta jap më vonë, jo tani.

- Me shumë dëshirë do të lexoja letrat e tij, - ndërhyri Ismaili. Dhe shkrimi juaj është intrigues. Do të doja ta lexoja. Të marrim vesh ç'bëhet. Për të tilla kemi nevojë.

I premtova se do t'i dërgoja shkrimin Bujarit, sa për ta lexuar Ismaili. Edhe disa nga letrat, të cilat ia dërgova në mbrëmje.



Kumti i zi

Dita e parë e muajit korrik, e nxehtë që në mëngjes. Në orën 9.23 minuta, në celularin tim vjen një mesazh. Më shkruan një miku im që më shkruan shpesh (i palodhuri Begzat Baliu) dhe nuk ngutem ta hap. Kur e hapi, ç'të shoh: "U largua nga kjo botë Ismail Kadare". U shtanga. Nuk e prisja. I kishte kaluar të 88-at; kishte rënë fizikisht, por nuk dukej se ishte kaq pranë vdekjes. (Më vonë marr vesh se vdekjen ia kishte shkaktuar një hemorragji cerebrale). Sakaq ia kthej mesazhin mikut: "Më duket e pabesueshme", kurse ai, si për ta mbështetur befasinë time, më "replikon": "Javën e kaluar ishte në Juvenilia".

Kështu e mësova unë lajmin për vdekjen e shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare, veprën e të cilit e kam quajtur vite më parë (kur Kadareja u shpall "Doktor Nderi" i Universitetit të Prishtinës) "emblemë e kulturës kombëtare".

Pothuajse në të njëjtën kohë, në orën 9.49, kryetari i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave, Fatos Tarifa, në grupin AKADEMIA në WhatsApp, shkroi: "Pikëllim i madh. Ismail Kadare u nda nga jeta sot në mëngjes. Një humbje e madhe për kulturën shqiptare dhe për krejt kombin shqiptar. Këtë pikëllim të thellë nuk gjej fjalë ta shpreh. Ngushëllimet më të sinqerta Helenës dhe familjes së tij".

Menjëherë pas kumtit të Fatosit nisën të reagojnë anëtarët e Akademisë: Emil Lafe, Llukan Puka, Arben Baboçi, Marenglen Spiro, Fatos Tarifa (përsëri), Aleksandër Xhuvani, Ksenofon Krisafi, Arjan Gjonça. Shkrova edhe unë, shkurt, dy fjali: "Ditë zie kombëtare. Do të jetojë vepra e tij e madhe". Kaq për fillim.

Vazhduan reagimet e anëtarëve të tjerë: Anila Papparisto, Kujtim Çashku, Eno Koço, Marta Muço, Luljeta Bozo, Ethem Ruka, Gëzim Hoxha, Diana Çuli, Rami Memushaj.

Të gjithë shprehin pikëllimin për humbjen e Kadaresë dhe vlerësimin për veprën e tij.

Pritet reagimi i prof. Qosjes, që është pjesë e "grupit". Doli të nesërmen. Një tekst i shkruar me kujdes, siç e do momenti dhe siç di autori i tij. Ngushëllime familjarëve, veçanërisht "shumë të nderuarës e të dashurës Helenë", të bijave të shkrimtarit dhe të tjerëve. Pason fjalët "emri dhe jetëshkrimi i tij do të jenë të gjithmonshëm" dhe paragrafi ku thuhet: "... mes Ismail Kadaresë dhe meje kohë pas kohe ka pasur edhe gjykime e vlerësime polemike si pasojë e pikëpamjeve tona të ndryshme për çështje të ndryshme letrare dhe kulturore në përgjithësi".

Dija dhe përvoja e kolegut të letrave dhe bashkëmoshatarit të Kadaresë, Rexhep Qosjes, gjen një formulim të përshtatshëm për ta justifikuar përplasjen e ashpër të vitit 2006 për identitetin e shqiptarëve, por edhe disa fërkime të tjera, më të vogla, më herët dhe më vonë:

"Në letërsinë evropiane është bërë historike bindja e pranuar prej krijuesve më të shquar evropianë se ata që polemizojnë me njëri-tjetrin ata polemizojnë sepse e duan dhe e nderojnë njëri-tjetrin". (Fjala e Qosjes mirëpritet në Tiranë: botuesi i Kadaresë, Bujar Hudhri, e përmend si shembull pozitiv në një debat televiziv).

Por jo të gjithë e kanë kulturën dhe edukatën e intelektualit të madh dhe njëherësh edhe kritikut të madh të Kadaresë, Rexhep Qosja, i cili di ta përmbajë veten kur duhet; shumë të tjerë, letrarë, publicistë, analistë apo edhe njerëz të thjeshtë nuk arrijnë ta bëjnë këtë: shajnë edhe në ditët e mortit, duke shkëlur çdo normë morale dhe njerëzore.

Vazhdojnë mesazhet dhe telefonatat, kryesisht nga gazetarë, që janë vënë në garë kush të sigurojë sa më parë ndonjë njohës të veprës së Kadaresë. Ndër të parët më thërret

Shënime në formë ditari

TRI KËNGË ZIE PËR
KADARENË

Nga Agim Vinca

gazetarja e kulturës e Televizionit "21", ish-studentja ime, Edona Demaj. Pranoj pa ngurrim dhe në kohën e caktuar, në orën 16, ngjitem në katin e 18-të të godinës së re të "21"-shit, ku shkoj për herë të parë. Rugës më vijnë në mend vargje të Kadaresë, fragmente nga veprat e tij në prozë, copëza ngjarjesh, emra personazhesh, ndërsa kur arrij në qendër të qytetit, te hoteli "Grand", më përfton një imazh nga "Krushqit janë të ngrirë": parulla e përgjysmuar "sova publ", që në të vërtetë ishte kërkesa kryesore e demonstratave të vitit 1981: "Kosova Republikë", për të cilën shkohej në burg.

Ish-studentja ime më pret me buzëqeshje. Nuk e kam parë një kohë të gjatë, dy-tre vjet, në mos më shumë, por duket bukur edhe tani që është bërë nënë e tre fëmijëve. Ka lindur tre djem, "drenicakë, profesor", thotë me shaka; "luftëtarë të lirisë", ia kthej unë. Nesër ata mund të bëhen "dalzotësit e Kosovës", togfjalësh që Kadareja e përdori kur doli në skenë UÇK-ja. Uroj të mos ketë nevojë dhe që fëmijët e Edonës e të krejt Kosovës, të rriten në paqe e liri, siç do të donte shkrimtari ynë i madh, që me fjalën dhe veprën e tij luftoi për lirinë e Kosovës.

Në studion e rregulluar bukur flas për veprën e Kadaresë, për temat, idetë, mesazhet dhe risitë që solli ajo në letërsinë shqipe. Për poezinë, prozën, veçanërisht romanet, pa harruar as esetë. Para se të dal nga shtëpia marr me vete, për ilustrim, edhe disa libra, ndër të parët që më zë dora: vëllimin poetik "Shekulli im", botim i vitit 1961, që bëri kthesë në poezinë shqipe; një botim të "Gjeneralit" në frëngjisht në edicionin "Livres de poche" (Libër xhepi) të vitit 1970, me një kopertinë tejet sugjestive (kapela e gjeneralit me kryqet e varret në vend të fytyrës); ditarin "Ra ky mort e u pamë", dhuruar nga vetë autori me autograf, me një shkrim gati të palexueshëm, në panairin e parë të librit në Kosovën e

posaçliruar: "Agim Vincës, miqësisht, për kujtim të takimit në Prishtinë. 29. 11. 1999, Ismail Kadare"; romanin "Dimri i madh", i cili, bashkë me "Koncertin", janë "romane-epope" e jo romane të tipit "sintezë", si të tjerët, si dhe librin "Bisedë përmes hekurash", që është një bashkëbisedim i shkrimtarit me veprimtarin dhe politologun e shquar Ukshin Hoti, i cili pas liritimit nga burgu shumëvjeçar në maj të vitit 1999 u zhduk pa gjurmë dhe as sot e kësaj dite nuk dihet se ç'ndodhi me të.

Që paraparë që biseda të zgjaste gjysmë ore, por zgjati rreth 45 minuta, duke u shndërruar gati në ligjëratë si dikur në fakultet.

Kur zbres nga ndërtesa e bllokut që i ngjan një Manhattan-i shqiptar, shoferi i Televizionit "T7" më priste në makinë. Ora i afrohet pesës, por ende bën shumë vapë. Përtoj boll, por, megjithatë, i përgjigjem ftesës, shkoj edhe në këtë televizion, që është pak më larg se të tjerët. Në studion e gjerë më del përpara një fotografi e madhe e Kadaresë dhe një gazetar trupimët, por i zgjuar. Ky, ndryshe nga kolegja e tij e "21"-shit, më shumë se për letërsi është i interesuar për raportin e shkrimtarit me politikën. Studioja është e freskët dhe biseda rrjedh lirshëm. Flasim, ndër të tjera, edhe për Konferencën e Rambujesë, më konkretisht për takimin e Hashim Thaçit me Kadarenë një natë para nënshkrimit të Marrëveshjes.

Vetë Kadareja flet për këtë takim te Ditari i tij për Kosovën, në shënimin e dt. 18 mars. Kryetari i delegacionit shqiptar të Rambujesë, Hashim Thaçi, e kishte barrën më të rëndë për vendimin që duhej të merrej: nënshkrimin e Marrëveshjes për Paqe e Vetëqeverisje në Kosovë, si quhej zyrtarisht, e cila e linte Kosovën nën sovranitetin e RF të Jugosllavisë (Serbi/ Mali i Zi) me një "autonomi substanciale". Një natë para se të merrej vendimi, Hashimi, i shoqëruar

nga Ramë Buja dhe përkthyesja Bukurie Gjonbalaj, nga Kështjella e Rambujesë shkon në Paris. Bisedojnë kokë më kokë, pa praninë e askujt. Duke mos pasur me vete as edhe një copë letër, e interpretoj këtë takim sipas kujtesës. Kërkon përkrahjen publike të Kadaresë dhe ai i thotë se kjo nuk do të mungojë. Me atë rast përmenda fjalën "tradhtar" (a më mbron nëse më shpallin të tillë), për çka reagoi njëri nga ish-anëtarët e delegacionit nga radhët e UÇK-së, Xhavit Haliti. Askush nuk mund ta dijë se çfarë kanë biseduar "kokë më kokë" Kadareja dhe Thaçi njëzet e pesë vjet më parë. Por shënimi vijues në Ditari, i datës 19 mars, tregon se rreziku i shpalljes "tradhtar" ishte real. "Urime për tradhtinë!" i drejtohet dikush njërit nga anëtarët e delegacionit pas nënshkrimit të Marrëveshjes (shih: "Ra ky mort e u pamë", f. 49).

"Zeka" ndoshta ka të drejtë, por asnjëri nga njerëzit për të cilët bëhet fjalë nuk mund të na ndajnë "davanë", sepse njëri është në Hagë, në një gjyq farsë, kurse tjetri në varr!

Komemoracioni i zbehtë dhe sulmet në mort

E martë, 2 korrik. Në orën 10, në Institutin Albanologjik, mbahet mbledhje komemorative kushtuar Kadaresë.

Nga frika se nuk do të gjej vend shkoj 10-15 minuta para, gjë që e bëj rrallë, por kur arrij shoh vetëm 3-4 vetë në sallë. Habitem jo pak, por zë vend dhe pres. "Vijnë më vonë", them me vete, mirëpo zhgënjehem keq: as gjysma e sallës nuk mbushet dot, as një e treta, madje edhe fotelet e rendit të parë mbeten bosh.

"Kohë pushimesh", thotë dikush. E vërtetë, por kafenetë e Prishtinës janë plot, edhe ato në afërsi të Fakultetit Filologjik dhe të Institutit Albanologjik. As punëtorët e institucionit ku mbahet mbledhja nuk janë të pranishëm. (Marr vesh se para tri-katër ditësh, po në këtë sallë, njerëzit kanë ndenjur në këmbë për një folklorist lokal).

Po atëherë përse bëhet fjalë: mungesë organizimi, rënie e interesimit, apo bojkot? Nuk di si ta shpjegoj këtë që ndodhi sot. Ra ky mort e u pamë!


Nga autoritetet shtetërore merr pjesë vetëm Ministrja e Arsimit, zonja Arbërie Nagavci dhe askush tjetër.

Flasin ushtruesi i detyrës së drejtorit të Institutit, dr. Lulzim Lajçi, historian dhe studiuesit e letërsisë Emin Kabashi e Arben Hoxha. Fjalët i kanë përgatitur mirë, me përkushtim, secili nga aspekti i vet, por flasin para sallës pothuajse të zbrazët, që të trishton.

Një ditë më parë, më thirri sekretari shkencor i Institutit dhe kërkoi nga unë që të mbaja një fjalë. "Të jeni në panel", u shpreh ai. "Jo, i thashë, unë do të vij të marr pjesë, por për të folur duhet të flisni ju vetë".

Pas mbarimit të mbledhjes, gazetarja e RTK-së më kërkoi një deklaratë për emisionin e lajmeve. Me të është edhe kolegu i saj nga "Koha Ditore". Flas para kamerës, pak i indinjuar për shkak të përshtypjes që më la tubimi i sapokryer. Nuk më kujtohet krejt çka thashë, por e di se fjalja e fundit qe: "Kadareja krijoi një perandori të madhe letrare".

Në mbrëmje, në orën 20, marr pjesë në një debat në KTV, me regjisorin Agim Sopi, njëri që e kupton letërsinë e që shkruan edhe vetë dhe dy të tjerë. Moderatorja e hap emisionin me fjalinë e një analisti nga Tirana: "Ismaili iku, mbeti Kadareja", në kuptimin iku njeriu mbeti vepra. Për ne në Prishtinë, në ndryshim nga kolegët tanë në Tiranë, ai ka qenë gjithmonë "Kadare" e jo "Ismail". Disa, madje, kanë pasur problem t'ia shqiptojnë drejt emrin dhe mbiemrin, punë theksi, kurse një kritik letrar i revistave e quante: "Smajl Kadarja". Edhe në zi lejohet të bësh pak humor, por biseda në studio është serioze. Edhe më "serioze" e bën



insistimi i moderatores te raporti ndërmjet “dy gjirokastritëve të mëdhenj”, si thotë: diktatorit Enver Hoxha dhe shkrimtarit Ismail Kadare.

Përpiqem ta kthej vëmendjen kah vepra, por pa sukses. E si mund të zhvillosh debat për letërsinë me njerëz që poezinë e konsiderojnë pjesën më me vlerë të veprës së Kadaresë (!), pohim që do ta skandalizonte vetë shkrimtarin; që te “Gjenerali” gjejnë “elemente distopike” dhe që veprën publicistike “Mëngjeset në Kafë Rostand” e quajnë roman?!
Kur dëgjon këso qyfyresh pendohesh që ke shkruar në emision, por është vonë.

E pashmangshme është pyetja për Çmimin Nobel, refren. A e mori, pse s’e mori, pse s’ia dhanë; a e ka merituar? Autorja e një emisioni letrar në një nga TV-të e Tiranës, thotë: “Kadareja vërtet nuk e mori Çmimin Nobel, por mund ta fitojë në të ardhmen!”. Sic! (Për ata që mund të mos e dinë, ky çmim u jepet vetëm shkrimtarëve të gjallë).

Varrimi (i përkohshëm) dhe fjala e përzishme

Të mërkurën ndjek në TV ceremoninë funebre për Kadarenë dhe fjalimin e KM Rama. Fjalimi i Ramës ishte fantastik. Askush nuk mund të shtyhet me të për fjalime, sepse Edi, para se të hynte në politikë, ishte artist dhe eseist. Edhe fjalën e ka shkruar në këtë frymë: “Ismail, nuk mund ta marrësh me mend se ç’më panë sytë këto ditë për funeralin tënd”. Flet për novelën që do ta shkruante po të ishte gjallë ai që është në arkemort lidhur me propozimet që i paskëshin ardhur atij si kryeministër për vendprehjen e përvetshme të Kadaresë. (Më i pranueshëm m’u duk propozimi për t’u varrosur te parku buzë liqenit, pranë vëllezërve Frashëri, Abdylit e Naimit, si dhe Konicës e Mid’hatit; emrat e këtyre të fundit Edi i shmangu në fjalën e tij).

Më ngeli në kujtesë fjalja: “Erdhi, shkroi, iku”. Dhe tjetra: “Ti i the të gjitha”. Por përfundimi nuk më pëlqeu. Jo se nuk e dua poemën e famshme të Majakovskit “Re me pantallona”, këtë vepër fantastike të poetit të madh rus, të përkthyer nga Kadareja i ri, por pse në gjithë atë korpus letrar kadarean a nuk mund të gjendej diçka e përshtatshme - dhe origjinale - për këtë rast?! Ja, për shembull, një strofë nga vjersha “Monologu i të vetmuarit”: “Tani unë ngjitem lart dhe s’kam asnjë gëzim./ Këtu ku kam arritur më ftohtë është, më vetmi./ E dija këtë gjë, por

padurimi i vdekur/ Më shtynte te ky cak të mbërrij, te kjo kotni”.

Ismail Kadareja do të varroset përkohësisht në varrezat e Tufinës. Kjo do të thotë se një ditë do të zhvarroset (vetë ideja e zhvarrimit është makabre; thuhet: “mos m’i lëkundni eshtrat!”) për t’u rivarrosur në atë “shtëpinë e vetme”, “vetëm për të”, që s’dihet ku do të jetë dhe si do të duket! Po e shoqja, zonja Helenë, ku do të prehet kur t’i shkojë pas “Is-it të saj”? Mos, vallë, bashkë në këtë jetë, veç në tjetrën?! Absurd! (Qeveria shqiptare është dashur të mendonte për këtë qysh më parë, ashtu siç duhet të reflektojë edhe në të ardhmen).

Te poema “Tirana në dimër” (2005) flitet për Tiranën e kohës kur kryebashkiak i saj ishte Edi Rama; në të Edi është personazh. Ja si shfaqet figura e tij në një nga strofat e poemës. “I gjatë, si natë e ankthshme n’udhëkryq/ Shfaqet mes brymës kryebashkiaku”. Në asnjërin nga veprat e periudhës “post” të Kadaresë, as tek ato në prozë (“Lulet e ftohta të marsit”, “Aksidenti” etj.), nuk është dhënë me aq forcë atmosfera e tranzicionit të egër shqiptar. Në mënyrë danteske përshkruhet një ditë e qytetit që shkërben Nju-Jorkun, ku blihen me para titujt kont e baron dhe ku porositen vrasje me pagesë. Çka s’ndodh brenda një dite, nga mëngjesi në darkë, në këtë qytet-fantazmë!

Në Kosovë sot është ditë zie. Radio emeton muzikë funebre. Tre funksionarët më të lartë të shtetit: presidentja Osmani, kryeministri Kurti dhe kryeparlamentari Konjufca janë në sallën e TOB-it, por askush nga institucionet arsimore, kulturore dhe shkencore të Kosovës, madje as nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe PEN Qendra, dy asociacionet letrare të Kosovës.

U dëgjuan shumë pasaktësi e shtrembërime këto ditë, madje edhe gjëra qesharake. Në lajmet kryesore të orës 19.30, gazetari i RTK-së, që raportin nga mbledhja përkujtimore e Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Kosovës (ASHAK), thotë se këmba e Kadaresë shkeli për herë të parë në Kosovë në vitin 1980 (!), ndonëse kjo ka ndodhur plot tetë vjet më parë, në vitin 1972, kur Teatri Popullor i Kosovës vuri në skenë “Gjeneralin” e dramaturgëzuar në regji të Piro Manit. Kadareja erdhi në premierë dhe ky qe takimi i tij i parë real me Kosovën, të cilën me imagjinatë e kishte vizituar shumë herë. (Vjersha e parë për Kosovën daton nga viti 1968).

Por padituria falet, pafytyrësia jo. Ç’tu bësh atyre që shajnë, për turp, në ditën e



KADAREJA YNË

Nga María Rocés González

Për qytetarin dhe personazhin Kadare kam kujtime të mjegullta të periudhës time shqiptare (1980-1984), periudhë veçanërisht problematike dhe e vështire për të, por e shoh veten time, mbi të gjitha, duke mbrojtur me vendosmëri veprat e tij të anatemuara nga regjimi enverist. Për veprimtaritë letrare të Kadaresë në Madrid, nuk e di më, në këtë pikë, nëse ruaj kujtimet e mia apo i kam marrë hua nga Lizarralde, por ngjyrat vijnë e theksohen, dhe e shoh në disa raste të rrethuar tërësisht nga lexuesit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth leximeve të tij. Dhe përsëri në Tiranë, tre momente: prill 2009, me Ramón Sánchez Lizarralde në shtëpinë e Kadaresë dhe, më vonë, pas vdekjes së Ramonit në korrik 2011, në dy takimet në kafenenë e Liqenit, me një Ismail Kadare të mbushur me zgjuarsi, pasion dhe bujari.

Pra, pas më shumë se katër dekadash bashkëjetese të ngushtë me të dhe me pesëdhjetë prej veprave të tij të përkthyer në spanjisht, jam absolutisht dakord me atë që tha Sánchez Lizarralde (Çmimi Kombëtar i Përkthimit në 1993) kur Kadare mori, në tetor 2009, Çmimin Princi i Asturias, për rrugëtimin kadarean të të dyve: *Ajo që filloi si një imperativ me karakter etik: të kontribuojë këtu për të përgënjeshtruar imazhin e deformuar që ekzistonte për atë çka po ndodhte në Shqipëri, përveç një lloj përmblylje të një rrugëtimi jetësore: të bëjë të njohur atë që patëm mundësinë të përjetonim personalisht, u shndërrua me kalimi e kohës në një përvojë intelektuale dhe emocionale të një lloj tjetër: duke ndjekur Kadarenë në përshkuam të njëjtën udhë si Bajroni çalë nëpër shtigjet midis Tepelenës, Gjirokastres dhe Janinës; kemi shoqëruar korrieret e kokave nëpër rrugët që lidhnin Stambollin me Ballkanin; kemi kaluar natën në Bujtinën shqëtesuese të Dy Robertëve dhe kemi pritur vdekjen e pashmangshme në një kullë izolimi. Kemi vizituar tunelet e tmerrshme të Pallatit të Ëndrrave dhe kemi ndjekur lundrimin e tyre të ethshëm nëpër viset e ashpra të Shqipërisë gjeneralët dhe priftërinjtë që ngrinin të vdekurit nga amshimi i lagësht i varreve e tyre; kemi ndarë vetminë e netëve me patriotë të marrë, ushtarë të çartur dhe rapsodë të një kohë tjetër që recitojnë litanine e tyre dramatike ndërkohë që kundrojnë me mospërfillje fytyrën e gurtë e të pandryshueshme të maleve. Kemi pasur mundësinë të zbres në skëterra të tjera që nuk i njihja dhe të udhëtojmë hipur mbi kuaj të drejtuar nga të vdekur...*

I dashur Ismail, i qoftë dheu i lehtë!

1 korrik 2024
Soto de Agues (Asturias)

mortit, siç vepruan vite më parë një skotë lakesh edhe me “Bacën” (Adem Demaçin).

Degradimi ynë moral kurrë s’ka qenë në këtë shkallë!

Me ndonjë nga paraqitjet e mia në medie në këto ditë zie, u ndava totalisht i pakënaqur. Të bombardojnë me mesazhe e telefonata gjatë tërë ditës, kërkojnë të lidhesh me scype dhe kur vjen koha të dalësh në ekran nuk je interesant, sepse flet për veprën letrare! Interesante është kolegja e gazetares, që flet për një takim të rastit me shkrimtarin në Paris – në një katedrale (jo në “Notre-Dame”)!
Për ikjen e Kadaresë nga kjo botë, kombi shqiptar mbajti tri ditë zi, dy në Shqipëri, një në Kosovë. Tri ditë zie për shkrimtarin që është, veç të tjerash, autor edhe i një vepre me titull: “Tri këngë zie për Kosovën”.

Kur doli kjo vepër, në vitin 1998, bëra një shkrim me titull “Beteja kadareane e Kosovës”. Si në të gjitha veprat me sfond historik të Kadaresë në të gërshetohen kohët, vendet, epokat. Mjafton të citojmë një paragraf nga ky libër, për të parë si bashkëjetojnë beteja njëditëshe në mesjetë dhe lufta e fundshekullit të njëzetë:

“Copëra të grisura gazetash, të hedhura nga shtegtarët, lëvizin nga era aty-këtu. Prej tyre qëllon që marr vesh, atë çka ndodh përreth. Emra vendesh e vezirësh befasues. NATO. R. Cook, Magdelain Albright. Ploja e fëmijëve në Drenicë. Millosheviç. Mein

Kampf. Prapë emri i vezires grua. Herë-herë midis tyre është edhe emri im: Murad I”.

Është monologu i Sulltan Muratit rënë gjashtëqind vjet më parë në Ballkan, që rëndon mbi “Gadishullin e madh”, i cili “U gdhi Evropë e u ngrys Azi”. Libri i Hitlerit “Mein Kampf” (Lufta ime) pranë emrit të diktatorit serb Millosheviç sugjeron karakterin fashist të regjimit të “kasapit të Ballkanit”, kurse shfaqja e emrit të sekretares së shtetit të SHBA-ve, zonjës Ollbrajt, e cilësuar me stilemen origjinale, tipike kadareane “vezirja grua”, nënvizon rolin e saj në zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Fluturimi letrar i Ismail Kadaresë si shkrimtar filloi në vitin 1961, me librin “Shekulli im”, ku me një zemërim majakovskian poeti i ri u ngrit kundër konvencave në art dhe në jetë. Dy vjet më vonë, ky libër u pasua nga vepra që e bëri të njohur në botë, romani “Gjenerali u ushtrisë së vdekur”, vepër me një rekord botimesh e përkthimesh dhe nga i gjithë korpusi i tij letrar, i krijuar në vite e dekada, që i dha vulën letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Kadareja foli me shekullin e vet, që shekujt të flasin për të. U bë shkrimtar universal duke qenë dhe mbetur thellësisht shqiptar. Nëpërmjet veprës së tij bota e njohu Shqipërinë dhe shqiptarët, kurse shqiptarët e njohën veten dhe botën.



Fotografi e vitit 1999, në Panairin e Librit në Prishtinë.

të, kishte botuar romanin "Darka e gabuar", ishte viti i largët, 2008, dhe unë prisja një autograf, pa e menduar që ai të më njihte në atë mori njerëzish e të shkëmbente ndonjë fjalë, por ndodhi befasia, ai më foli me dashamirësi, një gjë që mua më habiti. Dhe këtë libër tani e ruaj si një vlerë të paçmuar.

IV

Gjatë ditëve të para të korrikut të ikjes së tij, po lexoja anë e kënd botës lajme për vdekjen e tij, vlerësime e epitete dhe ndërkohë kthehesha te librat e tij, pranë të cilëve ndieja sërish atë gëzimin e lexuesit ri të dashuruar pas veprës së tij.

Shkrimtari Kadare vërtet kishte ikë, në anën tjetër, si të thuash, të gjumit, të heshtjes, të vdekjes. Që në ditën e parë pas ikjes së tij, bëra një ekskursion në jetën time dhe thashë me vete: sa e varfër do të ishte bota ime, bota e brezisë sime, pa librat e Ismail Kadaresë, një gjë që e kisha thënë disa herë. Dhe m'u kujtua një shkrimtar, po ashtu i madh, Milan Kundera, që thoshte diku se një libër i ndaluar në vendin tënd, kishte më shumë vlerë se miliarda fjalë që vjellin universitet tona.

Dhe unë isha rritë në një klimë ku librat ishin të ndaluar, bashkë me shkollat, universitetin, asokohe, kur Kosova, si një tregim zie, ishte futë nën thundrën e egër të pushtimit serb dhe unë i pushtuar nga ankthi e paqartësia, kërkoja shpëtim te librat dhe përmes veprës së Kadaresë nisa të udhëtoja shtigjeve të letërsisë, të udhëtoja nëpër Shqipëri, tashmë kisha parë qytetin e gurtë dhe Kështjellën e pamposhtur të Shkodrës, atë kështjellë që kishte zënë hapësirë të madhe në mendjen time, ku thyeshin e rrokshmjat dhe e parrokshmjat, realiteti e imagjinaria.

Ajo që më kishte magjepsë pafund te Kadareja ishte raporti i tij me lexuesit, sidomos me lexuesit e veprës së tij, me lexuesit e ri, të cilët i çmonte, si pjesën themelore të letërsisë, pa të cilën, shkrimtari nuk ia dilte. Në këso çaste, ai dukej se zbriste prej Olimpikut dhe bëhej krejt i përzemërt, fliste qetë e shpjegonte kujdesshëm, duke kërkuar fjalën e zgjedhur, për çdo gjë që thoshte, me kujdes dhe klas të lartë.

Kadareja e kisha takuar edhe në raste tjera, por mbaj si të përzemërt një takim, së bashku me familjen time, bashkëshorten Editën, Luisin e Izabelën, në qershor të vitit 2021. Ishte një ditë e bukur. Fëmijët kishin lexuar vepra të Kadaresë dhe kjo gjë e gëzoi, madje edhe për faktin se fëmijët me vete, kishin marrë dy libra të tij për autograf, gjë që e entuziazmoi Shkrimtarin për të na dhuruar një bisedë shumë të bukur dhe të paharrueshme.

V

E kisha pohuar në shumë raste se Ismail Kadare ishte bërë pjesë e jetës sime, që në moshë të re, kur isha pesëmbëdhjetë vjeç, ato vite të egra, kur në Kosovë gjithçka ishte e mjegullt dhe e paqartë, përveç librave, që më ngjanin në shandanë drite atyre këndeve të errëta të jetës, të atyre udhëve që ndërrojnë emra dhe kontrolloheshin nga policë të egër serbë. Dhe atëherë e kisha kuptuar forcën që kishin librat e mirë, në të vërtetë, ata ishin ilaç kundër marrëzisë e kundër shtypjes.

Asokohe, Shqipëria kishte dalë prej errësirës komuniste, kurse Kosova kishte hyrë në natën e errët, do të thoshte vetë Kadare, ishte kapërdirë nga regjimi i egër hegjemonist serb, i cili e kishte lidhë një popull të tërë në litarin e robërisë. Kadareja ndërkohë kishte ikë në Paris dhe prej aty bënte një punë madhështore, që ky litar të hiqej prej qafës së popullit të tij, për të cilin shkroi e u angazhua pareshtur.

Asokohe, isha lidhë shpirtërisht me Shqipërinë, e doja Gjirokastrën e Shkodrën, Lezhën e Tiranën, ndonëse nuk i kisha vizituar deri pas luftës së Kosovës së vitit 1999, dhe kjo ishte një çudi që mendja zor e rrokte. Po, Shqipërinë e doja përmes dashurisë që kishte mëkuar në mua letërsia, për çka vepra Kadaresë kishte meritën kryesore.

Dhe sot, një falënderim qiellor për të!

Prishtinë, 08.07.2024

VERA E FILLESËS SË NJË MIQËSIE

Nga Prof. Dr. Diana Kristo



Ishte ndoshta vera e vitit 1967 ose 1968, kur Shqipëria sapo kishte filluar të dalë paksa nga makthi i Tacibao-ve dhe në vend kishte filluar të frynte një puhizë e lehtë liberalizimi, kur takova për herë të parë, fare rastësisht, Ismailin dhe Helenën, në plazhin e Durrësit.

Ndërsa po prisja në hollin e hotelit Kruja që të zbriste kushërira ime, më zunë sytë Helenën rrëzëlluese, e cila tërhiqte vëmendjen e të gjithëve. Sytë tanë u takuan; ashtu e çiltër dhe e shpenguar siç është ajo, mu afrua dhe ndërkohë iu drejtua Ismailit, "Ismail, shiko sa e bukur është kjo vajzë," duke më ledhatuar faqen. "Është vajza e Alqi Kristos (në atë kohë im atë ishte drejtor i Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri"), vazhdoi pasi mori përgjigjen nga unë se e kujt isha. Gjithë qejf, u afrova, u ula në kolltukun midis të dyve dhe kështu filloi një bisedë e këndshme njohjeje. Më vonë, duke qeshur e ndërprerë njëri tjetrin, ata më treguan historinë e dashurisë së tyre, letrat e Helenës, përgjigjet apo mospërgjigjet e Ismailit, etj. Frymëzim për mua ishte këmbëngulja e Helenës.

Pas dy ditësh, pas një shëtitjeje të shkurtër në breg të detit, Helena propozoi të shkonim në hotel Adriatik, por donte të kthehej në dhomë për t'u veshur. Të tre shkuam në dhomën e tyre dhe Helena "na përzuri" në ballkon sa të vishej. Poshtë ballkonit po kalonte një vajzë e gjatë dhe unë thashë, "Sa e gjatë dhe e bukur është." Ismaili mu kthye, "Të vjen keq që nuk je e gjatë?" "Po," i thashë, me gjysmë zëri. "E di si thotë një proverb francez," më tha, "parfumi më i mirë ruhet në shishe të vogla." Gjithnjë gjente diçka për të thënë në çdo situatë.

Të tre shkuam në hotel Adriatik, ku në tavolinat bosh shkruhej "rezervuar". "S'paska vende," tha Ismaili. "Jo," i thashë, "ja ku ka," duke i treguar një nga tavolinat "rezervuar". "Mund të ulemi këtu, nuk thotë njeri gjë për ty." Edhe sot e mbaj mend ngurrimin, një fare droje apo frike në sytë e tij. Mendoja se duke qenë në shoqërinë e atij çifti të dëgjuar, mund të na shtrohej tapeti i kuq përpara. Por nuk ishte kështu. Ismaili e ndërte spektrin që gjithnjë i vërtitej mbi kokë.

Ato pushime vere shënuan edhe fillimin e një miqësie të çiltër me bazë diskutimet e gjalla për letërsinë kontemporane nën këndvështrimin filozofik të kohës, për autorët për të cilët i shprehnim mendimet tona nën zë. Këto diskutime, shpesh të shoqëruara me citime nga autorë të ndryshëm, që filluan nën rrezet e diellit të plazhit të Durrësit, e që vazhduan vite me radhë, e tërhiqnin fort Ismailin.

Ismailit gjithmonë i pëlqente të ishte në shoqërinë e të rinjve të lexuar, me të cilët mund të diskutonte lirish për rrymat e reja në letërsi, art dhe veçanërisht për bisedat filozofike lidhur me autorët e huaj, kryesisht ata francezë që kishin bërë epokë. Ne i dëgjonim gojëhapur komentet e tij, të cilët kapërcenin kufijtë e gurtë partiakë dhe linin të fluturonte përfytyrimi i lirë. Në atë periudhë kam diskutuar edhe "Përbindëshin" me të. Unë e përfytyroja përbindëshin si atë demonin shpirtkeq moguai të folklorit kinez që për pak na gllabëroi edhe ne në Shqipëri, duke ndezur aspektet më të errëta të natyrës njerëzore. E Ismaili ishte plotësisht dakord me këtë dimension të ri përfytyrimi. Biseda të tilla të rrezikshme i bëja gjithnjë haptas me Ismailin, duke pasur besim intuitiv te ruajtja e sekretit, që ka qenë gjithmonë reciprok.

Nuk më kujtohet fare filmi, por një herë, të tre shkuam në kinema Partizani. Filmi, si gjithmonë, paraprihej nga një dokumentar për fitoret e socializmit ose për Enverin. Atë ditë, rastisi që dokumentari ishte për Enverin, duke treguar një nga kongreset ku ai përqafoi një nga fëmijët dhe sytë iu mbushën me lot kur ata brohorisnin "xhaxhi Enver...". Ismaili u kthye nga Helena dhe pëshpëriti aq sa ta dëgjoja dhe unë, "çrregullim i personalitetit histrionik a personalitetit antisocial".

Kur doli libri "Dimri i vetmisë së madhe" në vitin 1973, s'kisha shumë që isha emëruar në ATSH si përkthyes. Aty punonte një daktilografiste e shkëlqyer që e shfrytëzonin edhe ata të Zërit të Popullit. Pipi Mitrojorgjit, kryeredaktorit të Zërit, ajo i kishte daktilografuar një artikull ku ai e ngrinte në qiell romanin, por nuk arriti ta botonte sepse u ndërrua shumë shpejt

pllaka. Atëherë kursehej shumë letra, kështu që ai i dha daktilografistes të daktilografonte artikullin kritik për librin, të shkruar në fletët e prapme të artikullit lavdëruar. Në epokë të tillë rronim.

Aty nga viti 1981, do të zhvillohej një kongres rinie në Nju Jork, në të cilin do të merrte pjesë edhe një delegacion shqiptar. Helena më mori në telefon dhe gjithë gëzim, me dashamirësinë që e karakterizonte, më tha: "Do të shkosh në Nju Jork me Ismailin. E pashë emrin tënd në listë." Ajo kishte parë emrin Diana, por nuk kishte vënë re mbiemrin. Fatkeqësisht, nuk isha unë, por një Diana nga rinia e Korçës. Megjithatë, sapo u kthye, Ismaili më mori në telefon dhe më tha se kishte qenë në një shfaqje në Broadway dhe se kishte marrë edhe biletat me vete dhe mezi priste të m'i tregonte. Broadway ishte ëndrra e të gjithë të rinjve, dhe ai e kishte realizuar atë për të gjithë ne. Sa herë shikoj shfaqje në Broadway më kujtohen biletat e Ismailit.

Në një nga diskutimet në orën e leksionit lidhur me veprën e Ismailit, një nga pedagogët na tha se Ismaili ishte frymëzuar nga Heminguei dhe se në veprat e tij tingëllonte stili i tij. Unë fluturova drejt e te Ismaili dhe i tregova për çfarë ishte diskutuar. Ai u përgjigj, "Ky s'paska lexuar fare letërsi." Ismaili ishte një lexues i zjarrtë, i pandalshëm. Pas botimit të librit "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur" në Francë, Shtëpia Botuese Hachette i dërgonte Ismailit arka pa fund me libra, të cilat ai vinte i merrte në Librin Ndërkombëtar ku punonte mamaja ime. Ajo, si strikte e paepur që ishte, nuk më lejonte as t'i prekja, "Janë të Ismailit", thoshte. E kjo vazhdoi deri sa erdhi një ditë Ismaili e më tha në sy të saj, "Merr çfarë librash të duash dhe sa të duash. Unë kam kaq shumë". Unë kaq doja, të parin mora The Catcher in the Rye të Salinger dhe pastaj me radhë libra të Camus, Sartre, Proust e të tjerë autorë të shquar. Në retrospektivë e kuptoj se nuk ishte fjala vetëm për mua. Ai e dinte se ato libra do të kalonin dorë më dorë, duke hapur horizonte të reja për shumë nga ne të rinjtë.

Thellësinë e veprës së Ismailit e kam kuptuar, ose më mirë e kam përcaktuar, pasi lexova George Mounin, semioticien e gjuhëtar francez, i cili është marrë dhe me përkthimin. Ideja e tij është që kuptimi i një fjale nuk mund të merret në izolim, por duhet të qëmtohet në shtresëzimet e ndryshme të kontekstit. Kuptimin e plotë të një fjale e gjen në kontekstin e një fjalie, në fjalët e tjera që e rrethojnë dhe strukturën sintaktike; kuptimin e plotë të fjalisë e gjen në një paragraf, i cili ofron një kontekst më të gjerë, në tonin dhe qëllimin që i japin formë interpretimit të fjalisë; kuptimi i paragrafit qartësohet në kontekstin e një faqeje të librit, rrjedha e së cilës të bën të kuptosh paragrafët në vijimësi; kuptimi i faqes çmohet më shumë brenda kontekstit të të gjithë librit, tema, narrativa, struktura e narrativës dhe objektivat e të cilit ndikojnë në atë se si i interpretojmë faqet e librit; vetë libri duhet të shihet brenda kontekstit historik dhe kulturor të një epoke të caktuar, mjedisit social, politik dhe kulturor në të cilin u shkrua libri, gjë që ndikon në tematikën, gjuhën dhe mënyrën se si pritet e çmohet vepra. Pra kuptimi i vetë librit shtrihet e përfshin të gjithë spektrin e civilizimit njerëzor.

Po kështu, edhe kaleidoskopin magjepsës letrar të Ismail Kadaresë, këtë burim frymëzimi artistik e jetësor për breza që ikin e vijnë, e kupton më thellë kur ke njohuri të thella të epokës që lamë pas, me të mirat e të këqijat e saj, të traditave historike, kulturore, zakonore të vendit, brenda kuadrit të zhvillimit të kulturës botërore, të zhvillimit të mendimit njerëzor në përgjithësi.

Korrik 2024
Massachusetts, USA

Lajmin se Kadare ndroi jetë ma dha im të vëllës Fredi në orën dhjetë të mëngjesit të datës 1 korrik. Nuk e besova, pata një mpirje. Pas pak mora një mesazh nga kunati im nga Athina në Viber ku mediati shqiptarë njoftonin ikjen e gjenit të letrave shqipe nga një atak zemre. Mjerisht lajmi ishte i vërtetë. Sfidanti e madh të diktaturës komuniste e kishte tradhëtuar zemra. Morti ngjan shumë më i hidhur kur ndodhesh larg. Atë ditë i kredhur në pikëllim piva një kafe të hidhur si gjithë miqtë e dashamirësitë e Kadaresë. Mendimi i parë ishte të kërkoja agjensitë e ndryshme për të mbyllur një biletë për Tiranë. Mu kujtua vdekja e nënës në 15 gushtin e vitit 2007. Kishim mbetur me vajzën në aeroportin e Athinës 24 orë rresht duke vështruar qiejt me mërzë të pafundme dhe ankthin se nuk do të arrijmë në varrim. Në pamundësi të shkoj për të hedhur një grusht dhe për të vënë një buqetë mbi varr homazhin do t'ia bëj më mirë këtej, thashë dhe publikova në mediati greke 19 poezi nga 60-70 që kam përkthyer nga krijimtaria e tij poetike. Dhe homazhi tjetër një memorial nga takimet e fundit me gjenialin Kadare.

Çdo udhëtim ka befasi dhe magjinë e vet. Vera e 2019-tës ishte treguar mjaft bujare dhe zemërgjerë me të papriturat e veta. Ishte pasur me invente dhe kishte ruajtur befasi me miq sublimë dhe njerëz të dashur që kishim gati 30 vjet pa u takuar që kanë lënë mbresa të pashlyera në kujtesë.

Pas ftesës për pjesëmarrjen katërditore në simpoziumin e pestë ndërkombëtar të Korinthit "Letërsia në udhëkryqet e botës" (aktiviteti i natës së katërt i referohej veprës sime) e diela e katër gushtit vinte si një ditë me aureolë feste. U nisëm nga Gjirokastra unë, ime shoqe, Athinaja, miku im i jetës dhe i letrave Ihanas Dino dhe ish nxënësi im në shkollën e mesme, miku Cezar Kotoni. Në orën 12 kishim takim me Kadarenjtë në vilën e tyre në Qeret, të Mali i Robit mes pyllit me pisha vigane, 200 metra larg detit. Mesazhin e kisha marrë që vitin e kaluar. Kur isha në Tiranë në majin e vitit 2018 në promovimin e antologjisë poetike "Metamorfozë Qytetesh" të poetit qipriot Mihalis Pieris të përkthyer prej meje. Një nga dëshirat supreme ishte dhe takimi me I. Kadarenë. Por për fat të keq nuk munda ta realizoj këtë takim se nuk ishte kthyer ende nga Parisi. Ishte një dëshirë e zjarrtë si ajo që më kish pushtuar në udhëtimin tim të parë në Greqi në mars-prill të 90-tës për të takuar poetin e madh grek Jani Ricosin. Por sëmundja dhe ikja e tij nga jeta nuk ma dhanë mundësinë duke më lënë një breng në shpirt. Nuk duhet ta lija rastin të më ikte nga dora. Vjet, një ditë para se të largohesha nga Gjirokastra kishim folur në telefon me zotin Ismail dhe i kisha kërkuar lejen për përkthimin e veprës së tij poetike në gjuhën greke. Dhe mesazhi ishte dhënë: Kur do të vish në Tiranë? Nuk e di me siguri, ndoshta verën e ardhëshme, thashë. Dua të të takoj patjetër. Të presim, tha. Dhe ja ku erdhi kjo verë dhe gushti me dozën e fatit për këtë takim sa nostalgjik aq dhe të dëshiruar pas gati 30 vjetësh. Thanasi organizoi takimin dhe ja ku ndodheshim përpara vilës së tij në orën 12 pa pesë. Gjatë rrugës diskutonim se sa do të zgjaste, sa do të rrinim duke pasur parasysh kohën e papështatëshme të drekës. Gjysëm ore sa pihet kafja, e shumta një orë. Dhe diskutimet u prenë me befasi nga celulari i zonjës Helenë që pyeste: sa veta jeni. Ismaili ju fton për drekë. Nuk mund të ndodhte ndryshe.

Ai gjiganti i letrave që rallë i shprehte me mimikë ndjenjat, "sfinks ballkanas" e kishte qajtur një gazetar anglez i BBC-së që adhuronte veprën e tij kur ishim takuar rastësisht në Nikosia në librarinë "Solonion book Center" ku punoja dhe kish pyetur cili shkrimtar i huaj modern lexohet më shumë këtu, Markes, Kadare, Kudara, dhe fikcioni novelistik anglez i kishte thënë zonja Adrianë. Librarja që mbulonte librin angjisht i tha se këtu punon dhe një mik i Kadaresë. Mik i Kadaresë? U habit ai. A mund ta takoj, pyeti. Ndënjën gati një orë duke biseduar për Kadarenë. Për librat e tij të përkthyer, për stilin, për ekologjinë e miteve dhe legjendave shqiptare e ballkanase, për pasurinë gjuhësore, për ironinë dhe metaforën, për arsenalin e punës krijuese. E

MEMORIALE NGA TAKIMET E FUNDIT ME KADARENË

Nga Petro Çerkezi

kishte takuar në Paris shkrimtarin e madh dhe kishin bërë një bisedë të gjatë e gati nervoze. Ajo për të cilën interesohej veçanarisht gazetari anglez ishte çështja Serbi – Kosovë dhe pyetjet që i bënte ishin intriguese. Në një moment shprehu një mendim që e iritoi tepër Kadarenë. "Nën Sërbinë Kosova do të jetë më e mbrojtur dhe do të zhvillohet më shpejt, se sa po të jetë e pavarur. Kush do të japë fonde për zhvillimin e saj? Do të jetë më mirë nën dhunën policore dhe me burgje, e kishte ironizuar Kadare që nuk e njihte konformizmin dhe e kishte shpartalluar gazetarin me një debatim të ashpër me argumenta duke ju sulur si me shpatë skenderbejane. I thashë Ismailit në telefon për këtë takim. Nuk isha kaq i ashpër, tha duke qeshur në telefon. Thjeshtë i thashë ato që duhen. Dy gjëra me kanë mbetur nga biseda me aglezin, "Kadareja, sfinks ballkanas, është polemist i papërbalueshëm dhe zemërimin e ka ballkanas, Olimpik si Zeusi". Kështu ishte Kadareja portreti i tij shprehte pak, por bluante dhe akumulonte shumë, kishte një zemër të butë dhe njerëzore dhe nuk i harronte miqtë e vërtetë.

Trokasim në derën e hapur me një emblemë bronxi si ato princëroret me kalanë e Gjirokastrës të gdhëndur mbi të. Hymë, kaluam hollin dhe u ulëm në verandën e qetë ku na mirseardhi zonja e shtëpisë me një finesë sa mondane aq edhe të thjeshtë, sa njerëzore aq edhe me ngarkesë emocionale, mikpritëse, gazmore me një fisnikëri absolute, siç e kam njohur përherë pa të cilën do të ishte e cinguar madhështia e shkrimtarit gjenial. Deti përtej ngjante si i dehur tek rrokulliste dallgët me rrëmujë. Një simfoni, muzikë freskie në këto ditë të nxehta gushti "sikur zbriste Vjosa", siç tha Ihanasi. Ismaili veshi xhakëtën verore ngjyrë kafe me katrorë në holl dhe doli. Takimi me sfidantin e madh ka përherë diçka enigmatike. Është ndoshta nga magjepsja që të krijon vepra e tij monumentale. Tani qëndron para nesh monument i gjallë dhe megjithë se i ka mbushur 83 vjetët nuk e tregon aspak moshën, biseda aq sa ka gjallërinë ka dhe një paqësim si me hyjnitë olimpike. Ai është mendjekthejllët dhe mendjemprehtë i paparashikuar në bisedë, siç e mbaj mend në të gjitha takimet tona. Sa kohë pa u parë, pyet tek përqafohemi. 30 vjet, i them, që nga 89-ta, para azilit, para demokracisë. I takon me radhë Thanasin, time shoqe, Cezarin. Megjithëse Cezari është adhurues i veprës e tij dhe ka qënë disa herë në takime dhe biseda në Gjirokastër nuk e sjell mirë ndër mend.

Po ju kush jeni? pyet. Tashmë ka rrjedhur shumë ujë dhe patriarku i letrave shqipe, është një shkrimtar i papërsëritshëm që e nxori letërsinë shqipe në arenën evropiane dhe botërore. Shkrimtari me një forcë të jahstëzakonshme vizionare me një vepër konceptuale me dimensione e vlera universale. Dikur një shkrimtar grek që kish lexuar mjaft vepra të Kadaresë kur mësoi se kisha pasur afinitet me të më pyeti: Ku e gjeti fuqinë titanike ky njeri të shdrohet në fenomen e të bëjë një kërcim të jashtëzakonshëm nga një qytet i vogël provincial e të pushtojë universin botëror? Megjithëse i rreshtova shumë fakte me bazë talentin e tij të rrallë ndjeva se ikte me mangësi. Për shumë njerëz që e njohin thellësisht krijimtarinë e tij përgjigja është të verpa. Për të tjerë mbetet pa përgjigje. Ç' rol luajti për mendjen e këtij djaloshi të hjahthëm e rebel Gjirokastra kështjellore me gurë gri piramidale që të dalë nga sokakët labirintikë si ai i të Marrëve, ku mençurinë e ndan një fije floku me marrëzinë e të ngjitet si yllësi e pashuar në qiellin e letërsisë kontemporane? Ku e gjeti guximin të krijojë një vepër me gjerësi homerike dhe dramacitet eskilian që i vuri minë të fshehtë me plasje të vonuar piramidës së diktatorit demoniak që kish lindur 500 m më lart në lagjen Palorto? Besoj se vepra e tij nuk lë shkas për dyshime. Një talent i madh i kalibrit Kadare e gjen përherë rrugën drejt lirisë dhe shpirtit njerëzorë edhe kur liritë janë të përndjekura, të cinguar e të burgosura. Besimi dhe dashuria kapërcen gjithçka.

Gjithsecili mund të përfitojë dije, duke u zhytur në bibliotekat më të pasura të botës, dije enciklopedike madje, por askush nuk mund të fitojë talentin me asnjë lloj diplome, të mësojë të ndjejë dhe të shkruajë, edhe po të kapërcejë pragun e universiteteve më famozë të botës. Talenti lind. Ai është gur themeli për një shkrimtar. Dhe Kadare diti ta zhvillojë talentin e vet në kushtet e një sistemi totalitar nga më të egrit në planet. Kur përvetëson dije bëhesh dikush tjetër dhe mund të pretendosh katedra të ndryshme. Kur ndjen dhe e percepton botën me fokusin ndjesor je vetëm vetvetja, vetvetja që ndriçohet me një dritë projektore të veçantë mbi piedestalin njerëzor. Dhe Kadare është vetvetja dhe vendi i tij amë dhe krijoi Kadarejadën e kohës sonë. Me veprën e tij madhore që ka fuqi ipnotizuese janë shkruar me saktësi matematike në të, fantazia, realiteti dhe memorja historike. Që të jesh vetvetja në një botë që lufton natë e ditë

të të tjetërsojë duhet të japësh betaja të ashpra dhe shpesh herë vetmohuese. Dhe këto beteja i dha dhe i fitoi shkrimtari ynë".

Një pyetje sa e natyrshme, por po aq bezdisëse dhe rutinore që përsillej tunduese në atmosferën e verandës dhe e menduar ndoshta nga të gjithë hidhet befasi në trapez: ç'po shkruani? A mundesh mos ja bësh një pyetje të tillë shkrimtarit të madh?

-Asgjë, thotë, s' kam ndonjë peng, s'do shkruaj më dhe ngre supet.

"I menduar gjer në çast të fundit, Nga mosthënia, nga pengu tragjik" më gjëmon në vesh si një dallgë që ngjitet gjer në tavolinë të përgjeshtrorë përgjigjen. Nuk e besojmë gjithsesi. Ismaili rrallë i tregonte planet e tij. Ishte në metodën e tij krijuese.

I përmend një thënie të Hemingueit në një intervistë: "Kur shkrimi është bërë pathos vetëm mortja mund ta ndalojë".

"Prandaj vrau veten Heminguei se s'mund të shkruante më", përgjigjet. Qeshim të gjithë. Duke hyrë silueta e Thanasit i ngjau si hijeligu Stalin "pamundësia e pafundme dhe ogurzezë" që Stalini të shfaqej midis nesh dhe biseda vazhdon për diktatorin paranoik Enver Hoxha. "Kur sunduesit grinden" që ka qarkulluar para një viti. Prova e përgjeshtrimit, thashë. Duhet zbrëthyer figura e tij, thotë Ismaili, duhen gjetur rrënjët e së keqes. Po shkruaj, po hulumtoj, thotë Thanasi. Figura e tij e mallkuar është e pranishme në jetët tona. Më vranë në gjumë, më kishte thënë, një shok i gjimnazit. Enver Hoxha vriste me fjalën e tij të bukur. Terror i fshehtë. Bureli – skëterrë. Gjithë Shqipëria burg, shkretëtirë e nëmur. Kur dola nga burgu mendoja se e kishte hak një plumb në zemër ai diktatori gjakpërës. Armën e kisha siguruar, por plani ishte i perealizueshëm se isha vetëm. Të gjithë ishim të kërcënuar, sidomos poetët dhe intelektualët.

Biseda ngrohet, bëhet më intime. Nuk duhen lënë të kalojnë pa u regjistruar këto çaste. Kërkojmë leje të bëjmë foto. Me kënaqësi, thotë Ismaili. Patjetër thotë Helena. Dhe celularët fillojnë punë shpejt e shpejt. Fiksojnë. Pastaj biseda kalon tek Gjirokastra, qyteti i vendlindjes nga është marrë brumi ku zhvillohet teatri dramatik i shumë veprave të tij dhe të shtëpia e re muze në Rugën e Dibrës.

-Janë ekspozuar dorëshkrimet? pyet Thanasi.

-Janë ekspozuar.

-Nuk ka rrezik, janë siguruar, se janë me shumë vlerë.

-Masat janë marrë. Nuk ke ç'bën tjetër.

S'ka dyshim s'mund të egzistojë një shtëpi muze për Kadarenë pa dorëshkrimet dhe reliket e shkrimtarit të shquar.

Biseda vazhdon me drekën. Një drekë në natyrë, mes blerimit, nën hijen e pishave gjigande dhe muzikës së dallgëve. Tani i ka rënë një hije tjetër fisnikërie, hija e arhondit e kryezotit mikpritës të shtëpisë gjirokastrite me pak ruzh në faqe sikur ta ketë makiazhuar një dorë e fshehtë, sikur ta ketë puthur mirësia. E ka makiazhuar bukuria e natyrës, mendova. Ia thashë Thanasit. Dhe prania e miqve, thotë. Ka dy tri lloj verash përpara. Më hedh një gisht në gotë dhe ma zgjat. Provoje, thotë, se ti merr vesh nga verërat. Τέλει, i them



padashur greqisht. Si është, pyet. E shkëlqyer, i them. Dhe m'u kujtua një drekë tjetër. Kisha porositur tek një mik mjeshtër i verës nga Sopiku i Pogonit një pagur me verë dhe duke shkuar në një Olimpiadë teatrale në Tiranë me trupën e teatrit të Gjirokastrës ja çova Ismailit. Të nesërmen më ftuan për drekë. Ku e gjete atë verë kaq të mirë, pyeti Ismaili. Pogoni bën verë të mirë, i thashë, edhe gjyshi im bënte verë të mirë. Dua dhe unë të mësoj cilësinë e verërave. Është bërë manjak i verërave, thotë Helena.

-Ta bëj edhe unë pyetjen që më bëtë ju më tha një çast: Ç shkruan? Pyeti.

Poezi dhe prozë, thashë. Një cikël romanesh. E kam bërë realitet porosinë që më ke dhënë dikur, poezia është ndjenjë, është akuarel i çastit, por nuk të mbush, shkruaj prozë dhe do shpaloset para teje një murale, do pushtosh një mal. Qesh. Kurse Thanasi e kombinon romanin me publicistikën. Ç'u bë me romanin që reçonsonova dikur, pyet. Fle në sirtar, i them.

-Në prozë dhe një ngjarje e zakonëshme merr dimensione të tjera, fjala merr ngjirim dhe pushtet artistik. Kur je larg vendit tënd ta fokuson më mirë temën që do shkruash, ta melodizon nostalgjia, por duhet kujdes se egziston përherë rreziku të kthehet në melo. Pastaj biseda kalon tek gjellërat, tek shijet, tek guzhina Gjirokastrite. Për vapën, për zagushinë politike, për memuarat e Helenës "Kohë e pamjaftueshme". E urojmë duke ngritur dolli. Përmendim autorë të ndryshëm që kanë shkruar kujtime si Lidia Avillova për Çehovin, e gra të tjera për Tolstoin e Dostojevskin. Helena përveç shijes, ka dhe kujtesë të mirë dhe e shfrytëzoi në mënyrë krijuese arkivin. Ora është 4 dhe i bëjmë shënjë njeri-tjetrit se duhet të ngrihem. Koha në këtë takim kaq të çmuar ka rrjedhur kaq shpejt.

-Rrini dhe pak, thotë Ismaili, kushedi kur do të takohemi prapë.

-Rrini, rrini, thotë Helena.

Jo themi, të çlodheni dhe ju, e lodhëm Ismailin. I falenderojmë. Përsëndetemi me Kadarenë që megjithëse nuk e tregon veten, ngjan disi i mallëngjyer. Helena na përcjell gjer tek sheshi ku kemi parkuar makinën. Kthehet kokën, shohim vilën dhe vazhdojmë përshypjet në makinë duke u kthyer për në Gjirokastër.

Kanë kaluar 5 vjet nga takimi i 4 gushtit 2019 dhe ja ku ndodhem sërish në Tiranë për një promovim të vëllimit antologjik të poetit turkoqipriot Mehmet Jasin që kam përkthyer në shqip dhe dy librave të mi poetikë që ka botuar kohët e fundit Naraida. Dhe sikur ta dinin sa e dëshiroja një takim me Kadarenë botuesit Jani Malo dhe Bujar Hudhri e kanë organizuar sërish.

Atë ditë të 9 prillit duke ecur rrugëve të Tiranës për të shkuar te Kafe Juvenilja për të takuar Kadarenë ndjeja të m'i rrëmbente këmbët një hov valleje dhe pas ndarjes të m'i grackonte një parandjenjë e keqe, mjaft trishtuese. Ora e kishte kaluar 12-tën. U takuam me Ismailin dhe me Bujarin, porositem kafe dhe filluam bisedën. Petro Çerkezi, i tha Bujari me të shoqen e mban mend dhe botuesi Jani Malo. Tundi kokën me një ravijëzim buzqeshjeje. Këta grekët Petrua e Thanasi dhe minorarë të tjerë ishin miqtë e tu më të mirë, që të deshën me shpirt, thotë Bujari. Gjatë bisedës u përpoqa të sjell ndërmend ngjarje nga takime të ndryshme për t'i nxitur kureshtjen dhe për ta tërhequr në bisedë. Tundte kokën vetëm. Rrinte mes nesh monumental si gjithmonë dhe me një monumentalitet heshtorje thua se ishte nisur kështu madhështor dhe krenar me një hije perëndie nga ajo kështjellë e vogël e Juveniljes drejt panteonit të përjetësisë. E kishte kapluar një lodhje universale. Të gjitha universale i kishte Kadareja. Universale vepra, jeta dhe heshtja që po e ngjitëte drejt botës së amëshimit. Bëmë disa foto dhe u ndamë me dëshirën e zjarrtë kur të vi nga vjeshta në Tiranë ta gjej krejt të kthjellët me atë llogjikë të çelniktë e befasuese.

Nga takimet me Kadarenjtë kam fotografuar shumë çaste dhe i mbaj në arkivin e kujtesës si brilante. Në vitet 80-të kisha çuar në shtëpinë botuese një libër në gjuhën greke

dhe ma kishin kthyer me vrejten e njohur nuk kishte poezi për partinë dhe shokun Enver. Siç isha i mërëzitur pasi isha grindur me redaktorin u ngjita të takoj Helenën në zyrën e saj në 8 Nëntori. Pasi u përshëndetëm dhe u pyetëm për shëndetin, ç'e ke atë dosje, pyeti. Një librin tim me poezi në gjuhën greke, që ma kanë kthyer, thashë. Kur mund ta takoj Ismailin, pyeta. Eja pasditë në shtëpi, ta takosh, tha Helena. Në orën gjashtë mbasdite shkova në shtëpi, është Petro Çerkezi, tha Helena, e ftova për kafe. Petro Çerkezi, dëgjova dhe zërin e vogëlushes, të Gresës dhe shpejtoi në dhomën tjetër. Tek pinim kafe nxirrte herë pas here vjedhurazi kokën te porta dhe na shihte. Një herë kur kishte shkuar në Gjirokastër, siç më kishte thënë Thanasi Dinua, vinte rrotull te kodra dhe shqiptoi katër herë emrin tim. Në fëmininë time këto dy emra mbaj mend që shqiptoheshin shpesh në shtëpinë tonë, kishte pohuar Gresa. Atë pasdite duke pirë kafënë Helena tha: Ismail e di që Petrua shkruan greqisht. Ka shkruar dhe një libër me poezi. Fakti që njeh greqishten nuk ja ul vlerat Petros, përkundrazi ja shton, tha ai. Po përgatitet një antologji e poezisë greke, ke përkthyer ndonjë poet, do të marrësh pjesë, më pyeti. Kam përkthyer disa, thashë, që nga poeti kombëtar Solomosi, gjer te Ricosi dhe Eliti. Të gjitha këto më kaluan nëpër mend në këtë takim që për fat të keq do të ishte i fundit.

Ora ka kaluar 2. 30. Duke u endur rrugëve të zhurmëshme me botuesin tim dhe time shoqe, ndjeja një ngrirje, një lloj boshësie thua se ajo ditë prilli kishte marrë një plagë. Dyshoj nëse të njohu Ismaili, thotë Jani. Jo, them me këmbëngulje, më njohu. E pe si i shfletosi dy librat që i fala, madje tek njeri lexoi dhe autografin dhe më falenderoi.

Të hënën, më 13 maj pata një bisedë telefonike me botuesin Bujar Hudhri ku e falenderova për botimin e intervistës sime në Exlibrin e së shtunës së kaluar. Jemi si gjithmonë me Ismailin tek Juvenilja, foli Petro Çerkezi i tha duke i dhënë telefonin. Si jeni, pyeta, si është Helena. Helena mirë është, unë nuk jam mirë, m'u përgjegj. Je i fort, i thashë, a i merr ilaçet? Përpara në tavolinë i kam. Në Exlibris kam botuar një intervistë të gjatë, i thashë, një pjesë dominuese e shkrimit flet për marrëdhëniet tona. E di, tha, e lexoi Helena në shtëpi. Lavdi zotit, thashë, më foli quartë si Ismaili i dikurshëm. Po fundi është i pashmangshëm për gjithë të vdekëshmit. Po ky i vdekshëm i madh i kapërceu të gjitha kufijtë me rrugëtimin e tij për së gjalli, kufijtë e regjimit diabolik, theu kodet tradicionale dhe ato letrare të një ideologjie mbyttësë dhe shtypësë obskurante islamo-bizantine, shpërtheu kufijtë e Shqipërisë, të Ballkanit dhe të Evropës dhe arriti në zenith të letërsisë botërore me talentin e madh dhe modernitetin e letërsisë që krijoi. Tani ai u shndrrua në një figurë të shënjtë, pjesë e mitit dhe e legjendave. Na pikëlloi shumë ikja jote, mjeshtër. Të falenderoj thellë që na maturove me fjalën tënde, na lartësoi të gjithëve letërsia jote që do të na bëhet më e lexueshme se kurrë, se je emancipues shpirtëror i kombit dhe i miliona lexuesve kudo në botë. Si në asnjë mort tjetër bajlozët kanë dalë prej stofullës së tyre, kanë dalë prej detit duke përgatitur topuzët me një mëri epokale. Po ti nuk të arrin dot ligësia njerëzore, meskiniteti dhe mediokriteti, mjeshtër.

"...Unë nuk u jap rëndësi më shumë seç duhet xhuxhëve dhe spiunëve. Janë këto qoka (referenca) të mëdha që na kanë mbajtur gjallë. Ndryshe prej xhuxhëve mund të çmendeshim. Ose të bëheshim edhe ne xhuxhër, si ata. Është kjo arsyeja që unë kam falur shumë gjëra. Ti më njeh, unë s'jam natyrë e butë. Veç kësaj, vij nga një qytet që ka qenë shquar për meritë e gjata. E megjithatë, është falja ajo që më ka kthjelluar shpirtin". Thotë në Dialog me Alain Bosquet.

Një ngushëllim i thellë dhe i sinqertë u takon të afërmve të tij, zonjës Helenë, bashkëshortes për ikjen e njeriut të saj të shtrenjtë, vajzave, Gresës dhe Besianës, kurse në të tjerët kemi veprën e tij. Përulemi para teje, mjeshtër!

ENIGMA E NJE VEPRE GJENIALE

Nga Feride Papeleka

Ismail Kadare është autori i një vepre të shquar. Ai është njëri ndër më të mëdhenjtë e letërsisë. Librat e tij më të mirë janë të gjallë e të ndritshëm, ku përzihet në mënyrë të llahartarshme imagjinata dhe realiteti. Romanet e tij, ata që përfshijnë universalitetin e jetës e të historisë duke krijuar një realitet të dytë, që lejon të shohësh bukurinë apo tragjikën e jetës, do t'i përkasin bibliotekës së kujtesës kolektive.

Vepra e tij madhore dhe e çuditshme është dëshmi e gjenialitetit të shkrimtarëve që e kanë revolucionarizuar letërsinë kombëtare, në kuptimin që i kanë dhënë asaj disa cilësi të reja, sidomos duke e harmonizuar dhe sinkronizuar atë me letërsinë botërore, duke e futur në korin e madh të zërave të zgjedhur.

Pavarësisht nga qëndrimet e tij vetjake, vepra e tij pati një jetë të pavarur dhe zbuloi idetë dhe maskat, iluzionet dhe shpresat, dashuritë dhe urrejtjet e njeriut në përgjithësi. Ai u bëri një prerje vertikale pasioneve njerëzore. Megjithëse studioi në Moskë për t'u bërë shkrimtar i realizmit socialist, ai krijoi një letërsi ndryshe, me një lloj stili të lartë dhe me forcë mjeshtërore duke i anashkaluar me zgjuars parimet kufizuese. Ai e ka mrekulluar aq shumë lexuesin kur doli në fillim në arenën e letrave shqipe, sa ta quante ngjarje çdo lexim të veprës së tij. Ai hapi një dritare të re, sidomos në jetën e lexuesit shqiptar.

Me energjinë e tij si shkrimtar i lindur (natus) që mund ta kishte zili çdo krijues, ai solli vepra si *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, *Kronikë në gurë*, *Kështjella*, *Pallati i ëndrrave*, *Muzgu i perëndive të stepës*, *Prilli i thyer*, *Krushqit janë të ngrirë* e ndonjë tjetër si dhe disa ese që i përkasin universit letrar si për Eskilin, Homerin, Shekspirin, Danten, Servantesin... I frymëzuar nga urtia dhe sublimiteti i legjendave shqiptare ai shkroi dy libra të jashtëzakonshëm: *Ura me tri harqe* dhe *Kush e solli Doruntinën*.

Tashmë vepra e tij ka marrë formën e një afresku, me gurë të formave dhe ngjyrave nga më të ndryshmet; ky është imazhi më i bukur i krijimtarisë së tij. Edhe në ka pesimizëm, vepra e tij fsheh një optimizëm real që shpreh besimin te inteligjenca, drejtësia, dashuria dhe bukuria. Ai luftoi kundër së keqes duke i dhënë veprës së tij kuptim të dyfishtë edhe kur u zhyt në të kaluarën historike dhe në fanatistikë, siç edhe e kam shtjelluar gjerësisht në Paris, në vitin 2001, kur paraqita punimin e paradoktoratës « Fantastikja në veprën e Kadaresë dhe Garcia Marquesit » (Le fantastique dans l'œuvre de Kadare et de Garcia Marquez).

Vdekja është gjithnjë mbarimi i ekzistencës fizike, një lloj gjendjeje që i shtang të gjitha zemrat. Nuk mund të thuash se jeta e tij qe e shkurtër. Ajo qe e mbushur kryesisht me punë krijuese cilësore, pavarësisht nga stuhitë politike, zënkat, betejat që përfshijnë në çdo kohë njerëzit e mëdhenj. Tashmë ai ka dalë nga ajo sferë ku ekzistojnë kundërshtimet dhe zilitë. Ai ka hyrë në rrugën që i jep secilit përgjigjen e duhur. Një gjë është e sigurtë: vepra e tij do të shkëlqejë mbi retë që shpesh mbulojnë kokat tona.

Romanet e tij më të mira, u krijuan përgjithësisht nën diktaturë. Kjo është edhe enigma e veprës e që mund të zërthehet me fjalët e një interviste të tij se « Unë njoha më parë letërsinë se lirinë ». Ato kanë « gërmuar » brenda shpirtit dhe zemrës së njeriut duke zbuluar diamante, por edhe greminën që fshihet brenda secilit prej nesh. Dhe sigurisht nga dhuntia e tij natyrore si dhe nga gjenia e tij, ai na la një veper të lartë dhe të qëndrueshme, në lartësitë e së cilës do të shkëlqejë emri i tij.

KADARE U NIS LART PËR NË BULEVARDIN E GJENIVE

Nga Bujar Skëndo

Ju i ngritët vetes një memorial planetar me veprën gjeniale të përkthyer në gjuhët e shtatë miliardë banorëve të tokës. Kurse lexuesit tuaj ju ngritën një memorial "jo duarsh", por fryme e shpirti, të lartë deri në qiell, pikërisht aty ku të presin gjenitë botërore. Fqinjërovo në këtë jetë me Eskilin, humbës i madh, me Danten e pashmangshëm, me Shekspirin e Hamletit, princit të vështirë, me Servantesin e Don Kishotit. Dhe, po ashtu, me Xhorxh Oruellin e Franc Kafkën, të cilët ua kujtove shpesh tërë lexuesve të tu.

Dhe do fqinjërosh sërish atje lart me të gjithë këta, në Bulevardin e Gjenive, ku vendin e nderit e mban, prej 2500 vjetësh, gjeniu i verbër, vetë Homeri...

Askush prej jush atje lart nuk ka marrë me vete asnjë nga kryveprat e veta. Asgjë. Gjithçka e latë dhuratë në tokën mëmë. Të gjitha kryveprat tuaja, bashkë me dhimbjet, gëzimet, triumfet ua latë lexuesve tuaj. Si një peng? Si një testament suprem? Trashëgimi hyjnore, pa asnjë dyshim, më e çmuara, më e shenjta që njerëzimi ka qysh kur jeta ka lindur në këtë planet të bekuar.

Është tamam sikundër e keni thënë ju. Nuk quhet vdekje. Quhet "jeta jote pa praninë tënde në botë". Po, është vepra jote gjeniale që jeton nëpër gjenerata e shekuj dhe që në kopertinë mban emrin KADARE!

Kjo është aleanca që gjeniu dhe letërsia e tij gjeniale bën me jetë- vdekjen. Dhe me vdekje- jetën. Prandaj, ndoshta, ke thënë se nuk të tremb vdekja. Ke "zbritur" disa herë atje në Ferr për të zbuluar ëndërrat kriminale të diktaturës komuniste, duart e gjakosura deri në bërryla të "pashallarëve të kuq"... Por edhe sepse jeta këtu lart shpesh kishte qenë më ferr se vetë Ferri.

Luftëtar i lirisë! Gjeni i fjalës së shkruar artistike. Krijues i një vepre voluminoze gjeniale. Njeri i Madhërishtëm. Njeri Krenar. Mik i Pashembullt.

Republika e letrave sot është në zi!

Në pamundësi të një paraqitjeje tërësore të gjithë krijimtarisë letrare të Besnik Mustafajit dhe duke mos pasur synim që të jepet ndonjë përshkrim telegrafik i gjithë kalendarit botues të tij, po zgjedh megjithatë të shtroj për diskutim disa teza që ndërlidhen me dy, tre aspekte më tipike të opusit krijues të shkrimtarit Besnik Mustafa dhe të profilit të tij intelektual e qytetar.

I ardhur në letrat shqipe si një individualitet që u krijua në një kontekst të caktuar letrar e shoqëror, fillimisht si poet në vitin 1978 me vëllimin poetik - "Buzëqeshje të gëzuara", pastaj edhe si prozator e eseist, Besnik Mustafaj la gjurmë të pakontestueshme të formimit estetik në prodhimtarinë e tij letrare, por edhe në klimën krijuese së cilës ai i takonte. Grafikoni i formimit të këtij individualiteti ka ndjekur një kurbë që shkonte përtej milieut social, kulturor e shoqëror të ambientit që e rrethonte paraprakisht adoleshentin Besnik Mustafaj, i cili derisa ishte në vendlindje e tij, në Bajram Curr, kishte arritur t'i lexoj gjithë librat e bibliotekës së shkollës, qytetit madje edhe të t'jatis dhe pastaj të riun Besnik Mustafaj, në kryeqytet, në Tiranë, me një ardhje shumë të hershme si poet në letrat shqipe. Nëse i hedhim një sy më përimitues këtij grafikoni nëpër të cilin lëvizimi formimi i individualitetit krijues e njerëzor i Besnik Mustafajit, do të vërejmë një atipizëm që e shoqëronte këtë formim, duke qenë gjithmonë jashtë shablloneve që i diktonte koha. Për ta ilustruar këtë po përmendim vetëm prirjen e tij shumë të hershme qysh në moshën fëmijënore për të lexuar letërsi për të rritur, siç ishte, bie fjala përvoja me leximin e romaneve "Lufta dhe Paqja" të Tolstoit, apo "Madam Bovari" të Gustav Floberit. Për rëndësinë e këtij të fundit Besniku kishte kuptuar vetëm atëherë kur e kishte lexuar për here të dytë në original gjatë studimeve.

Nisur nga kureshtja e një vëzhguesi që ka ndjekur deri diku vazhdimësinë e punës së tij, kam vërejtur se një cilësi që e ka Besnik Mustafaj, nuk ndërlidhet gjithmonë vetëm me të bërit letërsi, por edhe me ofrimin e një modeli të të bërit qytetari në jetën tonë kulturore e shoqërore. Ai pati oferta qysh i ri të merr poste shtetërore, por refuzoi me bindjen se nuk do ti qëndronte si duhet shtofi i një zyrtari të lartë. Ai madje edhe në fillimet e demokracisë nuk u tundua nga ofertat që iu bënë nga udhëheqja e atëhershme e dalë pas zgjedhjeve të para të lira e demokratike.

Për Besnik Mustafajin, diplomacia, ose marrëdhëniet ndërkombëtare, megjithatë ishte vokacioni më kreativ që nuk do ta detyronte të shndërrohej në një aparatçik shtetëror, por edhe një valvulë që i linte frymëmarrje të lirë për tu marrë me krijimtarinë letrare.

I lidhur fillimisht me ambientin e vendlindjes, të cilin e kishte braktisur shumë herët, shkrimtari Besnik Mustafaj e përdori këtë ambient si përpunim letrar në laboratorin e tij krijues, duke i transformuar disa tope dhe arketipe në minzanska fabulative, qoftë në romane, apo novela, "Dëmtuar gjatë rrugës", "Autoportret me teleksop", apo edhe në ese, siç janë dy librat e tij me këtë zhanër "Midis krimeve dhe mirazheve" dhe "Bishti i Kometës".

I bashkëshoqëruar me gjithë këtë bagazh që ia impononte profili i dyzuar, herë si politikan, e herë si shkrimtar, në grafikonin e formimit si krijues ndërvepruan disa rrethana që në vetvete përbënin atë atipikën që e përmendëm më lartë.

Atipikja e parë, ndërlidhet me kohën kur ai doli autor me një vëllim poetik, qysh si student, atëherë kur bashkmoshanikët e tij nuk e kishin statusin që gëzonte ai në ambientin e atëhershëm letrar. Ky status mbase do t'i siguroj atij parakushte që të zhvillohet si një habitat socio-kulturor në kryeqytet, një privilegj ky që nuk e kishte

Besnik Mustafaj, një laborator aktiv në kërkim të hapësirave të pashkelura krijuese

Nga Emin Azemi

Një shkrimtar mund ta lexosh për efekte argëtimi, por kjo nuk është rruga e duhur për ta njohur atë. Edhe njohja me shkrimtarin Besnik Mustafaj sikur e kushtëzoi lexuesin të jetë më aktiv në procesin receptiv, sepse duke e njohur tërësoren e një shkrimtari, ne mund të valorizojmë edhe cilësinë e tij. Dhe cilësia e shkrimtarit Besnik Mustafaj është rrjedhojë e një letërsie të kultivuar në një laborator që është tepër aktiv në kërkim të hapësirave të pashkelura fabulash e motivesh, që vetëm një shkrimtar me senin e zhvilluar artistik arrin t'i përpunojë në vepra të arrira letrare. Besnik Mustafajin duhet ta njohim edhe më tepër, për të depërtuar në thellësinë dhe gjerësinë e leximit hemanuetik të veprës së tij, sprovë kjo që shkon përtej kësaj qasjeje modeste times.

kushdo nga gjenerata e tij.

Atipikja e dytë - ai filloi të shkruaj prozë, i pari nga brezi i tij që ishin gjithë poet. Për këtë ndoshta duhet faleminderuar Ismail Kadarenë, i cili gjatë një shëtitjeje me Besnikun e kishte qortuar se pse askush nga brezi i tij nuk po merrej me prozë. Sepse, sipas Kadaresë, vetëm në prozë sprovohet pjekuria krijuese, gjuhësore e estetike e autorëve.

Atipikja e tretë - Besniku është ndër politikanët e parë që politikën e braktisi për hir të letërsisë. Ky divorc i letërsisë nga politika, nuk nënkuptonte që ai të kalonte nga kolltuku i një burokrati në një vëzhgues pasiv të zhvillimeve politike në vend. Përkundrazi ai vazhdoi të kontribuojë me opinione e debate mbi politikën, por pa qenë pjesë e pushteteve, sepse, sipas arsyetimeve që ka dhënë Besniku, inercioni i pushtetarit shkon duke marrë përmasat e një makine që lëviz sipas vullneteve që ti diktion dikush tjetër. Me fjalë të tjera pushteti ka disa manire të autodestruktivitetit njerëzor, dhe për rrjedhojë edhe një barrë më e madhe përgjegjësie për punët që jo gjithmonë janë në koherencë me pastërtinë etike të atij që është në pushtet apo afër pushtetit.

Në mendësinë e Besnik Mustafajit, në vendet në tranzicion është heroizëm i madh të besosh në dobitë e shkrimit, aq më tepër kur autoriteti i shkrimtarit matet me aftësinë për të ndikuar të lexuesit në pasurimin e vetëdijes së tij letrare.

Duke qenë midis politikës dhe letërsisë, Besnik Mustafaj këtë status nuk e çoi kot,

por pikërisht atë e ngriti në një referencë krijuese ku do të buronin disa prej dilemave të tij, që përmasa verprave konkrete sikur marrin përgjigjen e duhur. Kështu, bie fjala, të libri "Bushti i Kometës", jo vetëm që triumfon letërsia kundrejt politikës, por Besnik Mustafaj shndërrohet në një gurë peshoreje në sytë e publikut se nga duhet të lëviz ndërgjegjja e shkrimtarit kur ai ndodhet para tundimeve të politikës dhe të pushtetit. Por edhe te romani "Autoportret me teleskop" shprehet më së miri divorci i letërsisë me politikën, vepër kjo që është një produkt i pastër letrar, që vjen pas një heshtje të caktuar krijuese, por që gjithë këtë heshtje ai sikur e justifikon me këtë libër, i cili për shumëçka është unik në mbarë letërsinë moderne shqipe. Madje në këtë roman, autori ka operuar mirë me një gjetje që i shkon më së miri metodës së tij krijuese duke e përdorur politikën si mundësi që ia jep narratori për të krijuar një personazh (homonim) letrar. Por edhe te libri "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin" një prozë kjo krejt e veçantë, ndryshe nga të tjerat, Besnik Mustafaj është vet shkrimtari dhe Besnik Mustafaj personazhi.

Duke iu rikthyer edhe një herë librit "Bishti i kometës" ia vlen të thuhet edhe dy - tri fjalë për rëndësinë e këtij libri në kuptimin më esencial që ndërlidhet me laboratorin e tij krijues dhe sidomos me aftësinë e shkrimtarit për të transferuar gjendje të ndryshme social-psikologjike e shpirtërore nga njëra epokë shoqërore te tjera dhe transformimi në rrugë e sipër i këndvështrimit të autorit

për probleme të caktuara, përfshi edhe lirinë e shprehjes. Në këtë libër, Besnik Mustafaj ndër të tjera flet edhe për dy vizita që i kishte bërë në Paris, një në kohën e diktaturës, në vitet e fundit të saj, dhe tjetrën në kohën e demokracisë. Përjetimet nga këto dy vizita janë të ndryshme, sepse përshtypjet e vizitës së parë, ai i mban për vete, nuk kishte si t'i manifestonte publikisht, për shkak të rrethanave ekzistuese, ndërkohë që për vizitën e dytë e realizuar pas rënies së diktaturës ai shprehet hapur dhe mezi pret t'iu rrëfejë njerëzve mbi atë që kishte parë në Paris. Pra është i njejtë Paris, por nuk është i njejtë Besnik, sepse bëhet fjalë për dy epoka ku individi në aspektin sociologjik është prodhim i atyre epokave. Për rrjedhojë edhe shprehja e përjetimeve është e varur nga raporti i individit me lirinë, ndonëse këtu kemi të bëjmë me një çështje shumë fundamentale që lidhet me vet shkrimtarin dhe me aftësinë e tij për të prodhuar vlera letrare atëherë kur bie një kufizim si produkt i rrethanave jashtëletrare. Libri "Bishti i kometës", ndonëse ka për autor një shkrimtar që ishte sprovuar me këto rrethana në kohën e diktaturës, ai megjithatë sikur e manifeston prirjen për të arsyuar talentin e tij në një shoqëri të lirë. Vetëm shkrimtarët e patalemtuar për mosuksesin e tyre fajësojnë pushtetet e shtetet.

Kur flasim për Besnik Mustafajin që një kohë ishte marrë me politikë dhe pastaj iu kishte kthyer me kohë të plotë letërsisë, gazetarët dhe njerëzit e mediave përgjithësisht këtë e kanë bërë me një kapërcim shumë të shpejt të vëmendjes nga njëra fushë te tjera, pa u thelluar në specifikat dhe efektet që prodhonte në publik një figurë me profil të dyzuar.

Kur e botoi në Paris, në vitin 1993, librin "Gjinkallat e vapës", Besnik Mustafaj, duke qenë ambasador në Francë, në një komunikim me një gazetar francez, kishte adresuar një porosi publike për presidentin e atëhershëm francez Fransua Miteran, në prag të një vizite të Millosheviqit në Francë. Duke dalur jashtë këmbës së ambasadorit, Besniku e porosishte Miteranin me fjalët: Nuk mundet asnjëherë ta bëjë Millosheviqin njeri të paqes, pa i kërkuar llogari për luftën, që kishte bërë në ish Jugosllavi.

Një diskurs i tillë publik që nuk i shkonte fare ambasadorit, paktohej si produkt që vinte nga vokacioni i shkrimtarit dhe këtë në njëfarë mënyre ia kishte konfirmuar edhe vet Miterani në një pritje, teksa i kishte thënë Besnikut: Sa mirë e ke lau jtur lojën me ato dy kapelat, duke aluduar në profilin e dyzuar shkrimtar/diplomat që e kishte ai.

Besnikun sot nuk po e pyesim sa



vjet i ka, por e dijmë se vitin e kaluar ka kremtuar dy festa: 65 vjetorin e lindjes dhe 45 vjetorin e karrierës letrare. Në këtë përvjetror ai erdhi me një dhuratë për lexuesit. Romani "Fati i marrë" quhej kjo dhuratë që brenda kopertinave mbarte një subjekt shumëshpresor ku ndërthureshin faktet historike me fiksinon letrar, dhe në horizontet e largëta të imagjinatës krijuese nxirte krye një Shqipëri që nuk ekziston. Shtrati i këtij romani zinte fill në vitin e largët 1878, në kohën e Kongresit të Berlinit, kur në në Angli kryeministër ishte Benxhamin Dizrael. Ky i fundit ishte njëri prej personazheve historikë të romanit, bashkë me Skënderbeun, Janosh Huniadin e ndonjë tjetër. Ai kishte shkruar një roman për Skënderbeun me titull "Naltësimi i Iskenderit" me subjekt të ngritur mbi një histori dashurie të Skënderbeut me të bijen e Janosh Huniadin, i cili i shërbyer Besnik Mustafajt për të thurrur fabulën e tij në formë palimpsesti.

Alegoria e romanit "Fati i marrë", që ka zanafillë te një libër tjerë me novela "Historia si një mushkë", konkretisht te novela me titull "Ura si vend i punëve të dreqit", është ndërtuar mbi një përrallë ku shkrimtari përfytyron se Shqipëria e kishte fituar pavarësinë që në vitin 1878, që më vonë do të jetë bashkëthemeluese e BE-së dhe NATO-s, se është një demokraci superfunktionale dhe është një vend me prosperitet dhe begati ekonomike më të madhe se Zvicra.

Në këtë roman ka pak personazhe, por ka shumë histori brenda dhe kjo e bën atë t'i nënshtrohet një procesi receptiv në dy rrafshë, sepse subjekti i romanit ngrihet mbi një imagjinatë, por ka fakte historike dhe logjikën e vërtetësisë së gjërave. Duke e gërshetuar imagjinatën me një sfond personazhesh real dhe me ngjarje historike, që kishin ndodhur, autori në këtë roman sikur e ndjek një qasje që bazohet në thënieën e Gabriel Garsia Marquezit sipas të cilit: "Frymëzimi është vetëm ardhja e subjektit", me çka pajtohet edhe Besnik Mustafaj, duke ia shtuar kësaj edhe punën e shkrimtarit. Përpjekja e Mustafajt për të kuptuar dhe shpjeguar pasojat që ka pasur historia mbi fatin dhe dramën e individit shqiptar, në fakt është një parapërgatitje për të kuptuar më mirë lidhmërinë e shqiptarit me vendin e tij, me identitetin e tij, por edhe me kontekstin kohor e politik në të cilin është ndodhur.

Në këtë dipotri duhet shikuar edhe librin "Një roman i pamundur", në të cilin procedeu narrativ ngrihet mbi dy tragjedi në dy skaje të shek. 20. Në thelb të fabulës janë dy fëmijë që përjetojnë dy masakra të ndryshme, në kohë e rrethana të ndryshme. Por njëri nuk shpëton, kurse tjetri i mbijeton masakrës e që bëhet shkas që të dyja historitë të përmbledhen në këtë vepër. Romani nis të tregoj për fatin e një shqiptari të lindur në çerekun e fundit të shek. 19 dhe të pushkatuar natën nga serbët bashkë me të birin 12 vjeç. Historia e këtij të fundit ishte bërë subjekt i një kënge, që autori Besnik Mustafaj e kishte dëgjuar shpesh kur kishte qenë fëmijë dhe ishte i vetmi moment, deri sa këndohej kënga, kur e gjithë shtëpia duhej të kishte një heshtje absolute. Sigurisht që Besniku si fëmijë nuk ka mundur ta kuptoj rëndësinë e këngës, por më vonë e ka kuptuar se subjekti i kësaj kënge mund të shndërrohej në një fabulë shkrimi aq më tepër që teksti i këngës për Shok Soklin është një nga tekstet më dramatike që mund të ketë kënga shqipe. Njëherësh te kjo këngë shohim edhe një skenë ku po luhej një ngjarje tragjike. Aty janë gjithë burra me duar të lidhur prapa që ecin të kërcënuar nga kundakët e pushkëve dhe një fëmijë 12-13 vjeç, të cilin e kanë marrë me veti dhe është i vetmi që nuk e dinte ku po shkonin dhe kjo shprehet më së miri përmes vargjeve të rapsodit popullor:

Tan po shkojnë tuj hallalu
Shok Sokoli shkon tuj knu

Fëmija i padjallëzuar e shihte se po hapen disa gropa, mirëpo nuk e dinte se ato ishin varre, andaj edhe babai i drejtohet:

Hajde bir me m'ndihmue
T'nxifsha kangën që je tu e knue

Tek dikur fëmija me instinktin e pafajësisë e kupton se diçka nuk është në rregull dhe e pyet babin:

Ç'janë këto vorre tu i pune?

Njuk janë vorre bab tuj punue
Por janë llogore për me luftue

I përgjigjet babi dhe me këtë don me zgjue brenda t'birin një sens burrnje e kurajoje.

Ishte lufta në Kosovë e fundit të viteve nëntëdhjeta ato që e kthyen Besnik Mustafajn te një sinopsis i një proze të rinisë që nuk po bëhej dot roman. Por, kishte mjaftuar leximi i një artikulli në maj të vitit 1999, që trajtonte fatin e një 10 vjeçari me emrin Prenk Ceka nga Gjakova, i cili i kishte shpëtuar maskarës me 21 kufoma, për t'iu rikthyer edhe njëherë ribërjes së këtij projekti. Imazhi i këtij fëmije në gazetë, e kishte kthyer shkrimtarin Besnik Mustafaj te kënga e Shok Sokolit, te një tragjedi tjetër e ndodhur 90 vjet më parë.

Sipas Besnik Mustafajt ky libër dëshmon se mungesa e urrejtjes nacionaliste në letërsinë shqipe i atribuohet viktimave të cilat edhe në vuajtje kishin ruajtur brenda vetes një dozë të madhe të humanizmit. Kjo shpërfaqet edhe në rastin e fëmijës së shpëtuar nga masakra, ku në mesin e të vvarëve ndodhej edhe motra e tij dyvjeçare. Por, ai nuk ishte mësuar të mendoj keq, dhe me insinktin e humanizmit kërkonte një dritë pozitive edhe te xhelatët teksa deklaronte: "Po ta kishin ditur serbët se motra e kishte atë ditë ditëlindjen, nuk do ta kishin vvarë".

Në praktikën krijuese të Besnik Mustafajt nuk ka ndonjë metodologji strikte të të shkruarit, për arsye se jo gjithmonë një subjekt i nisur në formë proze përfundon brenda një kohe të caktuar, pasi që veprat i shkruan në kohë të ndryshme. Vetëm dy romanet e fundit "Fati i marrë" dhe "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin" janë romane që janë filluar dhe mbaruar pa u ndërprerë. "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin" është një roman i shtrirë mbi dy botë, është një fabulë që ndërtohet mbi periudhën e errët të pandemisë Covid-19, me personazhe të marrë nga realiteti dhe të tjerë që janë produkt i imagjinatës. Në fakt romani më tepër bën fjalë për shtetrrethimin, me tanke dhe ushtarë të armatosur, për ankthin dhe ringjallen e frikërave të vjetra, se sa për pandeminë. Duke u nisur nga fakti se frika shpesh ka prodhuar letërsi të jashtëzakonshme, Besnik Mustafaj me romani e tij sikur bën përpjekje për të na bindur se si frika ndikon në imagjinatën e njeriut, në sjellje e tij, në në gjuhën e tij. Në disa qasje kritike ky roman madje është krahasuar me "Fermën e kafshëve" të Gjorgj Orvelit.

Një shkrimtar mund ta lexosh për efekte argëtimi, por kjo nuk është rruga e duhur për ta njohur atë. Edhe njohja me shkrimtarin Besnik Mustafaj sikur e kushtëzon lexuesin të jetë më aktiv në procesin receptiv, sepse duke e njohur tërësoren e një shkrimtari, ne mund të valorizojmë edhe cilësinë e tij. Dhe cilësia e shkrimtarit Besnik Mustafaj është rrjedhojë e një letërsie të kultivuar në një laborator që është tepër aktiv në kërkim të hapësirave të pashkelura fabulash e motivesh, që vetëm një shkrimtar me senin e zhvilluar artsitik arrin t'i përpunojë në vepra të arrira letrare. Besnik Mustafaj duhet ta njohim edhe më tepër, për të depërtuar në thellësinë dhe gjerësinë e leximit hemanuetik të veprës së tij, sprovë kjo që shkon përtej kësaj qasjeje modeste times.

"ODEON" (2024) NJË PËRMBLEDHJE E RE STUDIMORE NGA ALFRED ÇAPALIKU Nga Arben Prendi

Profesor Alfred Çapaliku është pedagog dhe studiues sistematik i letërsisë dhe kulturës shqiptare me një kontribut të dallueshëm në ndriçimin e autorëve dhe fenomeneve të anashkaluara të letërsisë shqiptare të traditës dhe bashkëkohësisë. Është i njohur tashmë edhe si poet lirik i veçantë. Prej vitesh anëtar i çmueshëm i Departamentit të Letërsisë dhe vitet e fundit edhe si anëtar me kontribute të rëndësishme në Qendrën e Studimeve Albanologjike, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Vepra letrare dhe studimore e prof. Alfred Çapalikut është tashmë si një pikturë me bojëra vaji, të cilën për ta studiuar dhe shijuar duhet t'i qëndrosh në distancë, për shkak të lojës së dritës dhe hijes mbi relievën e saj.

Dhe me këtë distancë, më lejoni të sjell në vëmendje disa kontribute studimore me të cilat ai qëndron veçmas prej studiuesve të tjerë, si:

veprat monografike "At Vinçens Prennushi" 1996, e ribotuar me ripunim në vitin 2019, me titullin "Një jetë për Fe e Atdhe, I lumi Vinçens Prennushi";

"Benardin Palaj" 1999;

"Gaspër Pali" 2002;

"Kolë Mirdita (Helenau)" 2015;

"Veli Stafa-Platonius" 2018,

të cilat mbeten vepra me rëndësi themelore për këta autorë në studimet letrare shqiptare.

Bie në sy se këta autorë janë autorë të anashkaluar në studimet tona letrare dhe është meritë e veçantë e prof. Alfredit, sepse ka bërë objekt disa autorë të ashtuquajtur minorë, por me rëndësi për procesin letrar shqiptar të gjysmës së parë të shek.XX.

Për të shtuar përmbledhjet me studime letrare "Alfabeti i munguar" 2003, "Ese dhe studime letrare" 2005, "Luksi i kulturës" 2012, "Paralele folklorike ndërkufitare" 2005, "Penda të traditës" 2020 dhe tani me përmbledhjen e fundit studimore "Odeon" 2024, përmes të cilave autori ka gdhendur vendin e tij në historinë e studimeve tona letrare, përmes një pune të zellshme dhe kurajoje duke bërë objekt shqyrtimi autorë dhe fenomene të ndryshme të letërsisë shqiptare, duke qenë një shembull për t'u ndjekur nga brezi më i ri i pedagogëve dhe studiuesve në fakultetin tonë.

Libri më i fundit "Odeon" është një përmbledhje prej 25 artikujsh studimorë dhe kritikë letrare të shkruara dhe të botuara në revista shkencore dhe periodikë letrarë dhe kulturorë përgjatë viteve 2018-2024.

Në këtë përmbledhje autori paraqet të dhëna me interes studimor dhe enciklopedik për 24 autorë të traditës sonë letrare dhe kulturore, si:

Pjetër Budi, Leonardo De Martino, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Antonio Busetti, Benardin Palaj, Donat Kurti, Ernest Koliqi, Kolë Ashta, Kolë Thaçi, Injac Zamputti, Veli Stafa dhe Vehbi Bala, por edhe për autorë bashkëkohorë, si:

Bahri Beci, Ismail Doda, Ermira Alija, Ardian Ndreca, Arben Prendi, Anton Gojçaj, Mimoza Hafizi, Andreas Dushi, Basir Bushkashi dhe Hasan Hasani.

Në këto artikuj ndërthuret me mjeshtëri njohja enciklopedike e veprës së autorëve dhe analiza e thellë e studiuesit të kultivuar, që përmes një stili elokuent mbërrin të distillojë esencën e vlerës që përmban vepra apo autori i bërë objekt studimi.


Për autorët e traditës studiuesi plotëson mozaikun e studimeve të mëparshme letrare me interpretime dhe komente të reja, ndërsa për autorët bashkëkohorë me kurajo e thotë fjalën e pari, duke anashkaluar paragjykimet e zakonshme për autorët më të rinj, duke vënë në dukje vlerat që ata sjellin në studimet letrare apo në krijimtarinë letrare bashkëkohore.

Në artikujt e këtij vëllimi autori shquhet për erudicionin e gjerë, sintezat e sigurta, bibliografinë e pasur dhe temperamentin e krijuesit letrar, që e ndihmon të jetë në sinkron me autorët dhe veprat e autorëve të shqyrtuar.

Në mënyrë të veçantë, artikujt "Publicistika e Kolë Thaçit", "Poemat e Kolë Thaçit", "Vendi i Kolë Thaçit në letërsinë shqiptare" sjellin një kontribut të ri, duke sjellë në vëmendje një autor pak të njohur dhe të anashkaluar në studimet tona letrare. Edhe këta artikuj e bëjnë prof. Alfredin të parin studiues, që ka kontribut të këtyre përmasave për këtë autor, dhe me siguri do të shërbejnë për studime të tjera në të ardhmen.

Përmbledhja me studime letrare është përveç të tjerash edhe një doracak praktik për njohjen dhe studimin e autorëve të paraqitur këtu, si nga ana e studiuesve të fushës, por edhe nga një lexues më pak i specializuar. Kjo edhe për shkak të stilit të përdorur, ndërmjet disa tipave të analizës historiko/letrare, studimore/kritike, por edhe eseistike dhe komentuese e mbi të gjitha për komunikativitetin në lëvrimin e një gjuhe të qartë, korrekte dhe të sigurtë, ku spikatë dora e mjeshtër në parashtrimin e problemit të marrë në shqyrtim, zhvillimin e tij dhe në rezultatin e punës kërkimore studimore.

Me përmbledhje studimore "Odeon" autori e kompletton më tej, me elegancë, opusin e tij studimor mbi disa autorë të traditës dhe të bashkëkohësisë letrare.



Romani «Pesha e padurueshme e pavarësisë» mban një peshë të rëndë të një udhëtimi pjekurie, trajektorja e të cilit përshkon thershëm botën e një të riu. Lufta e dytë botërore e ajo çka solli pas në Shqipëri, nuk la pa prekur edhe një të pafajshëm. Pesha e pafajësisë së të cilit është më e rëndë se vetë faji.

Shpesh në jetë njeriu bashkërend me kohën pa e kuptuar. Ecën paralel me vorbullën që mbart epoka e tij, i oshtin në vesh gjëmimi i saj aty përtej, dhe, pa e kuptuar, fillon ta mbartë atë brenda vetes. Harku i udhëtimit të tij ndoshta i hallakatur shtigjeve e labirintheve, hap pas hapi përfundon aty, në pikëtakimin fatal, nëse mund të quhet kështu. Por pavarësisht emërtimit, **lakorja që përshkruan njeriu në jetë nga pikënisja, në pikën kulmore e më pas në fundin e pakthyeshëm, është rruga deri në pjekurinë e tij të ashpër.**

Në këtë harkore ndryshimi dhe formimi ecën heroi në librin «Pesha e padurueshme e pafajësisë» të autorit Primo Shllaku, për të arritur në destinacionin e tij të pashmangshëm. Ai provon «*me u përqendru me shikimin në një pikë...*» për të kështu vilen e rrushit, oficerin mbi kalë, të krisë pasqyrën dhe së fundmi, pa u tubulluar, është «*gati me e rrëzue diktatorin në kokërr të shpinës, sapo ai të ngjitet në tribunë...*».

«*Po zgjohej*» - thotë autori, që në faqet e para të librit, dhe jo, *u zhgjua*. Pra duke u çapitur aty, midis ëndrrës dhe zgjimit, ai arrin të vërtetojë «*se sa e vockël ishte jeta e tij tue i ardhë rreth ujit të njerëzve... Ngjarjet.. i kishin krijuar befasisme lidhur me njoftjen e vetes*» Duke ndarë tashmë ditë të tëra me viktimat e kohës së tij, të faj e të pafaj, që «*Të gjithë e urrenin emnin e vet dhe të gjithë ishin faktikisht pa emën*», Marini arrin në përfundimin fshikullues dhe njëkohësisht të vërtetë «*se një jetë fajtori ka ma shumë rrugëdalje se jeta e të pafajshmit*»

Dialogu tragjik i priftit ortodoks me Zefin, një nga personazhet e librit, trondit, huton, trazon, dëshpëron.

«*Ti ke problem, ti nuk duroke pafajësinë tande, djalosh... / - Vidhe dhe qetësohu... Përfundimisht...*», Fjalët e priftit më kujtuan vargjet e një kënge greke që e kisha dëgjuar pak kohë më parë.

(*Dje vonë ... /U gjenda duke pirë me një shenjtor.../Ç'kërkon këtu, i thashë /Ky vend nuk është për ty.*

Më tha... /nëse dëshiron të shenjtërohesh, /duhet të mëkatosh /e në arritsh, le të pendoresh).

Marini ynë që fillimisht në zbulimet e tij të para për forcën e jashtëzakonshme të syve të tij, ishte i sigurt se «*nuk ban me i ngulë sytë*», mbas kohës kur sheh se iluzionet e tij rinore kishin humbur, ishin tretur, «*...qortonte veten që nuk i kishte provue me i «thye» ose me «ia ç» sytë Tatjanës*»

Duke rendur në rreshtat e këtij romani që **rrëfëhet shtruar, por me një dinamikë tronditëse së brendshmi**, pyetesh shpesh nga vetja: A ka peshë pafajësia? Ja që paska. Pafajësia verbon. Ajo dyshohet në epoka e sisteme të ndryshme, ka dy anë, ashtu si një monedhë me dy anët e saj të tjetërlojshme, ajo është dyfytërshe.

Për çfarë jemi të pafaj? Cila është pesha e fajit të lypur nga qenia njerëzore? Kush e bën të padurueshme pafajësinë? Dyshimi, koha apo njerëzit? «*Potërja e detit ishte potëre e tij, kurse uturima e skuadriljeve kishte diçka njerëzore ...*» Pra njerëzit, miq dhe armiq për njerëzit. Rrjedha dhe gurgullima e mendimeve dhe përjetimeve në rrëfim të bëjnë të thellohesh dhe përdridhesh në përsiatje me ngjyime të ndryshme bindjesh, arsytimesh e gjykimesh, duke i pohuar shpesh vetes - *Le të kem faj, që të mundem të akuzoj vetë veten për fajësinë time.*

Në çdo hap të Marinit e çdo faqe të librit, në gjarpërime udhësh, ndjenjash, mendimesh, përjetimesh, lexuesi zbulon

Romani «Pesha e padurueshme e pafajësisë» i PRIMO SHLLAKUT burim i pashtershëm gjuhësor e stilistik

TË JESH, A TË MOS JESH ... I PAFAJSHËM?

Nga Alma Ibi Zekollari

bashkë me të, monopetet dhe skutat e botës njerëzore, pavarësisht epokës e vendit ku rrjedhin ngjarjet. Është Marini i këtij romani dhe çdo Marin i jetës së secilit prej nesh, që shpesh, në gjendjet e ndërmjetme të arsytimit, gjykimit, vramendjeve dhe përjetimeve, zbulon veten dhe botën rreth tij ku «*...nuk kishte lanë gjurmë.. e kishte kuptue se dëshironte me lanë gjurmë...*» që i thotë vetes troç: «*unë e këpus vilen e rrushit me sy*», por që ndien një lehtësim kur thotë prapë me vete se «*Deti ishte ma i fortë se unë*»

Në rreshtat e këtij libri del në pah njeriu me gjithë brendinë e tij të veçantë, individi përballë botës që hap pas hapi, i vetëm, zbulon këtë botë me **sytë e tij**

Duke lexuar për forcën e syve të pesonazhit të këtij libri më erdhi në mendje një fragment i paharueshëm nga libri «*Loja e syve*» të Elias Canetti ku thotë «*Ka sy që të ngjallin frikë, ... Është diçka e tmerrshme ngultësia e një vështrimi të pamëshirshëm. Mitik është edhe syri që s'kërkon të shqyjë viktimën, megjithëse nuk i ndahet kurrë asaj që ka parë. Ky mit është bërë realitet, dhe kushdo që e ka përjetuar rikujton me emocion e tmerr*

syrin që e detyroi të mbytej në thellësinë e tij të pamasë...»

Libri, i çfarëdolloj zhanri qoftë, mbi të gjitha është mjet i lëvrimin të një gjuhe të caktuar, qoftë i asaj të origjinës apo i asaj të përkthimit. Ai është mjet që e ngre lart një gjuhë, ose e shkel dhe e përdhos atë. Ky libër që kemi në duar, duke filluar **që nga titulli të jep dritën jeshile të asaj që do lexosh.** Të tërheq me gjuhën e tij të bukur, të pasur artistikisht, të plotë, duke peshuar rëndë në tokën e vet. Ashtu siç godet këmba e valltarit që di të hedhë siç duhet vallen e nisur.

Nëse përdorimi i plotë sinonimik, antonimik, shprehjet gjuhësore e frazeologjike etj, e pasurojnë gjuhën, vënia në funksion të rrëfimit pasuron stilistikisht një vepër letrare, ashtu siç ndodh kryekëput në këtë prozë të bukur të këtij romani.

Jam e sigurt që përzgjedhja e titullit nuk është aspak e rastësishme. «*Pesha e padurueshme...*» mund të ishte: pesha e rëndë, e madhe etj, por është **e padurueshme, peshë pafajësie.**

Përplasja kuptimore fjalësh e shprehish japin ngjyime stilistiko -gjuhësore që e bëjnë më të thekshme forcën



e fjalës. Lexojmë: «*...një kaltërsi e egër... /ai sfond gri i ndytë përkëdhelte... /shpërthim i madh bashllëku... /pickim kënaqësie... /qyteti i mpimë, i qetë, por vlues... /zogj të zinj metal... /qëndronte i papranishëm... /klithmë gjarpni, /prani e padukshme.. etj*» Shtrëngata e këtyre lloj kërcitjesh gjuhësore therëse përdoret mrekullisht duke i dhënë ngarkesë të bukur figurative rrëfimit.

Pavarësisht se rrëfimtari tregon në vetën e tretë, nuk krijohet asnjë hendek, boshllëk dhe largësi midis heroit dhe lexuesit. Mendimet e tij përcillen natyrshëm dhe rrjedhin bashkë me përjetimet tona. Tregon ngjarjet që ndodhin shpesh midis reales dhe joreales, të vërtetës dhe të pavërtetës, midis ekzistencës dhe mosekzistencës, i mendon, i shtjellon, i përpunon dhe gjithashtu **i rithotë.** Dhe kjo e fundit përsëri e përsëri ndihet e domosdoshme për t'u rithënë, *lodhja e Marinit, /dhimbja në rrënzat e kofshëve, /këputja me sy dhe rënia e viles së rrushit, /pritja e një përgjigjeje, /ecja e Tatjanës, /unaza e rrokullisur në bar, /pluhuri pas makinës, /thyerja e pasqyrës me përqëndrimin e syve... etj, etj.* Këto rripurje bëjnë lexuesin të pozicionohet e të kundrojë edhe një herë nga tjetër dritare këndvështrimi e pikëpamjeje.

Kur lexon çdo gjë rrjedh natyrshëm, pa ngut, **si rrjedha e mendimeve njerëzore.** Të duket se nuk lexon por shikon, ndjek me sytë e mendjes gjithçka. Gjithçka që rrëshqet pa kuptuar, ashtu siç rrëshqet fjala në gjuhën e librit duke dredhurar natyrshëm nga tregimi i rrëfimitarit, në përsiatjet e kujtimet e personazheve, për t'u zhytur më pas në ligjëratën e drejtë dialoguese.

Shpesh lexon përshkrime të ndryshme dhe fjalori i përdorur me rrjedhën e tij të fuqishme, ku e bukura e thënë hidhur dhe e hidhura e thënë me fjalë të ëmbla, të bëjnë të pëshpëritësh: - Ky është përshkrimi i detit që ka personazhi përballë apo i asaj që përjeton heroi ato çaste?


Ajo që më bëri për vete në gjuhën e këtij libri është standartja e gegërishtes që përdor autori në rrëfim, melodia e këndshme e saj.

Por aty, veç elementeve gjuhësorë të gegnishtes, dy dialektet bazë të shqipes ndërthuren butësisht në gjuhën e personazheve nga jugu i Shqipërisë. Ky libër është i denjë për pikë referimi në studime gjuhësore. **Gjuha e një populli pasurohet kur përdoret e plotë** me të gjitha krahinizat dhe dialektet e saj. Pa ngurruar po rreshtoj disa fjalë që ndoshta mospërdorimi sot po i fashit, po i humbet dhe ndoshta dikujt do i duhet kohë për të kujtuar apo kuptuar përdorimin dhe semantikën e tyre. «*truma, vullani, gliqe, sheneshini, trokaça, nallça, cijatje, prozhmime, çervesh, shpërthiq, llom, rrashtë, hulli, rrashkaqel, i pashekull, të vërgjilta, për së kithi, tironte tehun, kishin hedh në fik punën...*», etj, etj

Duke vënë në funksion gjithçka që mbart një gjuhë, ajo nuk tkurret dhe nuk humbet rrugëve të harresës. Nuk ka nevojën e etur dhe të pakontrolluar të huazimeve pa fund.

Kjo e bën të veçantë librin dhe besoj mëshon më tepër duke i bërë më të dukshme bindjet gjuhësore të shkrimtarit, eseistit, poetit, dramaturgut, përkthyesit, Primo Shllaku.

Pastë rrugë të bukur dhe të gjatë pranë lexuesit!



Heshtja jote asht sa qielli i thellë. Ajo po më mëson me e kuptue humbjen time. Tash që dielli u shue dhe ra terri, fjalët e tua të dikurshme janë yje të natës...

Sa e sa herë u përplasa në mëdyshje cila je Ti: ajo që e bukur asht me e pa dhe bukuri përhap ngado që ecën rrugës, apo ajo që nga të gjitha pjesët e trupit shfaq bukuri të cilën e dëshmon esenca e bukurisë sate në trupin e dashtun për mue? Apo, unë vetë e kam krijuar pamjen tënde të cilën e due? Cilën pamje me e ndërtue n'këtë shkrim? Atë pamje me të cilën mundet me t'njofte gjithkush? Apo këtë pamjen tande që unë e rrej thellë në shpirt dhe që asht vetëm imja? Apo këtë pamjen tande, mbi të cilën ka ra heshtja e randë e së panjoftunës?

Në netët e gjata të vetmisë së shkrimit për ty, unë e krahasova me pakufi secilin detaj tandin me vajzat e vendit dhe tue marrë prej secilës gjanat ma të bukura, mirëpo nuk mujta as me u afrue te bukuria jote. Ti je ma e bukura e të gjitha pjesëve të bukura të vajzave që kam pa...

Dikur dritë i jepshe dhomës, gjithë shtëpisë. Ti i jepshe dritë qytetit. Kur shkove Ti, të gjitha u shuen në terr.

Me largimin tand, bota e madhe, e bukura dhe madhështorja, erdh mbas teje, Shtrigë.

Të kujtohet se si në atë fillim po e shihja me kujdes peizazhin e dashunisë si me qenë ai peizazh i natyrës së mrekullueshme herët në një mëngjes pranvere? Përmbi detajet e bukura ende nuk qe largue plotësisht terri, mirëpo tue u përqendru, tue pa përtej asaj që syni sheh, e kuptojsha që po iluminohesha në atë dashuni siç iluminohet pelegri i devotshëm në udhëtimin e tij jetësor drejt shtëpisë së Zotit.

Po depërtojsha ngadalë përtej shqisës dhe po shihsha mbrenda territ të mrekullueshëm në të cilin Ti më ftojsh, më kishe grishë e tash po më prijshe.

Thellë e ma thellë të rashë mbrapa, magjistare.

Dashunia për ty e zgjanoi botën time larg e larg, përtej së përditshmes, përtej përvojës që na sjell koha dhe përtej asaj që të pesë shqisat na flasin një jetë të tanë.

Tash, kur e kujtoj këtë dashuni, e shoh që kam në mendje pamje të pambarim të saj: biseda, mesazhe, letra, postkarta, skica, fotografi, shënime çasti, dokumente, përshkrime, regjistrime, burime të shumta, arkiva, biblioteka, filma, poezi, gjana pa fund që munden me u radhitë si pamje ekstaze të jetës me ty. Shtrigë. Shumë.

Çdo gja për të cilën deri atëherë kisha jetue, si dija, mësimdhania, librat, pasunia, fama, nuk më kënaqshin ma. I hodha përtokë lehtas, siç hidhet pluhuni që ka ra mbi tryezë të shkrimit, para se me nisë me shkruve fjalën në letër.

Fjala ishe Ti.

Fjala je Ti.

Ti e di që unë, atëherë, i kisha të gjitha: shëndetin, familjen, pasuninë, fuqinë, të mirat, dijen, artin, të gjitha gjanat që e bajnë njeriun të lumtun... Mu atëherë rashë ndashuni me ty dhe e pashë që e gjithë lumtunia e atyne gjanave aq të çmueshme në jetë nuk është ma të randë se një kokërr gruni n'hambarin e dashunisë, ku përfundova unë, bashkë me ty.

Erdhe në andërr. Çuditshëm: nuk isha i ngarkuem emoci-onalisht. Ti ishe diku, mirëpo më duhej me të gjetë, se kisha me e ndryshue një ngjyrë tanden. Ti ishe diçka blu e thellë, pranë së errtës, ndërsa unë duhej me të ba ngjyrë purpull, bojalli. Nji lloj pikturë të cilën duhej me e ndërrue tue mos ia humbë as kuptimin, as bukurinë, mirëpo nuk ishte ashtu e mundun, se ishe Ti. Ti e pranove në tanësi atë që të thashë unë. Megjithëse na po flitshim si dy të njoftun të thjeshtë, të cilët duhej me e krye një punë të vogël, por të domosdoshme. Bashkë e bamë nji copë rruge, kaluem disa pasazhe ose



ZEJNULLAH RRAHMANI

Heshtja tregim

korridore, disa zyra të ndryshme, mandej ashtu natyrshëm Ti u largove dhe unë vazhdova me e krye edhe ma tutje atë punë, mirëpo ndërkohë e kisha shumë të qartë që po më duheshe, ndërsa nuk mundesha me të gjetë ma. Prandaj i pyetsha njerëzit e njofshëm për ty.

E di që kishe veshë pantallona xhins dhe nji bluzë dhe ishe nji vajzë me flokët blu të haptë, si qielli i fjetun... Por unë u zgjova: nuk të gjeta. U zgjova pa të gjetë ma. Kurrë ma! Ajo ndjenja që kam nji punë, të cilën domosdo duhet me e krye, vazhdojke me qenë pjesë e mendjes sime, si e ndiej edhe tash, në këtë moment... dhe ja që të telefonoj për me qenë në nji mënyrë në kontakt, me ty edhe pse nuk përgjigjesh ma, edhe pse e di që Ti nuk përgjigjesh dhe unë jam në anën tjetër të botës, ndërsa Ti je në Prishtinë, ose diku aty, rrotull, në heshtje.

E Dashtun, bukurisë sate rrezëlluese seç i kish ra nji hije hane, trishtim e lodhje bashkë.

Ra nata dhe nuk po e ndezshim dritën në shtëpi. Drita nuk u bjerr nga fytyra jote dhe prej saj bukuria ndriçonte butë-butë. Ishte magjia e femnës së dashnueme që shtrihej mbi gjanat e botës përreth dhe unë e ndiejsha atë ngroftësi... Bota e tana ishte e pasunueme nga ndjenja jote që po i influenconte sendet e shtëpisë sime. Mbreti isha unë, shërbëtori yt.

Jam i humbuni, se mbasi që fjeta prapë, prapë u ktheva në andërrin me ty dhe prapë e di që të kërkova. Vazhdova me të kërkue deri në mëngjes, mirëpo nata i zhdoku gjurmët dhe mëngjesi më gjeti me pak hije të zeza të andërrës, me boshllak të pakufishëm në zemër dhe me rrahë mavi nën sy...

Tash e shoh që dashunia, çkado qoftë ajo që quhet kështu, nuk mundet kurrë me u shpjegue me fjalë të besueshme. As nuk due me e tregue me fjalë të vërteta. Çkado qoftë ajo që unë ndiej, le të mbetet përgjithmonë në figura e në art. E vërteta kishte aq shumë bukurie dhe ndjenja sa përgjithmonë ka me u varrosë me mue... edhe me ty. Ajo dritë dëshpërimi në fytyrën tande mundet me u pa sall në fytyrën e gurëve të vorreve... Përse më le?

Ti më ke dhurue disa nga mrekullitë e jetës.


Nëse ndonjiherë e kam ndie natyrën e bletë dhe ajrin, asht koha që Ti më ke dashunue. Ditët kur e kam ndie lirinë si me e ndie freskinë e ajrit dhe erën blu të ajrit të malit janë ditët kur jam dashunue në ty. Nëse ka pasë kohë që i ka dhanë kuptim jetës sime, ajo kohë ka qenë koha që ta kam kushtue ty. Nëse ka pasë nji përjetësi në jetën time, kjo asht dashunia me ty.

Në mue dashunia pat folë si art. Të gjitha kanë qenë aty: goditjet me daltë mbi mermer, shenjat e mrekullueshme të vijave, tonet fantastike të ngjyrave, shenjat e ngjashmëritë, mashtrimet të errëta ndjenjash të brishta, sugjerimet e stërholla të emocioneve dhe dhembjet e mprehta që copëtojnë, aromat e padefinueshme të humbjeve e pikëllimeve...

Ti i dhe kopshtit bukurinë ku shëtisja në andërr. Veç lule të egra e parfume kurrë të shijueme fluturojshin përreth meje.

Ti je nata jeme e parfumeve.

Natë dashuni, ndjenjat tona ishin gjethe të llojlojshme të pyllit të pashkelun... E shoh tash që i shkruaj se si po tentoj me i vendosë në rende, me i kthye gjetet që kanë ra prapë te druni i tyne dhe me i pa sa të bukura e të natyrshme që ishin dikur.



Atë dashuni kush e krijoi nga ne të tre që ishim të pranishëm: Ti, Zoti dhe unë? Cili nga ne të tre e nisi ortekun?

Secilën gjethe e marr në duer dhe e shoh sa e veçantë ka qenë secila dhe sa shumë ngjyra e muzikë ka bartë dikur, prej fillimit të qenies së saj e deri në ditën e sotit të kujtimit tim.

Ka pasë aq shumë ekspresione ndjenjash, sa shpejt e patëm kuptue edhe unë, edhe Ti, që kishim marrë krahë e po fluturojshim nëpër qiellin e paanë të kozmosit, mespërmasë stuhisë së kaosit... Tash, lum mikja, unë me duer të shkrueme i kapi yjet e zjarra të emocioneve të dashunisë dhe ja, po baj të pamundunën me i vu në lëvizje, po i shtyj nëpër galaksitë e fjetuna e pa mbarim të rruetzave... Prushin e zemrës po e shpërndaj si zjarr të kujtesës mos me e humbë asnji margaritar të dashunisë, asnji gur të saj.

Para atij zjarri, që më kthehet në zemër me ty, dielli i verës duket si nji qiri i vogël në dollap.

Ndoshta nuk më dashunojshe vetëm si të tillë çfarë isha e jam, po më dashunojshe se vetja jote jetonte në mue? Edhe unë të dashunojshe ty jo për çfarë je në veten tande, po të dashunojshe se vetja ime jetonte në ty. Tash që mendoj për këtë, e shoh që dashunia ishte rruga për me e realizue veten tonë. Tue njoftë ashtu veten tonë, në ne e në tjetrin, na bahej e mundun me e njoftë jetën dhe plotninë e saj që nuk përthekohet mbrenda nji individi. Çdo gja në këtë univers asht e lidhun dhe asht pjesë e vetes sonë edhe nëse asht në tjetrin. Pa veten tonë të shtrime tek tjetri nuk ka botë, nuk ka Univers, nuk ka Zot. Na, në dashuni, jemi esenca e vetes, siç asht syni ynë esenca e dritës, lëkura jonë esenca e prekjes, veshi ynë esenca e tingullit, gjuha jonë esenca e shijes, truni ynë esenca e vetëdijes... Në dashuni të gjitha i kishim të lidhuna, të kuptueshme ishin të gjitha, ishim esenca e vetes sonë.

Në dashuni na ishim.

N'dashuni ishim të gjithë së bashku: Ti, unë, shtëpia, oborri, fusha, pylli, toka, oqeani, qielli, dita dhe nata, Universi, emnat tanë, na, Zoti.

A asht dashunia si jeta? Kur asht, asht e pambarim dhe e pafund, asht e ndryshme dhe e ndryshueshme, e bukur dhe bukuri...

Çka ndodh me dashuninë kur vjen fundi? A asht ajo si njeriu? Që vdes? A ekziston ma përtej fundit? Çka asht njeriu kur e humb dashuninë? Ato ditë unë kisha dashtë me u ba diell që del mbi majë të Pashtrikut për me të pa ty kudo që mundohesh me u fshefë. Ti hyn në mendimet e mia natyrshëm siç hyn drenusha në pyll dhe bredh sa do, bredh nga e shpie hapi a instinkti dhe nuk lëndohet kurrë, as kurrë nuk humb, se asht në shtëpinë e vet.

Brumbuj e grajzi fluturoen rend e rend mbi lulet e gjemba-çëve. Kanë me mbledhë nektarin e tyne a me u therë në gjembat e panumërt, si unë? Le të kthehet qenia ime në gjuhën e vet, ashtu si kthehemi netëve të verës në shtëpinë tonë, të lodhun dhe të gëzue, dhe i lajmë kambët, fytyrën, bahemi të pastër për familjen tonë, për veten dhe për Zotin në ne. Nji mbramje të tillë, mbasi të përçolla ty deri poshtë te hymja, u ktheva dhe natën që kish mbetë e kalova tue ndie praninë tande në mue... Baj be që nganjherë, edhe mbas shumë e shumë vjetëve, n'momente të pastërtisë sublime, e ndiej si Ti troket në zemër... dhe ajo brubullon sikur bletë që bahet gati me dalë nga kosherja e me nisë familjen e re...

Të ketë qenë ajo dashuni dhe mrekulli bukurie vetëm nji pikturë e bame mbi ujin e lumit që rrjedh?

Natën folëm gjatë për poezinë dhe dikur, vetvetiu tue ndëgjue muzikë...

Ti rrijshe e mbështetun te shtrati im me nji filxhan kafeje në dorë. Të kishin ra mbi sup flokët all. Supet delikate të dridheshin

lehtas si pemë që tundet nën peshën e borës... Te cicat që u frynë lulëzuen kokrrat e përskuquna...

O Zot! thirra përmbrenda vetes: E kam kaq pranë gruen e dashtun, që nuk mundet me u pa ma n'këtë dhë.

Poezisë së grues ia ndjeva ritmet e fshehta dhe gjithë kuptimet deri tek terri i figurave të arta... muzikën e ndjeva të tanën në dashuni, të plotën, siç e ndien toka lumin që rrjedh nëpër gjinin e saj.

Isha ato çaste popull që porsa e ka fitue lirinë dhe vazhdon me jetue përtej realitetit.

O Zot! Sa afër iu afrova vdekjes atë natë!

Tue të shikue, lëshue ndjesish e ndjenjash të përhumbuna, në qetësinë e kënaqësive sensuale, në një çlirim a robnim të mrekullueshëm, e të frigshëm emocionalisht, fillova me e ndie dhe fizikisht, pothuajse me e pa, atë lidhje të pashembullt që po bahej mes meje e teje. Po e kuptojsha rrugën e fshehtë e të çuditshme që po kapërcente nga shqisat dhe gjithnjë e ma e qartë po bahej që ajo lojë e kënaqësi po i kapërthente hapësinat e thella e të zeza shpirtnore ku lind prej fillimit e krijohet bota njerëzore...

E di, loja e shqisave po e mbushte jetën, ajo lojë shpirti po na e hapte derën e vdekjes.

Na ishim dy të verbët që i prijshim njanitjetrit rrugës së panjoftun. Nji qorr dhe nji e verbët ishim të vetëm në Pyllin e Zi: mrekulloheshim me çdo prekje, me secilin kontakt lirojshim kënaqësi e frigë të madhe, e shijojshim çdo gërvishitje, secilin lëndim, çdo aromë, çdo za të pyllit ku jetojshim...

Ka me vdekë trupi im, kur të mos jetë ma trupi yt. Kur të vdes trupi, kam me vdekë edhe unë.

Na ishim dy persona që ishim strukë në shpellë të fshehtë dhe kishim zaptue fronat e po pijshim me kënaqësi pije të ambla e të idhta. Pijshim nektar dhe pelim. Ishim të hapun për pafundësinë e ndryshimeve. Trupat tanë notojshin butë-butë në ndjesi, nëpër prekje, shijime, kënaqësi... nëpër dhembje e mall, nëpër ambëlsi e dhembje... Kishim nevojë me qenë të vetëdijshëm për atë që po na ndodhke me trupat dhe me ne.

N'terr e ndritë jetojshim njikohësisht.

Si kuaj të egër kalërojshin kënaqësitë tona.

Karroca e çmendun që fluturojke nëpër qiell e tërhequn prej yjeve ishim na. Dëshira jonë e tërhiqte nëpër rrugët e pakrye të dashunisë dhe të humbjes.

Vetëm ty të shihsha. Vetën nuk e shihsha ma.

Murg në shkreti u bana atëherë dhe Ti ishe qëllimi që përmbante shkaku e parë dhe arratisjen e fundit. Kur m'preke Ti, diçka në mua klithi: "Zgjohu! Ndiqe mrapa në mësimin e dashunisë! Ndiqe derisa të unisohesh me të. Njihe për me e njoftë veten!"

Por Ti je në botë diku... Si me e kthye unë shikimin nga vetja tash?

Në shtëpi timen Ti ishe zjarri që digjej në votër. Kur shkojshe, ishe dielli në qiellin e kësaj bote.

Si zjarri në votër që digjet në mbramje të vonë dimni, me gjithë flakërimën në gropën e oxhakut, dashunia jote shkëlqente për të gjitha gjuhëflakët. Porsi ato dashunia shprehej në forma të ndryshme, tue pasë dalë prej të njajtit burim...

Nga dashunia jote nxejke dielli, binte shiu, fryjke era, reshke bora, vrahej e kthjellej moti në shpirtin tim.

Natë grimë kohe të dashunisë u përsërit mija herë gjithë cikli i jetës e vdekjes.

Unë tash i bana njiqind vjet në humbje. Ti nji mijë i bane. Nji-mijë-e-njiqind-e-nji jemi.

Era që fryu sot më solli kujtimin tand. Njiherë, n'të ftoftë, fryma jote e ngroftë dhe e avullt përhapej deri tek unë e unë e pata thithë atë frymë të dashtun që dilke prej gojës sate.



XHEVAÏR LLESHI

Kmesa tregim

Ajo, t'i biem drejt, ishte kurvë dhe e njihnin të gjithë, sikur ta kishte të shkruar në ballë. Por ja që ai, i panjohur, s'e njihte. E mati mirë me sy dhe po priste përjashta si për t'u eglendisur me veten. Edhe asaj i bëri përshtypje gjatësia dhe trupi në dukje i fortë, e vuri re me një shikim të pjerrët nga brenda jashtë.

Ajo zbriti shkallët dhe doli në rrugicën e përparme të pallatit të madh dhe e këqyri nga afër atë, për një kohë pa ia ndarë sytë, duke tërhequr sutjenat e ngushta e të hapura si për të thithur vëmendje, se atyre të shkretëve u qante syri për kësi hiresh tunduese. Por vetëm kaq, se të tjerat, edhe po t'i rendisje s'i numëroje dot.

- Po ti këtu? - e pyeti dikush.

- Shih rrugën o murg! Mos pengohesh në pllaka se janë ca të ngritura nga lagështia... - Murgu i sat ëme! E di unë si e do ti! - Dhe sytë i lëshuan xixa.

Ai, djali i gjatë, sikur qe aty pranë, u hodh dhe e zhvati për qafe.

- Si e ke hallin, hë?

- Unë në punën time jam. Ti, ti ç'kërkon këtej?

- E pse, mos po të ha rrugën? - Dhe s'të kam parë ndonjëherë...

- Babjush, o murg i mirë, o kmesë, mos t'i prish duart me ty, se, si tepër po më hanë...

'Murgu' u skërmit dhe ngeli aty pa bërë as tutje, as tëhu. Si një kmesë e lënë në harrim. Një lëvizje imja të hedh te kroi i Vërës... E dëgjove? Ik e shih punën...

- E, mo, e dëgjove ç'tha? - i shty urët ajo.

- Mbylle moj cipëplatur, mbylle atë vrromë!

'Murgu' rënkoï.

- Ç'm'i paske ato shenja në duar? - s'iu ndenjtjetrit, të gjatit, duke menduar se duart e hapura dukeshin si harku i kmesës.

- Mos të dukem i zbërdhulët, i rrjepur, apo i llangosur? Mos të ngajë i përvuajtur në fytyrë, apo i mëshirshëm? Edhe atë që po mendon ti, e kam gjithnjë me vete.

- Zotëri, mbahu për vete, me mua s'ke punë, po as me të tjerët... Unë s'ta mbushkam syrin, duket... Thuaj po të duash, po edhe mua... murg më dukesh, po edhe i pangopur, i zënë je - edhe i ushqyer, i ndukur mirë, por me sa duket askush s't'i paska dhënë duart... Ç'do ti këtu?

'Murgu' s'po fliste, papritur ai nxori më të shpejtë nga gjiri një tullumbace të gjatë e të fryrë, si kmesë, dhe ia tundi para syve, duke thënë: - Po të godita me këtë, bie në vend dhe s'ngrihesh dot kurrë, t'këput në mes, se kjo duket e ëmbël dhe tërheqëse me gjithsej, të bën për vete e të tundon, se është me luspa të ashpra dhe e mishtorme, të ngulet në vend të lik dhe e merr rrugën përprjetë duke u tundur, që punë e madhe...

- Qenke pajisur me vegla, o murg!

- E pra, edhe ne kina vegla, si thu ti? - ia ktheu murgu në dialekt, me mllef. - Apo jo, moj zuskë?

Tullumbacen e gjatë dhe të fryrë, si kmesë, nuk e fshehu gjëkund. E mbante në dorë. Dukej sikur kish mbaruar punë me gjithçka dhe tullumbacja e gjatë sa krahu i dridhej, ndërsa ai sapo vuri maskën e një nënqeshjeje të lehtë... «Murg simpatik» mendoi ajo.

- Ta mbaj pak? - e pyeti më tepër me sy.

E mori, e ktheu mbarë e prapë tërë koketëri me të dy duart e kuruara mirë, që ta shihte sa më mirë dhe la një oh të zgjatur. Madje më e gjatë se tullumbacja-kmesë. Ai mbeti mes trotuarit i mikluar, pa e fshehur fërgëllimën e beftë, madje i ndezur papritur për një shturje pa mend, kërceu përpara me hov dhe...

Ajo po puthte murgun.

- Ç'je ti, 'murg'?

- Ti mbaj vendin, të thashë, se përndryshe do të godas dhe e di ku e ke tëndin, te kroi i Vërës. As me mend nuk e merr se ku bie ai krua!

- Ti murg, qëparë më pyete me të keq. Se s'kam zanate të atilla...

- Fshati që duket s'do kallauz, - foli nëpër buzë djali i gjatë.

- O, e zeza unë, ky paska roitur, po a e njeh ti, këtë? - tha ajo.

- Jo, nuk e njoh! Po ky është patronazhist, o t'u mbylltë!

- Jo. E ke gabim. Pse kjo tullumbacja-kmesë qenka shenjë e këtyre, patronazhistëve?

- Jo, nuk e njoh dhe aq mirë, mos është shkop gome, apo shkop bejsbolli, nga ata të deputetëve?

- E ç'qenkan këto? Vetëm me të dëgjuar i kam!

- Ti më parashtro lutjen dhe unë fill ta shqyrtoj.

- Rrini këtu, atë bëni! - Murgu ia mori nga dora tullumbacen e gjatë, kmesën, u mendua një copë herë, pastaj belbëzoi me sa duket fjalë të ndyra, të cilat e përplaste fort duke i bërë enkas të pakuptueshme.

Ajo u fërkua me bërryl me djalin. Një erë e lehtë gushti fëshfërinte mbi kokat e tyre dhe tullumbacja-kmesë tundej plot shkëlqim sikur të ishte e qelibartë.

- Ky gënjejhet lehtë, me një fjalë goje, - tha murgu. - Jo më kot kmesa quhet kështu. Do të thotë t'këput n'mes! A gegnisht, kupton? Mirëpo ju ngatëroni gegnishten me atë që ha përmbrenda krimbi i politikës... Ç't'u bëjë atyre që i bren krimbi i estetikës? Me ata jo, s'bëhet shaka, duan shtatë kokë... Ne, - shtoi murgu, - dukemi teveqelë, po kemi sy, po të kapëm të qajmë...

- E marr me mend.

- Jo. E ku ke mend ti?

- Ke luajtur? Unë s'paskam mend, hë?

Unë jam aktiviste vullnetare! Ne jemi me zë të veçantë në buxhetin e shtetit...

- Ti duket se merr vesh, po ai s'ia thotë fare...

- Je e bindur se ka dorë?

- Më lër të mendohej, zuskë, duhet të rrih me mua se më ngacmon, veç të tjerave, një patronazhist dhe një aktiviste vullnetare shkojnë, apo jo?...

Pas pak, dy metra më tej, u ulën pranë një tryeze.

- Faleminderit, - belbëzoi murgu - të paktën gjeta vendin ku të çlodhem në këtë qytet ku s'ka galeri, biblioteka dhe salla ekspozitash. Kjo është çështje nostalgjie për zanatin e vjetër të sigurimsit.

- Ti sa je kthyer nga Greqia? - pyeti ajo të gjatin.

- Nga e kuptove?

- Se shikon përherë anash, si lepur, sikur e ndjek njeri.

- Dua të rri vetëm. Nuk dua të kthehem më andej!... Por, jo, ende s'guxoj, më dhemb zemra, s'kam as shtëpi, as katand!... Pastaj këtu dua të martohem... Jetojmë në një vend që rron me zakone, me rrapëllima e duke pëshpëritur.

Djali i gjatë dhe i sertë erdhi përsëri në vete dhe shqyente sytë e mëdhenj duke u dridhur. Ajo e tërhiqte, e tundonte, por ja që ata të dy shkëmbenin mendime me njëritjetrin. Kurse ai mbetej doemos jashtë, ulej e ngrihej në karrige dhe këqyrte i habitur dy miza që kryenin fët-fët aktin seksual në fluturim dhe nuk i afroreshin më njëra-tjetrës. Edhe insektet të jenë kaq të paturpshëm? Shiko si shfaqet ajo: trulllosëse, tejet eksituese, e epshtë gjer në marrëzi. Të jenë të gjitha kështu aktivistet vullnetare? I ngjante, kështu iu bë, kmesës-tullumbace. Po dhe pikë.

Njeri i çuditshëm, ky murgu! Vërtet t'i hyjë në punë tërë ajo tullumbace e gjatë? I fantaksur! Se prapamendimet i ka të rënda, jo dokudo, ndoshta kemi të bëjmë me një fenomen. Dhe lëre-lëre, por të hedh me sy te Kroi i Vërës! Krua i padëgjuar. Do t'i ketë ndodhur ndonjë apokalips këtij të godituri? Do ta kem zili... Sidomos për kmesën. Ajo seç ka një lirizëm të freskët dhe elegancë, pa e fshehur theksimin e zmadhuar të volumeve, formave e vijave. Kurse murgu kërkon që të hapë sa më shpejt vrimën e misterit.

- Ti s'më the? - Ishte zëri i saj sërish dhe murgu u drodh. I erdhi për të qarë, por lëvizi tullumbacen-kmesë që befasi u shfry dhe fluturoi në ajër me shpejtësi, duke lënë në këmbët e tyre një nepërkë elektronike, që lëvizte si të ishte vërtetë e gjallë...

- Iku, - tha djali. Mos ka vajtur në Kroin e Vërës?

Murgu mbeti pa gojë. U shfry edhe ai. Djali i gjatë i ardhur nga Greqia, i Panjohuri i asaj dite, qeshi aq fort sa të gjitha krojet u thanë dhe ai mbeti i hutuar, në pritje për të parë një kmesë të vërtetë, si shenjë tundimi...

RITUALI PA FJALËN VDEKJE

Asgjë nuk i ngjan më shikimit tënd
Ndonëse pritja hidhërohet me dashurinë
Tashmë imagjinata aty ka zënë vend
Edhe kur qielli mësohet me vetminë

Asgjë nuk ndodh as në mesnatë
Ndonëse hijet tashmë kanë ikur
Malli vjen nga e njëjta shtrëngatë
Edhe kur të gjithë qirinjtë janë fikur

Asgjë nuk pëshpërit pa zërin e bekuar
Dikur "më shumë dritë" kërkonte Gëte
Nuk dridhen buzët në lojën e mashtruar
Të dashuruarit i marrin ëndrrat me vete

Çdo gjë fundoset e ringjallet përsëri
Hyji i dashurisë e ndjek yllin e vet
Poetët udhëtojnë deri në pavdekësi
Këto gjëra do të përsëriten me mijëra vjet

ATA SY JANË SIKUR SHIU

Ata sy janë sikur shiu
Sikur zjarri është dashuria
Secilën puthje çasti e përciu
Kur zgjohet prapë nostalgjia

Ato buzë nuk i prek më shkrumbi
Sa herë pëshpërisin mallin e ri
Ditën tjetër pritja humbi
Me të njëjtën fantazi

Ato ëndrra nuk i duron më nata
Edhe kur loja merr fund
Fjalët prapë i merr shtrëngata
Fluturat e bardha s'janë askund

Ata shpirtra janë të njëjtë
Asnjë dhimbje nuk i tret
Ngjajnë me ritualin e shenjtë
Sikur zogjtë në qiellin e vet

GËRSHETI I MËRZITUR

Dikur më pëlqente shikimi i syve
Dhe fishkëllima e erës në mesnatë
Hëna që buzëqeshte midis yjeve
Më pëlqente edhe fjala uratë

Tani malli ka emrin e vet
Kur e marrim me vete çdo mbrëmje
Fjala e ëmbël nga durimi pëlqet
Sa herë e ndiejmë të njëjtën dhembje

Dikur edhe nata kishte frikë
Si ndonjë çast i zemëruar
Ndoshta vetmia më nuk ik
Ndoshta nostalgjia na ka harruar

Tani përse e fshehim zjarrminë
Sikur ëndrrën e dremitur
Prapë e ndiejmë të njëjtën drithërimë
Kur ti thur gërshetin e mërzitur

SI DASHURIA PËR TY

Ka ra malli
Ka ra malli me fjetë
Si dashuria
Me përkund të njëjtin fat
Me dashtë një dallëndyshe
Me flatra të bardha
Si dikur
Me ikë e me pa dhimbjen
Si nuk vdes në shi
Me e marrë me vete
Atë zjarr të buzëve

**SALI BASHOTA****Orari i ri i ëndrrave**

Me ia heq shkrumbin
Deri te pragu i vendlindjes
Pa lënë asnjë gjurmë
Si dikur
Ka ra malli me fjetë
Si dashuria për ty

DREMITJE

Shkuan edhe ata atje
Sa shpejt shkuan
Siç shkojnë ditët e netët
Kur i krehim flokët para pasqyrës
Malli na pikon nëpër faqe
Derisa e harrojmë frikën
Ta bartim menjëherë
Si dremtitjen e fundit
Të ngujuar në shpirtra
Shkuan edhe këta afër nesh
Sa shpejt shkuan

NUK DUA TË VDES MË

Një herë kam vdekur
Në tokën e askujt
Ishte fillimi i pranverës
Binte shi si do Zoti
Treni i zi fishkëllonte
Ndërsa erërat ishin zemëruar
Me retë
Prandaj nuk dua të vdes më
Herën tjetër kam vdekur
Duke kënduar rrugëve
Me një trëndafil në dorë
Binte shi si di Zoti
Nëna nuk iu besonte syve
Si mund të vdisja ashtu i bukur
Pa thënë asnjë fjalë
Prandaj nuk dua të vdes më

RITUALI ME EMËR TË VËRTETË

Në fillim ishte zjarri
Që luante me vdekjen
Pa i djegur të gjitha fjalët
Pa i shqyer zërat
Për disa sekonda
Ndoshta biem majtas

Pa i mbyllur sytë
Aty ku flinin gjarpërinjtë
Dhe qyqja e pikëllimit
Djathtas biem si engjëjt
Pa e trembur dashurinë
Prapë kur vjen koha e gjumit
Biem një nga një
Në shtratit e Prokrustit
Ai që bie i pari
Do të pajtohet me ferrin
Pa njohur asnjë mëkat
Ndoshta biem
Në fund të ëndrrave
Pa e marrë çmimin e ri të dhimbjes
Përnjëmend biem
Me shpejtësinë e shikimeve
Përpara pasqyrës së mjegulluar

NJË PËRMALLIM VJESHTE PËR NËNËN

Nëna vjen prapë në Prishtinë
Me një copë qiell të vendlindjes
Me aromën e mollëve të verdha
Sytë i mbushen lot
Duke përtypur lutjen e pambaruar
Që t'i përshtatet klithjes së vet
Në të njëjtën pikë
Retë e zeza i lë në harresë
Si mallëngjimin e heshtjes
Nëna vjen në Prishtinë
Me të gjitha rrudhat në fytyrë
Duke fshehur ofshamën
Në shpirtin e saj
Kur vjen nëna në Prishtinë
Me vete e merr hijen e shtëpisë
Heshtja rri e vetmuar
Mbi krahët e erës së jugut
Vetëm një dhimbje nuk e harron
Te varri i babait tim
Në Kodrën e Bashotëve
Asnjëherë nuk e harron
As shkrumbin e dorëshkrimeve të djegura
As vajin e fëmijëve të mi
Kur vjen nëna në Prishtinë
Me vete i merr të gjitha ëndrrat
Vetëm ëndrrën për Albumin e grisur
E lë në vend të sigurt
Derisa ta mësojë përmendsh
Dhimbjen time të parë

**NDOSHTA ËSHTË MË
E RËNDËSISHME HESHTJA**

Këtu është
Zëri i shiut
Atje pak më larg
Është zjarri i ëndrrave
Pak më larg
Është vetmia e humbur
Si pulëbardhë e lagur
Eja të çmendemi bashkë
Një ditë të zakonshme
Me shi
Atje është pëshpëritja
Me buzë shkrumbi
Ndoshta është më e rëndësishme
Vetëm heshtja

**NË SAN DIEGO TAKOVA NJË GRUA TË
BUKUR**

Ajo më buzëqeshi
Sikur të ishim njohur
Para dy mijë vjetësh
Ajo kishte sy të kaltër
Si unë
Dhe një shenjë në faqe
Si Helena e Trojës
Më tha eja të vdesim
Në çastin kur perëndon dielli
Vetëm sytë mos i mbyll
Se prapë mund të vdesim
Në vendin e duhur

ORARI I RI I ËNDRRAVE

Një natë vjeshte me hënë
Vetmia pajtohet me mllefën e vet
Pa përfunduar orari i ri i ëndrrave
Derisa shikimet luajnë me zjarr
Çka më thua Jorge Luis Borges
A duhet të verbohemi edhe unë
Një ditë kur hesht shpirti
Kush ma kthen dritën e syve
Kur e lidhin vdekjen me zinxhirë
Për ta emërtuar një rrugë me emrin tim
Çka më thua Jorge Luis Borges
A duhet t'i zbusim gjarpërinjtë
Për ta pakësuar zemërimin
Kur pëlqet ai çast i frikësuar
Disa dhimbje të tjera
Shkojnë atje ku s'vdes malli i shpirtave
Çka më thua Jorge Luis Borges
A i harrojmë gjithmonë hijet e dehura
Kur shtrëngata e humb rrugën
Ndoshta vjen ajo ditë e lumtur
T'i japim fund lojës së mëkatit
Çka më thua Jorge Luis Borges
Nëse i grisim të gjitha fjalët e pathëna
Edhe kur toka sillet rreth dashurisë
Një natë vjeshte me hënë

NJË RE E BARDHË DHE NJË RE E ZEZË

Një re e bardhë
Një re e zezë
Prapë e njëjta ëndërr e këputur
Si në balada
Dhe një tufë lule
Në shenjë përmallimi
Asgjë tjetër
Midis dritës dhe errësirës
Asnjë gjarpër
Si Boa ynë
Një re e bardhë
Një re e zezë
Prapë i njëjti zjarr i dritës
Mbi dallgët e shpirtit
Si në legjenda

FJALËT

Pas një mijë vjet udhëtimi nëpër natë
Një Zot i mirë, kujtesa, sërish,
Bekimin tuaj të parë ma ka dhënë.

Dhe, i lektisur,
I tëri i lektisur pas jush tash jam,
Po humësira kohësh, nganjëherë,
Perde muri midis nesh, sërish po vënë.

Ndaj, të vërtetën me thanë,
Me dalë nga shpellë e Arkadisë
Njashtu si Hermes, dëshirë kam.

Bashkë me ju, edhe nga Olimpi vrashtar
Në rrugën e Hermes Trismegistit
Përgjithmonë, me dalë kisha dashtë.

NË MENDIM I RËNDË, PLUMB I RËNDË

Një mendim i rëndë, plumb i rëndë,
I ritë paksa me dy riga lot
Në një botë të mbyllur dikur ka rënë.

Ka rënë,
Oh, ka rënë atëherë kur dole nga bota
Që përnjëmend e pafajme si loti ka qenë.

Kur s'kish histori, Marks, Lenin, Stalin,
Komunistë, që kudo mbollën lemeri.

Kur ishe mall, mall i djegur vere,
I mërguar bashkë me retë
Në qiellin e pamatë.

Kur bota, qiejt, yjzit, që të gjithë,
Një përmasë kishin; përmasën e ëndrrës
Së një fijeje të njomë bari kishin.

E di, koha,
Koha të gjitha i mori,
I mori e i dogji dhe hi të gjallë
Në një qoshe të gjithësisë i ka lënë.

I ka lënë, qëkur i ka lënë,
Oh, atëherë kur dole nga bota
Që njëmend e pafajme si loti ka qenë.

PRANVERË

(Në kujtim të H.)

Tretur diku thellë, në një botë largët,
Vagullt, si në një hapësirë të pafund,
Midis mijëra të tjerash, krejt vetmitare,
Një lule, vetëm një lule sot shoh.

Një lule, e vetme, dikur Luledritë,
Që emrin më bukur, në një ag të lashtë,
Para Sokratit, ia ka dhënë Diotima.

Po më thuaj,
Ashtu siç ke qenë, e heshtur, gojëzanë,
Në një botë të vogël, si prej qiejsh e rënë,
Pse midis nesh koha, kaq mure ka vënë.

Oh, mure,
Mure hekuri koha ka vënë,
Që kurrë, tash e një mijë vjet,
Këta dy sy me t'pa s'i ka lënë.

Po shumë,
Shunë kisha dashtë me t'pa dhe një herë,
Ashtu siç dikur, para një mijë vjetësh,
Këto dy ninëza drite të kanë pikëzuar.

MAHNITJA E PARË

I falem një zjarri të lashtë
Të lashtë e të perëndishëm
Që ende na e ruan Mahnitjen e Parë.

Mahnitjen e Parë,
Kur sytë tanë, sy prej drite e yjesh,
Botën, ashtu në heshti, të bukur,
Të bukur e të plotë, e kanë parë.



DEMË TOPALLI

Fjalët

Oh, e kanë parë
Dhe për botë të largëta, aq të bukura,
Tashmë të tretura nëpër kohë,
Na e ruajnë mallin e, nganjëherë,
Besa, na bëjnë edhe me qa.

VOTRA

Shumë, shumë kisha dashtë,
Sikur Zoti im i parë, aq i mirë,
Të m'i jepte sonte një mijë palë sy.

Oh, një mijë palë sy
Dhe nëpër të tjera shtigje,
Shtigje prej resh e yjzish
Me ardh e me hy në ty.

Me ardh e me hy sërish në ty
E me pa zjarrin e parë,
Me pa, ashtu në heshti me pa
Zjarrin e shndërruar në hi.

Oh, zjarrin,
Zjarrin e shndërruar përgjithnjë në hi
Që thellë, thellë në vetvet mbruan
Aq shumë gëzime, makthe e histori.

LUMI STIKS

Prej balte, i tëri prej balte je.

Sytë e tu të errur, sy prej nate,
Si shigjetë helmi vijnë e në ne hyjnë,
Hyjnë, kur shpirti ynë të jetë ligështuar.

Hyjnë thellë, thellë, e rritën, rritën
Derisa në një gropë të zezë, futë të zezë,
Shpirti ynë të mos jetë shndërruar.

E lashtë,
E lashtë është kjo ligështi njerëzore
Që aq shumë jetë në zi ka mbular.

KAFAZ

Prej një zjarri të lashtë malli
Dhe copëza të tretura kujtimesh
Një mjeshtër gojëzanë të ka bërë.

Një mjeshtër gojëzanë,
I lënë aty ku koha dhe historia
Rregulla hekuri kishin vënë.

Herët, midis një makthi fillesash,
Një Zot i mirë e i urtë doli e tha:
Hy! Këtë kafaz të frikshëm, për ty,
Kopsht lumnie kam për ta bërë.

Të falem,
Për këtë iluzion muresh të verbra,
Shumë të falem, o Zot i mirë,
Po, muzg i vonë të më zërë këtu
Njëmend s'kisha me dëshirue.

Vetëm, të lutem, më thuaj,
Nga cila derë mundem me dalë pra,
Me dalë e me çel dyer të ndryra kohësh
Se ndoshta këta dy sy ende dinë me pa.

NJË EMËR

S'është emër i krijuar sipas një rendi njeriu
Po emër i parë i rënë në tokë nga qielli.

I rënë në një kopsht të bërë nga mëkati,
Ku një Zot, që në agun e parë të botës
Shumë, shumë nga gjërat e bukura
Na i ka ndaluar.

Na i ka ndaluar
Dhe një rend tjetër, krejt tjetër,
Prej vuajtjesh, mëkati e vdekjesh
Në Tokë e ka krijuar.

E ka krijuar,
Që ne bijtë vdekatarë prej mëkati
Me mujt me shkruet e vetëm me shkruet.

KA ÇASTE

Ka çaste prej makthi nate
Dhe botë të tretura nëpër hone kohësh
Që nganjëherë vijnë e ma ngushtojnë
Këtë hapësirë prej librash e mendimi.

Ka çaste,
Çaste prej shumë netësh e ditësh
Që më bëjnë të zgavërt e të papeshë
Njësoj sikurse vetë zbrazëtia.

Ka çaste,
Që prej ftohëri hapësirash shpesh vijnë
E më bëjnë si me qenë prej druri.

Ka çaste,
Kur mendimi mbyllet deri errësim
Dhe fjalët vijnë krejt të sflitura, vdesin,
Vdesin ende pa rënë në letrën e bardhë.

Disa shkrime të
mediave kineze
për vdekjen e
Kadaresë

Përgatiti
Iljaz Spahiu
Sinolog

The Paper, platformë mediatike me qendër në Shanghai, në një informacionin të gjatë për Kadarenë shkruan se, më 1 korrik u nda nga jeta shkrimtari më i njohur shqiptar, fituesi i parë i Çmimit Man Booker, prej disa vitesh me radhë pretendenti më i zëshëm i Çmimit Nobel. Pasi flet për jetën dhe krijimtarinë letrare të Kadaresë, ajo numëron disa nga veprat e tij të përkthyer e botuara në Kinë si dhe çmimet e shumta që ai ka merituar në vende të ndryshme të botës.

Portali Letërsisë dhe Kulturës Phoenix, me qendër në Hongkong, gjithashtu duke njoftuar ndarjen nga jeta të Kadaresë, përmend disa nga veprat më përfaqësuese të tij dhe nënvizon se kritika letrare e kakrahasuar shpesh atë me Kafkën dhe Kunderën. Romanet e tij me përshkrime në dukje absurde, pasqyrojnë artistikisht realitetin shoqëror. Për fat keq, shkruan ky portal, Çmimi Nobel e humbi Kadarenë.

Qendra e Studimeve Albanologjike në Fakultetin e Gjuhës shqipe pranë Universitetit të Gjuhëve të Huaja në Pekin, në shkrimin me titull "Ndërron jetë Kolosi i Letrave shqipe", thekson se Kadare është shkrimtari shqiptar me ndikimin më të madh në botë. Veprat e tij të përkthyer e botuara në rreth 45 gjuhë të ndryshme, janë botuar gjithashtu nga disa shtëpi të njohura botuese në Kinë, duke e bërë atë një shkrimtar të njohur e të dashur për lexuesit kinezë.

Po ashtu, media të ndryshme duke pasqyruar lajmin e vdekjes së Kadaresë, tregojnë edhe për një takim që Yu Hua, një nga shkrimtarët më të njohur kinez, ka pasur me Ismail Kadarenë. "Në verën e vitit 1998, jam takuar me Kadarenë në Torino. Ishim ulur bashkë në restorantin e Teatrit të Torinos dhe bisedonim me anë të një përkthyesi, ndërsa në mungesë të tij hanim e pinim. Atë kohë Kadare banonte në Francë. Ai është shkrimtari më i rëndësishëm shqiptar dhe si shumë shkrimtarë nga vendet e Evropës lindore, dikur nuk mund të kthehej në atdhe. Kur u takuam ne, nuk ekzistonte më ky problem. Ai mund të kthehej kur të donte, por më tha se nuk kthehem shumë shpesh. Arsyeja është se, sa herë që kthehem ndjehem shumë i lodhur. Sapo kthehem, shtëpia e tij ziente nga njerëzit, tamam si një kafe-bar, ku mblidhen njerëz të njohur e të panjohur. Gjithmonë do të ishin të paktën 20 vetë."

1970, romani i një shkrimtari të panjohur shqiptar pati sukses të madh dhe të shpejtë në Parisin letrar. "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" ishte historia e një gjenerali italian që kthehet në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore për të gjetur trupat e ushtarëve italianë të vrarë atje dhe për t'i kthyer në Itali për t'i varrosur. Ajo u cilësua si një kryevepër dhe autori i saj u ftua në Francë, ku u prit nga intelektualët francezë si një zë origjinal dhe i fuqishëm nga pas perdes së hekurt. "Gjenerali" u përkthye në një duzinë gjuhësh dhe frymëzoi dy filma: njëri me të njëjtin titull të Michel Piccoli-nit, dhe të shkëlqyerin tjetër "Jeta dhe asgjë tjetër" të Bernard Tavernier - it.

Që atëherë, mbi një duzinë romanesh dhe disa përmbledhje me poezi dhe ese të tij janë përkthyer në frëngjisht, anglisht dhe gjuhë të tjera. Ai konsiderohet si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të botës dhe është propozuar disa herë për çmimin Nobel. Botuesit francezë po botojnë aktualisht veprën e tij të plota në gjashtë vëllime, si në frëngjisht ashtu edhe në shqipen origjinale. Tre të parat tashmë janë botuar.

Ismail Kadare lindi dhe u rrit në qytetin e Gjirokastrës në Shqipëri. Studioi letërsi në Universitetin e Tiranës dhe bëri tre vjet studime pasuniversitare në Institutin Gorki në Moskë. "Gjenerali" ishte romani i parë, i botuar pas kthimit në Shqipëri në vitin 1962, kur ishte njëzet e gjashtë vjeç.

Kadare është krahasuar me Kafkën dhe Orwell-in, por zëri i tij është origjinal, njëkohësisht universal dhe i rrënjësor thellë në tokën e tij. Për më shumë se dyzet vjet Shqipëria jetoi nën diktaturën komuniste të Enver Hoxhës, stalinizmi veçanërisht i egër i të cilit zgjati më shumë se në çdo vend tjetër të Europës Lindore. Kadare përdori një sërë zhanresh dhe mjetesh letrare - alegorinë, satirën, distancimin historik, mitologjinë - për t'i shpëtuar censurës së pamëshirshme të Hoxhës dhe raprezaljeve vdekjeprurëse kundër çdo forme mendimi ndryshe. Vepra e tij është një kronikë e atyre dekadave të tmerrshme, megjithëse historitë shpesh janë vendosur në të kaluarën e largët dhe në vende të ndryshme. Ngjarjet e dy romaneve të tij më të famshme, "Pallati i ëndrrave" dhe "Piramida", zhvillohen përkatësisht gjatë Perandorisë Osmane dhe në Egjiptin e lashtë, ndërsa "Dimri i madh" dhe "Koncerti" i referohen qartë shkëputjes së Hoxhës nga Rusia nën Hrushovin dhe nga Kina pas vdekjes së Maos.

Ismail Kadare u largua nga Shqipëria në vitin 1990 dhe u vendos në Paris. Në vitin 1996 ai u zgjodh anëtar i asociuar i Akademisë Franceze të Shkencave Morale dhe Politike (L'Académie des Sciences Morales et Politiques), duke zëvendësuar filozofin britanik me origjinë austriake Karl Popper, i cili vdiq atë vit.

Ai jeton me gruan dhe vajzën në Latin Quarter, në një apartament të gjerë dhe të ndritshëm me pamje nga kopshtet e Luksemburgut; udhëton shpesh në Shqipëri. Kjo intervistë u zhvillua në shtëpinë e tij në shkurt dhe tetor 1997, me biseda telefonike ndërmjet tyre.

Kadare ka reputacionin se nuk i para ka shumë qejf të paditurit, por me mua u tregua i butë, i sjellshëm dhe shumë i durueshëm me dikë që nuk e njeh vendin dhe letërsinë e tij, të cilave ai u përkushtohet me pasion. Ai flet rrjedhshëm frëngjisht me theks të veçantë, zë të qetë e të matur.

SHUSHA GUPPY: Jeni shkrimtari i parë shqiptar bashkëkohor që keni arritur famë ndërkombëtare. Për shumicën e njerëzve, Shqipëria është një vend i vogël me tre milionë e gjysmë banorë në skaj të Evropës. Pra, pyetja ime e parë ka të bëjë me gjuhën shqipe. Çfarë është ajo?

ISMAIL KADARE: Gjysma e popullsisë

Në shenjë nderimi për Ismail Kadarenë The Paris Review ribotoi dhe bëri të mundur leximin në format elektronik të intervistës së verës së vitit 1998.

KADARE: DOJA TË MBETESHA SHKRIMTAR DHE I LIRË

përktheu Granit Zela



shqiptare jeton në Jugosllavinë fqinje, në rajonin e Kosovës. Gjithsej, dhjetë milionë njerëz në botë flasin shqip, që është një nga gjuhët themelore europiane. Nuk po e them këtë për krenari kombëtare, është një fakt. Nga pikëpamja gjuhësore, ekzistojnë gjashtë ose shtatë familje themelore të gjuhëve në Europë: latinishtja, gjermanishtja, sllavishtja, baltikja (që flitet në Letoni dhe Estoni) dhe tri gjuhë, si të thuash, pa familje, - greqishtja, armenishtja dhe shqipja. Prandaj gjuha shqipe është më e rëndësishme se vendi i vogël ku flitet, pasi zë një vend të rëndësishëm në hartografinë gjuhësore të Europës. Hungarishtja dhe finlandishtja nuk janë gjuhë indo-evropiane.

Shqipja është gjithashtu e rëndësishme sepse është e vetmja pasardhëse e gjuhës së lashtë ilire. Në lashtësi kishte tre rajone në Evropën Jugore: Greqia, Roma dhe Iliria. Shqipja është e vetmja e mbijetuar e gjuhëve ilire. Kjo është arsyeja pse ajo ka intriguar gjithmonë gjuhëtarët e mëdhenj të së kaluarës. Personi i parë që bëri një studim serioz të shqipes ishte filozofi gjerman Gottfried Leibnitz në vitin 1695.

Ai që Volteri parodizoi te "Candide" si Dr. Pangloss, i cili tha: "Gjithçka është mirë në këtë më të mirën e mundshme të botëve".

Pikërisht. Megjithatë, Shqipëria nuk ekzistonte në atë kohë si një njësi më vete; ishte pjesë e Perandorisë Osmane si pjesa tjetër e Ballkanit, përfshirë Greqinë, por këtij gjeniu gjerman gjuha iu duk interesante. Pas tij, studiues të tjerë gjermanë bënë studime të gjata për shqipen, për shembull, Franz Bopp, libri i të cilit është shumë i detajuar.

Po letërsia shqipe? Cila është origjina e saj? A ka Dante, Shekspir apo Gëte shqiptar? Burimet e saj janë në thelb orale. Libri i parë letrar në shqip u botua në shekullin e XVI dhe ishte një përkthim i Biblës. Vendi atëherë ishte katolik. Pas kësaj pati shkrimtarë. Ati themelues i letërsisë shqipe është shkrimtari i shekullit të nëntëmbëdhjetë Naim Frashëri. Pa pasur madhësinë e Dantes apo të Shekspirit,

ai është gjithsesi themeluesi, personazh emblemantik. Shkroi poezi të gjata epike, si dhe poezi lirike, për të zgjuar ndërgjegjen kombëtare të Shqipërisë. Pas tij erdhi Gjergj Fishta. Mund të themi se këta të dy janë gjigantët e letërsisë shqipe, ata që fëmijët studiojnë në shkollë. Më vonë erdhën poetë dhe shkrimtarë të tjerë që ndoshta krijuan vepra më të mira se ata të dy, por nuk zënë të njëjtin vend në kujtesën e kombit.

Turqit morën Kostandinopojën në 1454, dhe më pas pjesën tjetër të Ballkanit dhe Greqinë. Cili ishte ndikimi i turqishtes në shqipen?

Gati i papërfillshëm. Përveç ndikimit në fjalorin administrativ ose në gatim, fjalë si qebab, kafene, pazar. Por ajo nuk pati asnjë ndikim në strukturën e gjuhës për arsyen e thjeshtë se ato janë dy makineri krejtësisht të ndryshme dhe njëra nuk mund të përdorë pjesët e këmbimit për tjetrën. Gjuha turke nuk njihet askund jashtë Turqisë. Turqishtja moderne është krijuar nga shkrimtarët turq të shekujve XIX dhe XX, ndërsa turqishtja e thatë administrative nuk ishte një gjuhë e gjallë dhe për këtë arsye nuk mund të kishte ndonjë ndikim në gjuhët e tjera të Perandorisë Osmane. Kam takuar shkrimtarë turq që më kanë thënë se kanë probleme me gjuhën e tyre.

Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e fjalorit të huaj ka hyrë në persishten - turke, arabisht, frëngjisht, ndër të tjera. Përpara kohëve moderne, autorët turq shkruanin në persisht, ose në arabisht nëse tema ishte teologjia.

Për mua si shkrimtar, shqipja është thjesht një mjet shprehës i jashtëzakonshëm - i pasur, i elastik, me aftësi përshtatëse. Siç e kam thënë në romanin tim të fundit, "Spiritus", ajo ka mënyra (modalitete) që ekzistojnë vetëm në greqishten klasike, gjë që e vë njeriun në kontakt me mentalitetin e antikitetit. Për shembull, ka folje të shqipes që mund të kenë një kuptim urues ose mallkues, ashtu si në greqishten e vjetër, dhe kjo lehtëson përkthimin e tragjedi greke, si dhe të Shekspirit, ky i fundit si autori

më i afërt europian me tragjedianët grekë. Kur Nietzsche thotë se tragjedia greke bëri vetëvrasje e re sepse jetoi vetëm njëqind vjet, ai ka të drejtë. Por në një vizion global ajo ka mbijetuar deri në kohën e Shekspirit dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Nga ana tjetër, besoj se epoka e poemës epike ka përfunduar. Për sa i përket romanit, ai është ende shumë i ri. Sapo ka filluar.

Megjithatë vdekja e romanit është parathënë për pesëdhjetë vjet me radhë!

Ka gjithmonë njerëz që thonë shumë marrëzira! Por në një këndvështrim universal, nëse romani do të zëvendësojë dy zhanret e rëndësishme të poemës epike - e cila është zhdukur - dhe të tragjedisë - që vazhdon - atëherë sapo ka filluar dhe ka ende edhe dy mijë vjet jetë.

Më duket se në veprën tuaj jeni përpjekur të përfshini tragjedinë greke në romanin modern.

Pikërisht. Jam përpjekur të bëj një lloj sinteze të tragjedisë së madhe dhe groteskut, shembulli sipëror i së cilës është Don Kishoti, një nga veprat më të mëdha të letërsisë botërore.

Romani që atëherë është ndarë në shumë zhanre...

Aspak! Për mua këto ndarje në zhanre nuk ekzistojnë. Ligjet e krijimit letrar janë unike; ato nuk ndryshojnë dhe janë të njëjta për të gjithë, kudo. Dua të them që mund të tregosh një histori që mbulon tre orë të jetës njerëzore ose tre shekuj - bëhet fjalë për të njëjtën gjë. Çdo shkrimtar që krijon diçka autentike në mënyrë të natyrshme, instinktivisht krijon edhe teknikën që i përshtatet. Pra, të gjitha format apo zhanret janë të natyrshme.

Dëgjo, mendoj se në historinë e letërsisë ka pasur vetëm një ndryshim vendimtar: kalimi nga oraliteti te shkrimi. Për një kohë të gjatë letërsia ishte orale, dhe më pas papritur me babilonasit dhe grekët erdhi shkrimi. Kjo ndryshoi gjithçka, sepse më parë, kur poeti recitonte ose e këndonte poezinë e tij, ai mund ta ndryshonte në çdo rast sipas dëshirës, ishte i liri. Në të njëjtën mënyrë ishte kalimtar, pasi poezia e tij ndryshonte gjatë përcjelljes gojë më gojë nga një brez në tjetrin. Pasi të shkruhet, teksti bëhet i ngulitur. Autori fiton diçka duke u lexuar, por humb edhe diçka, lirinë. Ky është ndryshimi i madh në historinë e letërsisë. Zhvillimet e vogla si ndarja në kapituj dhe paragrafë, shenjat e pikësimit, janë relativisht të parëndësishme; janë detaje.

Për shembull, thonë se letërsia bashkëkohore është shumë dinamike sepse ndikohet nga kinemaja, televizioni, shpejtësia e komunikimit. Por e kundërta është e vërtetë! Nëse krahasoni tekstet e antikitetit grek me letërsinë e sotme, do të vini re se klasikët vepronin në një terren shumë më të madh, të pikturuar në një kanavacë shumë më të gjerë dhe kishin një dimension pafundësisht më të madh - një personazh lëviz midis qiellit dhe tokës, nga një hyjni për te një i vdekshëm, dhe përsëri, në asnjë kohë! Shpejtësia e veprimt, vizioni kozmik në një faqe e gjysmë të librit të dytë të Iliadës është e pamundur të gjendet tek një autor modern. Historia është e thjeshtë: Agamemnoni ka bërë diçka që nuk i ka pëlqyer Zeusit, i cili vendos ta ndëshkojë. Ai thërret një lajmëtar dhe i thotë të fluturojë në tokë, të gjejë gjeneralin grek të quajtur Agamemnon dhe t'i fusë një ëndërr mashtruese në kokë. Lajmëtar i mbërrin në Trojë, gjen Agamemnonin në gjumë, i derdh një ëndërr mashtruese në kokë si lëng dhe kthehet përsëri te Zeusit. Në mëngjes Agamemnoni thërret komandantët e vet dhe u thotë se ka parë një ëndërr të bukur dhe se duhet të sulmojnë trojanët. Ai pëson një disfatë dërrmuese. E gjithë kjo në një

faqe e gjysmë! Kalohet nga truri i Zeusit tek ai i Agamemnonit, nga qielli në tokë. Cili shkrimtar mund ta shpikë këtë sot? Raketat balistike nuk janë aq të shpejta!

Megjithatë, ka pasur ngjarje letrare si modernizmi - Xhojsi, Kafka...

Kafka ishte shumë klasik, po ashtu edhe Xhojsi. Kur Xhojsi u bë vërtet modernist te "Zgjimi i Fineganëve", dështoi. Shkoi shumë larg dhe askush nuk e pëlqen atë libër. Edhe Nabokovi, një admirues i madh i Xhojsit, tha se ishte i pavlerë. Ka shpikje dhe risi që nuk janë të pranueshme, sepse ekziston një damar që nuk mund ta presësh pa u ndëshkuar, ashtu siç nuk mund të zhdrukësh disa aspekte të natyrës njerëzore. Një burrë takon një grua dhe ata bien në dashuri. Në këtë dashuri ekzistojnë të gjitha mundësitë, larmishmëritë, por askush nuk mund ta imagjinojë këtë grua me trupin e një krijese tjetër. Nëse ka një shkëputje totale nga realiteti, ai është fundi - njeriu hyn në fushën e shenjave.

A doni të thoni se ka një farë vazhdimësie në krijimtarinë njerëzore?

Pikërisht. Ne jemi në një farë mënyre të kurthuar nga e kaluara e njerëzimit; nuk kemi nevojë të dimë psikologjinë, le të themi, të krokodilëve apo gjirafave. E kaluara mund të jetë një barrë, por nuk mund të bëjmë asgjë për këtë. E gjithë kjo zhurmë për risitë, zhanret e reja, është e kotë. Ka letërsi të vërtetë dhe pastaj është pjesa tjetër.

Ju keni folur edhe për "krijimin negativ". Çfarë doni të thoni me këtë?

Krijim negativ për një shkrimtar është ajo që ai nuk shkruan. Të duhet një talent i madh për të ditur se çfarë nuk duhet të shkruash, dhe në ndërgjegjen e një shkrimtari veprat e pashkruara janë më të shumta se ato që ai ka shkruar. Ti bën një zgjedhje. Dhe kjo zgjedhje është e rëndësishme. Nga ana tjetër, njeriu duhet të çlirohet nga këto kufoma, t'i varros, sepse ato e pengojnë të shkruajë atë që duhet, ashtu siç është e nevojshme të pastrohet një gjermadhë për të përgatitur vendin për ndërtim.

Kjo më kujton Cyril Connolly-n, i cili la thënë: "Librat që nuk kam shkruar janë shumë më të mirë se ato që kanë shkruar miqtë e mi". Por le të flasim për fillimet tuaja. Së pari për fëmijërinë tuaj: ishe shumë i vogël kur shpërtheu lufta, pas së cilës gjithçka ndryshoi në Shqipëri.

Fëmijëria ime ishte e pasur, sepse kam qenë dëshmitar i shumë ngjarjeve. Lufta filloi kur isha pesë vjeç. Unë jetoja në Gjirokastrë, një qytet shumë i bukur, nëpër të cilin kalonin ushtritë e huaja, ky ishte një spektakël i vazhdueshëm, italianët, grekët. . . qyteti u bombardua nga gjermanët, anglezët, kaloi nga një palë te tjetra. Për një fëmijë ishte shumë emocionuese. Jetonim në një shtëpi të madhe me shumë dhoma boshe ku luanim - një pjesë e rëndësishme e fëmijërisë sime. Familja ime atërore ishte modeste, babai im ishte njoftues gjysqi, njeriu që dërgonte letrat e gjykatës, por familja nga nëna ishte shumë e pasur. Në mënyrë paradoksale familja e nënës ishte komuniste, ndërsa babai ishte konservator dhe puritan. Bënim jetë modest në shtëpi, por kur shkoja në shtëpinë e gjyshit nga nëna, isha fëmijë i një familjeje të pasur. Im at ishte kundër regjimit komunist; nëna dhe familja e saj ishin pro tij. Nuk grindeshin për këtë, por e ngacmonin njëri-tjetrin me ironi dhe sarkazëm. Në shkollë nuk i përkisja as fëmijëve me prejardhje të varfër prokomuniste, as atyre të familjeve të pasura që ishin të tmerruara nga regjimi. Por unë i njihja të dyja palët. Kjo më bëri të pavarur, të lirë nga komplekset e fëmijërisë.

Pas shkollës u transferuat në Tiranë, kryeqytet dhe studiuar letërsi në universitet. Pastaj shkua në Institutin Gorki në Moskë. Ndodhi në kohën e Hrushovit, kur kishte një lloj çlirimi, një shkrirje pas ngrirjes së gjatë Staliniste. Si e gjetët skenën letrare në Moskë?

U dërgova në Institutin Gorki për t'u bërë shkrimtar zyrtar i regjimit - ishte një fabrikë për fabrikimin e pseudoshkrimtarëve dogmatik të shkollës socrealiste. Në fakt, u duhej tre vjet për të vrrarë çdo lloj aftësie në krijimtari, çdo origjinalitet që zotëroje. Për fat të mirë tashmë isha i imunizuar nga ajo që kisha lexuar. Në moshën njëmbëdhjetë vjeçare kisha lexuar "Makbethin", që më kishte goditur si rrufe, dhe klasikët grekë, pas leximit të tyre asgjë tjetër nuk kishte pushtet mbi shpirtin tim. Ajo që po ndodhte në Elsinor ose pranë mureve të Trojës më dukej më reale se i gjithë banaliteti i mjerë i romaneve socrealiste.

Në institut ma neveriste indoktrinimi, i cili në njëfarë mënyre më shpëtoi. Vazhdova t'i thosha vetes se në asnjë mënyrë nuk duhej të bëja atë që më mësuam, por krejt të kundërtën. Shkrimtarët e tyre zyrtarë ishin të gjithë skllëvër të partisë, me pak përjashtime si Konstantin Paustovsky, Chukovsky, Jevtushenko.

Gjatë qëndrimit tim në institut shkrova një roman me titullin "Qyteti pa reklama". Kur u ktheva në Shqipëri kisha merakun se mos ia tregoja ndokujt. Botova një fragment të shkurtër në një revistë të titulluar "Një ditë në kafene", i cili u ndalua menjëherë. Nuk kishte më asnjë diskutim për botimin e librit. Kreu i Organizatës së Rinisë Komuniste, i cili kishte rekomanduar botimin e tij, më vonë u akuzua për liberalizëm dhe u dënua me pesëmbëdhjetë vjet burg. Fatmirësisht ky fragment ekziston; përndryshe askush sot nuk do ta besonte kush që e kam shkruar romanin. Ishte historia e dy mashtruesve letrarë që duan të falsifikojnë një tekst për të provuar se ai mund t'i përshtatet marksizmit, për të përparuar kështu në karrierë. Ai përfshiu problemin themelor në thelbin e kulturës socialiste, falsifikimin. Ky roman do të botohet në vëllimin e gjashtë të veprave të mia të plota, që po përgatitin botuesit e mi francezë. Asnjë fjalë nuk do të ndryshohet.

Megjithatë, në adoleshencë ju tërhoqi komunizmi, apo jo?

Kishte një anë idealiste; ti mendoje se ndoshta disa aspekte të komunizmit ishin të mira në teori, por mund të shihje se në praktikë ishin të tmerrshme. Shumë shpejt kuptova se e gjithë godina ishte shtypëse, katastrofike.

Në institut, a ju lejohej të lexonit shkrimtarë të ndaluar ose disidentë si Pasternak, Ahmatova, Cvetajeva, Mandelshtam?

Kam lexuar Gogolin dhe Pushkinin dhe disa romane të Dostojevskit, veçanërisht "Nëndhesa e të vdekurve" dhe "Vëllezërit Karamazov".

Po në Shqipëri?

Në Shqipëri të gjithë këta shkrimtarë ishin të ndaluar. Herë pas here arrija të gjeja një vëllim kur udhëtoja jashtë vendit. Kam lexuar Orwellin dhe Kafkën. Mendoj se ky i fundit është më i rëndësishëm. Më pëlqeu "1984", por gati aspak "Ferma e kafshëve", sepse alegoritë e mbretërisë së kafshëve nuk më prekin shumë. Ajo që ndodhi në vendet totalitare ishte më e keqe se çdo gjë që letërsia ka shpikur ndonjëherë.

Orwell-i ishte unik në Angli. Në kohën kur shumica e intelektualëve ishin simpatizantë apo bashkëudhëtarë, ai e kuptoi natyrën e totalitarizmit dhe e ekspozoi atë.

Nuk mund ta kuptoja se si Sartri mund të mbronte Bashkimin Sovjetik. Gjatë Revolucionit Kulturor në Kinë, atij iu tha se mijëra shkrimtarë, artistë dhe intelektualë u persekutuan, u torturuan, u vranë. Dhe ai u bë Maoist!

Çfarë triumfi pas vdekjes për Kamyn, reputacioni i tij është shtuar gjatë viteve të fundit! Ai del të ketë pasur të drejtë për çdo çështje politike, ndërsa Sartri e ka pasur gjithmonë gabim. Kamyja qëndroi i palëkundur pavarësisht nga të gjitha trysnitë e ushtruara mbi të, gjë që nuk ishte e lehtë asokohe.

Kam respekt të madh për Kamyn, ishte shembullor. Shumica e intelektualëve perëndimorë që jetonin këtu, të lirë, të pa kërcënuar nga diktatura totalitare, prisnin që ne të tregonim guxim dhe të vinim në rrezik jetën tonë. Në Kinë ishte edhe më keq se në Shqipëri. Pse nuk protestuan intelektualët perëndimorë?

Ju u kthyet në Shqipëri në vitin 1960 dhe botuat romanin që do t'ju bënte të famshëm "Gjenerali i ushtrisë së vdekur". A ishte historia e mbështetur në një ngjarje të vërtetë, një gjermadhë të vërtetë varresh?

Enver Hoxha sapo ishte shkëputur nga Bashkimi Sovjetik, duke akuzuar Hrushovin për revizionizëm, për anim drejt Perëndimit.... duke tërhequr interesin e Perëndimit duke mëtua liberalizëm kulturor. Kundërshtimi i romanit tim erdhi nga kritika zyrtare pas botimit. Më fajësuan që nuk isha optimist, se nuk shpreha urrejtje ndaj gjeneralit italian, se isha kozmopolit e kështu me radhë.

Romani juaj i dytë, "Përbindëshi", trajtoi temën e ankthit politik. Si u prit?

"Përbindëshi" është historia e një qyteti ku një mëngjes të bukur shfaqet Kali i Trojës. Brenda kalit ka personazhe nga antikiteti - si Uliksi - që vetëm presin ditën kur qyteti do të bjerë. Por unë bëra diçka të çuditshme: Troja nuk bie; kali qëndron atje përgjithmonë. Njerëzit jetojnë në ankh të përherëshëm. Ata thonë, si do të jetojmë? Kjo ka vazhduar për tre mijë vjet dhe kali është ende atje. Ai është i përjetshëm. Çfarë mund të bëjmë? Ata pëshpëritin për komplete,

kërcënime dhe jeta nuk është normale. Për shkak se regjimi totalitar është themeluar mbi këtë paranojë për kërcënimet nga jashtë, atij i duhet një armik për të përligjur represionin.

Ky roman u ndalua. Pra, me çfarë keni jetuar? Sepse nëse dikush nuk do të ishte shkrimtar zyrtar, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve, nuk mund të bënte asgjë.

Ndonëse më botuan dhe më ndaluan, me radhë, sapo u botova dhe u bëra i njohur si autor, u bëra anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe merrja një rrogë mujore, e cila ishte e njëjtë për të gjithë, qoftë gjeni apo batakçi. Kjo pagë ishte një e mijëta e honorarëve që duhej të kisha marrë për numrin e librave që më shiteshin.

Në një klimë të tillë shtypjeje, si arritët që "Gjenerali" të përkthehej dhe të botohej në Francë?

Në Shqipëri, si në të gjitha vendet e Europës Lindore, ekzistonte një organizatë përgjegjëse për përkthimin e një numri librash në disa gjuhë të huaja të rëndësishme. Kështu ata e përkthejnë librin tim në frëngjisht. Rastësisht e pa gazetari Pierre Paraf, e pëlqeu dhe ia rekomandoi një botuesi francez.

Pas suksesit të madh në Perëndim, u ndjetë pak më i sigurt, i mbrojtur nga fama juaj ndërkombehtarë?

Po, por edhe më i vëzhguar, sepse më konsideronin të rrezikshëm.

Le të kalojmë tek ndikimet. Para së gjithash, interesi juaj për tragjedianët grekë, veçanërisht Eskilin për të cilin keni shkruar një ese të gjatë, "Eskili ky humbës i madh". Pse ai?

Pashë paralele mes tragjedisë greke dhe asaj që po ndodhte në vendet totalitare, para së gjithash atmosferën e kimit dhe luftën për pushtet. Merrni Shtëpinë e Atridëve, ku çdo krim çon në një tjetër derisa të gjithë të vriten. Në rrethin e Hoxhës kishte krime të tmerrshme. Për shembull, në vitin 1981, kryeministri Mehmet Shehu bëri "vetëvrasje" - i vrrarë nga Hoxha. Nga ana ime, unë isha disi i mbrojtur nga burgu prej famës time ndërkombehtarë, por jo nga kama, mund të më vrisnin dhe të thoshin se ishte një vetëvrasje ose një aksident me makinë.

Do të bëhem avokati i djallit, nëse mundem, dhe do të sugjeroj që në një shoqëri të tillë vetë mbijetesa bëhet e dyshimtë, si në Rusinë e Stalinit. Mund të përmendim ata që humbën jetën, si Mandelshtami, ose bënë vetëvrasje, si Cvetajeva, ose reshtën së shkruari, si Pasternaku - të zvogëluar në përkthimin e Shekspirit - dhe të tjerë pafund. Në vitin 1970 shkruat një roman me gjashtëqind faqe, "Dimri i madh", i cili nuk mbështetej në një mit apo një ngjarje historike, por në situatën aktuale politike në vendin tuaj. Libri juaj dukej se ishte sulm ndaj revizionizmit dhe si rrjedhim mbrojtje e Hoxhës. Çfarë arsyeje keni pasur për të shkruar librin? Në fund të fundit, mund të kishit vazhduar të shkruanit llojin e historive të fshehta, alegorike që kishit shkruar.

Nga viti 1967 deri në vitin 1970 kam qenë nën vëzhgimin e drejtpërdrejtë të vetë diktatorit. Mos harroni se për fatkeqësinë e madhe të intelektualëve, Hoxha e konsideronte veten si autor e poet e për rrjedhojë si "mik" të shkrimtarëve. Duke qenë se isha shkrimtari më i njohur i vendit, ai ishte i interesuar për mua. Në një situatë të tillë kisha tre zgjedhje: të përshtatesha me bindjet e mia, që do të thosha vdekje; heshtje e plotë, që nënkuptonte një lloj tjetër vdekjeje; ose të paguaja një haraç,



një taksë. Zgjedha zgjidhjen e tretë duke shkruar "Dimrin e madh". Shqipëria ishte bërë aleate e Kinës, por pati fërkime mes dy vendeve që më vonë çuan në një ndërprerje të marrëdhënies. Ashtu si Don Kishoti, edhe unë mendova se libri im mund ta përshpejtonte këtë shkëputje me "aleatin" tonë të fundit duke inkurajuar Hoxhën. Me fjalë të tjera, mendova se letërsia mund të realizonte të pamundurën – të ndryshonte diktatorin!

Ai libër është i vetmi, me sa di unë, në të cilin trajtoni drejtpërdrejt situatën politike. Përndryshe keni përdorur mjete të ndryshme maskimi - mitin, alegorinë, humorin. Po mendoj për "Piramidën" dhe "Pallatin e ëndrrave", të vendosura përkatësisht në Egjiptin e lashtë dhe në kohën osmane. Te "Piramida", Faraoni Keops dëshiron të ndërtojë një piramidë që do të ishte më e madhe dhe do të zgjaste më shumë se çdo tjetër, një sipërmarrje që përlligj dhe legjitimon çdo sakrificë, çdo shtypje. Te "Pallati i ëndrrave", kontrolli dhe klasifikimi i ëndrrave shkollon keq. A i kuptuan lexuesit tuaj në Shqipëri aludimet për perandorinë sovjetike dhe për faraonin Hoxha?

Po. Ata e panë qartë që unë aludoja për perandorinë komuniste, prandaj e ndaluan "Pallatin e ëndrrave".

A u ndikuat nga shkrimtarët që përdorën të njëjtat mjete, si Bulgakovit te "Mjeshtri dhe Margarita", Zamyatinin te "Ne", që frymëzoi "1984", i Orwell-it, si dhe Hrabal dhe Kundera, ose Kafka te "Kështjella" dhe "Gjyqi" - prototipet e një sistemi shtypës dhe i mbyllur?

I kisha lexuar dhe isha i vetëdijshëm për disa ngjashmëri. Në të njëjtën kohë, isha i shqetësuar të mos përdorja dredhi banale. Më duhej të isha i bindur se do të ishte letërsi e vërtetë, me vizion global. Në këtë kuptim "Pallati i ëndrrave" është një sukses.

Gulagët sovjetikë kanë krijuar një letërsi të pasur të dëshmisë me veprat e Solzhenicinit, Natalia Ginzburgut, Nadezhda Mandelstamit dhe të tjerëve. A kishte gulag në Shqipëri?

Po, por më pak, pasi vendi ishte i vogël. Hoxha ndërtoi mijëra bunkerë antibërthamorë në rast të shpërthimit të një lufte atomike, por ata ishin krejtësisht të padobishëm, - qëllimi i tij ishte - siç e dinte ai shumë mirë - të krijonte një psikozë frike.

Me gjithë qëndrimin e dyshimtë ndaj jush, Hoxha ju bëri deputet. Pse?

Nuk do të thoshte asgjë. Lista e deputetëve bëhej nga ai, dhe nëse dikush refuzonte eliminohej, vritej. Askush nuk refuzoi kurrë dhe nuk kishte ndonjë angazhim. Një herë në vit mbledhej Kuvendi dhe Hoxha diktonte atë që donte, pa diskutim, pa debat. Deputetët zgjidheshin midis punëtorëve, shkencëtarëve, shkrimtarëve, në mënyrë që Kuvendi të shfaqej përfaqësues i popullit.

Pas suksesit të librave tuaj në Perëndim, mund të ishit larguar nga vendi. Jeni tunduar ndonjëherë? Në librin "Pranvera shqiptare", botuar në vitin 1992, thoni se disa herë për pak keni qëndruar në Francë.

Nuk u largova sepse hakmarrjet ndaj të afërmeve, miqve, madje edhe të njohurve ishin të tmerrshme. Në vitin 1983 erdha në Francë me synimin për të qëndruar. Pastaj kuptova se nuk ishte e mundur. Kishte rrezikun e një shkëputjeje të plotë nga vendin tim, gjuhën time, të gjithë ata që doja. Miqtë e mi francezë më këshilluan të kthehesha, dhe unë e bëra.

Romani i trishtë që ju shkruat më



vonë, "Hija", shpjegon këtë déchément - zgjedhjen midis ekzilit dhe lirisë nga njëra anë, shtypjes dhe tiranisë nga ana tjetër. Kishit frikë nga ekzili?

Jo. Shkrimtari është gjithmonë deri diku në ekzil, kudo që është, sepse është disi jashtë, i ndarë nga të tjerët; ka gjithmonë një largësi.

Atëherë, pse u larguat pas rënies së komunizmit?

U largova në vitin 1990, kur Shqipëria po luhatej midis demokracisë dhe diktaturës. Mendova se largimi im do të ndihmonte kauzën e demokracisë. Thashë që nëse vendi zgjidhte diktaturën nuk do të kthehesha dhe ky kërcënim nxiti luftën për demokraci. Kisha ardhur në Francë për botimin e "Pallatit të ëndrrave" dhe bëra një deklaratë publike. Mediat e raportuan dhe kjo luajti një rol vendimtar në favor të demokracisë.

Populli donte të të zgjidhte president, si Haveli në Çekoslovaki, por ju refuzat. Pse?

Nuk ngurrova asnjë sekondë të refuzoja. Rasti im ishte i ndryshëm nga ai i Havelit. Doja të mbetesha shkrimtar dhe i lirë.

Është dilemë e madhe: a duhet t'i rezistosh diktaturës, të bëhesh disident, siç bënë disa shkrimtarë në Çekoslovaki; apo të largohesh nga vendi, siç bënë shkrimtarët gjermanë kur Hitleri erdhi në pushtet - ata u larguan masivisht.

Le të mos tregohemi naiv! Rrethanat ishin të ndryshme në secilin vend. Nuk mund ta krahasosh Shqipërinë e Hoxhës me Çekoslovakinë. Nuk kishim një Dubcek, Pranverën Çeke dhe gjithçka që ndodhi më pas. Nëse Haveli do të ishte në Shqipëri, do të pushkatohej menjëherë. Kjo është arsyeja pse nuk kishte disidentë në Rusi nën Stalinin. Askush nuk mund të bënte asgjë. Në Shqipëri, ashtu si në Rumani, Stalinizmi zgjati deri në fund. Kur Haveli ishte në burg, ai kishte makinën e shkrimtarit, mundësi informimi në mediat botërore, të gjithë flisnin për të. Ata që e krahasojnë situatën tonë me Çekoslovakinë nuk e kanë idenë e represionit Stalinist.

Pra, ishte vërtet mrekulli që mbijetuat?

Jo plotësisht. Çdo regjim duhet të ruajë fytyrën në lidhje me komunitetin ndërkombëtar, dhe nëse je një shkrimtar i famshëm, regjimi duhet të jetë i kujdesshëm. Hoxha donte të konsiderohej poet, student i Sorbonës, shkrimtar, jo vrasës. E vetmja gjë që një shkrimtar mund të bënte nën një diktaturë të tillë ishte të përpiqej të krijonte

letërsi të vërtetë. Në këtë mënyrë bën detyrën ndaj përjetësisë. Të presësh diçka tjetër është cinike dhe kriminale. Shqiptarët kishin tek unë një shkrimtar që i lidhi me botën. Dominoja jetën tonë kulturore dhe ruaja kulturën shqiptare me veprën time, sepse nga njëra anë ishte ajo që krijoja, nga ana tjetër ishte produkti komunist, i cili ishte i pavlerë. Kur botohej një libër i imi, në pesëmbëdhjetë minuta shitej, çdo kopje blihej menjëherë. Njerëzit e dinin që ndoshta do të ndalohej, ndaj nxitonin ta blinin para se të ndodhte. Ndonjëherë libri ishte i ndaluar para shpërndarjes, por deri atëherë mijëra kopje ishin në qarkullim dhe njerëzit ia kalonin ato njëri-tjetrit.

A nuk duhej ta dorëzonit dorëshkrimin në Lidhjen e Shkrimtarëve për shqyrtim siç ndodhte në Rusi?

Jo. Në Shqipëri nuk kishte censurë parabolim; meqë kishte kaq shumë terror, mjaftonte autocensura. Kjo ishte një nga veçoritë e Hoxhës, siç thashë, ai e konsideronte veten intelektual. Pra, ishin botuesit ata që vendosnin nëse do ta botonin një libër apo jo. Kur dorëzova dorëshkrimin e "Pallatit të ëndrrave", e dija se ishte një libër i rrezikshëm. Botuesi e lexoi dhe tha se nuk mund të rrezikonte ta botonte. Kështu që i thashë se e pranova përgjegjësinë: Nëse fillojnë të të shqetësojnë, thuaju se të bëri përshtypje fama ime dhe se unë të nxita. Në rrethana të tilla ata gjithmonë ndëshkonin autorin, jo botuesin. Kështu ndodhi në fakt. Ai u tha autoriteteve se duke pasur parasysh prestigjin tim nuk kishte guxuar të refuzonte dorëshkrimin tim.

Pra, shkrimtarë si ju dhanë sinjale, por njerëzit në Perëndim nuk donin të besonin se sa e rëndë ishte situata në vendet e Europës Lindore.

Në Shqipëri të gjithë e dinin që unë isha një shkrimtar kundër regjimit. Dhe fakti që regjimi nuk mund të më dënonte u dha kurajo të tjerëve. Ky është funksioni themelor i letërsisë: ruajtja e pishitarit moral. Në vitin 1988 Franca më bëri anëtar nderi të "Institut de France", një nder shumë i madh. Një gazetar francez më intervistoi në radio, duke më pyetur singierisht nëse isha i lirë të shkruaja atë që doja. Unë iu përgjigja: Jo, sepse liria në vendin tonë është ndryshe nga këtu. Çfarë mund të thojë tjetër? Nuk mund të flisja më hapur kundër regjimit. Ajo që po përpiqesha të bëja ishte t'i jepja një populli të lidhur me zinxhirë një ushqim të caktuar shpirtor - një pasuri kulturore të krahasueshme me atë të popujve të lirë të botës.

Mund të shpjegoni se çfarë kuptoni me letërsi të vërtetë?

E njeh menjëherë, në mënyrë instinktive. Sa herë që shkruaja një libër, kisha përshtypjen se po i fusja një kamë diktaturës, duke i dhënë njëkohësisht kurajo popullit.

Duke pasur parasysh atë që ka ndodhur në Jugosllavi, do të doja t'ju pyesja për intolerancën fetare. Gjysma e shqiptarëve janë myslimanë, përfshirë edhe familjen tuaj. A keni marrë arsim fetar? A ekziston rreziku i fondamentalizmit islamik në Shqipëri tani që praktika fetare është bërë e lirë?

Nuk mendoj kështu. Familja ime ishte myslimane në emër, por ata nuk e praktikonin besimin. Askush rreth meje nuk ishte fetar. Përveç kësaj, sektit bektashi i islamit që praktikohet në Shqipëri është shumë i moderuar, madje më shumë se në Bosnjë. Kështu që nuk mendoj se duhet të shqetësohem për këtë.

Për t'u kthyer te ana profesionale e gjërave, si e ndani kohën tuaj mes Tiranës dhe Parisit? Dhe ditë juaj, kudo që të jeni?

Jam më shumë në Paris sesa në Tiranë, sepse këtu mund të punoj më mirë. Në Tiranë ka shumë politikë dhe shumë kërkesa. Më kërkohet të shkruaj një parathënie këtu, një artikull atje. . . Unë nuk kam përgjigje për gjithçka.

Sa për ditën time: shkruaj dy orë në mëngjes dhe ndaloj. Nuk mund të shkruaj kurrë më shumë - truri më lodhet. Shkruaj në një kafene pranë qoshes, larg shpërqendrimeve. Pjesën tjetër të kohës e kaloj duke lexuar, duke parë miqtë, gjithë pjesën tjetër të jetës sime.

A është të shkruarit lehtë për ju apo i vështirë? Jeni të lumtur kur shkruani, apo jeni në ankth?

Të shkruarit nuk është një profesion i lumtur dhe as i palumtur - është diçka në mes. Është gati një jetë e dytë. Shkruaj lehtësisht, por gjithmonë kam frikë se mund të mos jetë e mirë. Ke nevojë për një gjendje shpirtërore të qëndrueshme; edhe lumturia edhe palumturia janë të këqija për letërsinë. Kur je i lumtur, priresh të bëhesh i lehtë, joserioz, dhe nëse je i palumtur, vizioni yt bëhet i turbullt. Së pari duhet të jetosh, ta përjetosh jetën dhe më vonë të shkruash për të.

Shkruani në makinë shkrimi apo me dorë?

Shkruaj me dorë dhe gruaja ime ka mirësinë t'i shtyp.

A rishkruani shumë?

Jo shumë, vetëm rregullime të vogla, por pa ndryshime drastike.

Çfarë vjen së pari - subjekti, personazhet, idetë?

Varet. Është e ndryshme për secilin libër. Procesi është misterioz, i paqartë. Nuk janë personazhet, por një përzierje e gjithçkaje. Merrni "Pallatin e ëndrrave". Në një roman të mëparshëm, "Kamarja e turpit", ka një faqe ku paraqitet për herë të parë ideja e kontrollit të ëndrrave. Më vonë mendova se ishte për të ardhur keq ta përdorja atë kaq shkurt ose të përpiktë. Kështu që shkrova një tregim mbi këtë temë, pa asnjë shpresë botimi. Por dy kapituj u botuan në një përmbledhje tregimesh. Kur pashë që autoritetet nuk e vunë re, u trimërova dhe e zgjerova në një roman. Pra, e shihni, zanafilla e një libri është misterioze.

Ata që e lexojnë veprën tuaj në origjinalin shqip, vërejnë bukurinë e prozës suaj. A është stili një shqetësim i ndërgjegjshëm për ju?

Jam tepër i përpiktë, madje kërkues për gjuhën. Për shembull, shkruaj gjithmonë poezi sepse poezia të detyron të punosh me gjuhën. Ekzistojnë dy lloje të pasurisë gjuhësore: e para është e ngjashme me atë të gurëve të çmuar - metaforat, ngjashmëritë, zbulimet e vogla - e dyta është në tërësi. Lumturia e madhe është një përzierje e përsosur e të dyjave, kur një tekst është shkruar bukur dhe përmbajtja është gjithashtu thelbësore. Por nuk ka asnjë përpjekje të ndërgjegjshme stilistike nga ana ime.

Cilat janë gjërat që ju pengojnë të punoni? Heminguej ka thënë se telefoni ishte vrasësi i madh i punës.

Në Tiranë askush nuk guxonte të përdorte telefonin, përveçse për qëllime të zakonshme, sepse telefonat përgjoheshin. Por siç thashë, shkruaj vetëm dy orë në ditë dhe nuk është e vështirë të izolohesh për kaq kohë.

Romani juaj i fundit, "Spiritus", u prit shumë mirë në Francë dhe shprej se se shpejt do të përkthehet në anglisht. Keni nisur një roman të ri?

Jo. A ka ndonjë ngut?

Qysh nga fillimi i vitit, jetoj në një trazirë të madhe mendore, e egër si një krevat i pashtruar. Nuk jam e sigurt nëse jam unë ajo që pasqyrohet në çka më rrethon, apo nëse është ajo që më rrethon arsyeja se përse ndihem e çorientuar. Një pjesë e këtij kaosi janë edhe librat e shkresat që përkulen në mënyrë ogurzezë kudo që hedh sytë, duke mu lutur të gjej kohë për to. Në fakt, janë më keq se punët e shtëpisë. Ato janë detyra të shtëpisë. Të paktën, unë mund t'i shmang punët; mund të punësoj dikë që t'i bëjë ato për mua. Por nuk gjendet askush që mund të më ndihmojë të zbraz valixhet në trurin tim.

Këtë përkujdesje të vetes e quaj poezi. Nëse e shmang për më shumë se sa duhet, filloj të ndjej një luzmë gjallesash brenda meje. Lajmëro shfarosësin e tyre!

Oh – por qenkam unë ai shfarosës. Ajo grackë minjsh është në të vërtetë lapsi im.

E mendoj poezinë si një dialog me veten, një bashkëbisedim personal, madje më shumë se sa një ditar. Jam vazhdimisht në dialog me veten, dhe kështu ka qenë për mua që në fëmijëri. Kjo vjen nga kalimi i një kohe të caktuar vetëm, si dhe nga kënaqësia që më sillnin ato çaste. Ndonjëherë, kur përjetoj miqësi të veçanta, ndihem në faj, sikur vetëm po i shfrytëzoj si dëgjues të monologëve të pafundmë që zhvillohen në mendjen time. A ndihen të gjithë njerëzit kështu si unë? Nuk e di. Unë njoh vetëm veten dhe mënyrën se si mund të kuptohet përvoja kur e përkthej atë në fjalë.

Unë shkruaj çfarë mendoj, por nga ta di se çfarë mendoj derisa ta shkruaj? Nuk mendoj në mënyrë abstrakte. Idetë më paraqiten si emocione të zbehta, të turbullta, sikur gjithçka që shkruaj më përcillet nga zemra, një muskul i fortë si një piton, por i brishtë si një byrek me shtresë limoni. Ndosht vetëm duke vrapuar pas poezisë (ajo e kërkon një farë përndjekjeje) që unë të përfundoj e kapur pas diçkaje, egërsisht në lëvizje, e cila më fshin nga toka dhe më çon gjithnjë e më lart.

Çdo ditë, poezia më thërret në të njëjtën mënyrë që minaret lëshojnë ezanin e tyre të mëndafshtë. Besoj se do të mund të shkruaja disa poezi çdo ditë vetëm nëse do t'i përgjigjesha kësaj thirrjeje. Megjithatë, shpesh shpërqendrohem nga një takim që s'mund ta anulohet, ose nga një email tekanjoh që kërkon t'i kushtoj vëmendje, ose nga nevoja bezdisëse e trupit për një dremitje.

Poezia është një shpëtim nga përditshmëria, një ftesë drejtuar të shenjtës. Për këtë arsye unë kënaqem kur lexoj vepra nga poetë që më frymëzojnë të nxitoj për të kapur lapsin tim. Nëse jam duke lexuar Bashō-në apo Issa-n, i lejoj vetes të shkruaj poezi më të shkurtra për natyrën. Kur lexoj Rumi-n, shtyhem të zbuloj shpirtëroren.


Shkrimi i poezive është një akt vërtet vetjak. Më çudit mendimi se poezitë e mia do t'i interesonin tjetërkujt. Poezitë janë aq personale saqë unë do t'i vlerësoja në të njëjtën mënyrë që do të vlerësoja grafitë me rreze X të mitrës sime. Është e vështirë të përfytyroj se kush do të donte t'i shikonte ato përveç meje.



SANDRA CISNEROS

Mbi aktin personal të shkrimit të poezisë “E mendoj shkrimin e poezisë një akt kryengritës”

Përzgjedhi dhe përktheu: Andja Krasniqi



Një rregull i pashkruar që më ndihmon të shkruaj poezi: i shkruaj ato sikur të mos mundja t'i publikoja, t'i printoja, t'i lexoja apo t'i shprehja ndonjëherë. Për këtë arsye poezia është ajo dhomë në shtëpinë e shpirtit ku jam e lejuar të mendoj çfarë të dua. Kjo gjë më duket befasuese, magjepsëse, e frikshme dhe qesharake, të gjitha njëherësh. Në këtë kohë të ndalimit të librave dhe të dyshimit të së vërtetës, e mendoj shkrimin e poezisë një akt kryengritës.

Është synimi im personal që në jetë të arrij deri tek një farë ndjeshmërie, mirësie dhe pranimi ndaj njerëzve nazeqarë rreth meje – gurutë e mi, jam e sigurt. Poezia është rrëfimi im personal. Jo gjyqese. E butë. Dashmirëse. Me besimin se do të lëviz nga ku jam tani dhe nga pikëpamja ime e vockël, e papërfillshme, duke shndërruar veten në një njeri që kërkon ndriçimin shpirtëror.

Në qoftë se një poezi më duket e thjeshtë për t'u shkruar, e di që nuk po përpiqem aq sa duhet. Poezitë janë të dyshimta kur e paraqesin veten lehtësisht.

Kjo është arsyeja se përse kaq shumë prej poezive të mia grumbullohen poshtë shtratit për muaj e vite, pasi asnjëherë nuk jam e sigurt nëse një poezi do të arrijë te dera. Me derën, dua të nënkuptoj që ato kanë arritur të më çojnë në një vend ku nuk prisja të shkoja. Kjo është ajo që duhet të bëjë një poezi.

Është puna e shkencëtarëve të zbulojnë vrimat e zeza në gjithësi, por është detyra e poetit që të zbulojë vrimat e zeza të qenies. Jam ende në një rrugëtim drejt vetëzbulimit, megjithëse jam gjashtëdhjetë e shtatë vjeçe e gjysmë teksa shkruaj. Jam duke plotësuar akoma praktikën time.

Ndihem me fat kur poezia më thërret sipër një Harley Davidson-i, duke mu lutur për një xhiro rreth lagjes. Por kur zhdukem për disa ditë dhe papritur kthehem me kostumin e zhubrosur, atëherë kuptoj që duhet ta kisha ditur: poezia është pjesërisht joshje e pjesërisht rrëmbim.

Është emocionuese, dëfryese dhe lozonjare, dhe u jam mirënjohëse lexuesve të mi. Jeni më se të mirëpritur të më bashkoheni në këtë rrugëtim.

30 gusht 2022, Casa Coatlicue, San Miguel de Allende

Sandra Cisneros

Sandra Cisneros është një shkrimtare e njohur për kontributin e saj të rëndësishëm në letërsinë amerikane. Ajo ka lindur më 20 dhjetor 1954, në Çikago. Cisneros njihet më së shumti për romanin e saj “Shtëpia në rrugën e Mangove” (1984), një histori që flet për një vajze të re latine të quajtur Esperanza Cordero, e cila eksploron tema të identitetit, përkatësisë dhe trashëgimisë kulturore. Cisneros ka marrë çmime të shumta për kontributin e saj në letërsi, duke përfshirë Çmimin Amerikan të Librit dhe Medaljen Kombëtare të Arteve. Ajo është gjithashtu një avokate e fortë për drejtësinë sociale dhe ka punuar gjerësisht për të mbështetur shkrimtarët nga komunitetet më pak të përfaqësuar.

FATE VELAJ

MOSSANGA

OnufriRoman